


Zhuljeta Grabocka (Çina)

Një jetë me Biblën

Kujtime

2016



Ligor Cina
(1920 - 1995)

*Kur i kanë thënë Ligorit,
se duhej shkruar një libër për jetën e tij,
ai iu është përgjigjur:
- "Pse të shkruani për mua
dhe njerëzit të lexojnë atë,
më mirë të lexojnë BIBLEN,
librin e të gjithë librave."*

Caralee Albanian Loring

Përmbajtja

Hyrje	9
Prolog	17
Korça në shkurtin e 1995	27
Besimi dhe njerëzit	35
Ditët e fundit të jetës	53
Këshillat e tij	73
Pjesa 2	87
Jeta	89
Gjyshja dhe nëna	95
Shtëpia e Zotit	101
Shkolla, fëmijëria dhe rinia	105
Humbja e babait	109
Ligori gjysh	115
Ungjillorët	121
Në gjurmë historie	133

Dashuria për Korçën e njerëzit e saj	141
Ungjillizimi, atdhetarizmi fetar	147
Epilog	149
Në kërkim për të biseduar me pastor Ian-in	151
Mendime rreth librit	169
Disa fjalë për autoren	173

Hyrje

Si dëshmitare e viteve 1990, prej shumë kohësh e kam ndierë pengun e shkrimit të kujtimeve për babain tim të dashur. Dhe jo vetëm për të, por për të gjithë besimtarët nismëtarë të krishterë ungjillorë. Ata të mbledhur në dhomat e thjeshta të shtëpisë sonë po merrnin barrën e një rilindje të re. Atë të besimit në Zot dhe rifillimit të veprimtarisë së kishës ungjillore në qytetin e Korçës. Atmosfera ishte premtuese. Përpjekjet çuan në rezultate që s'mund të imagjinoheshin më parë. Vitet e mohimit të lirisë së besimit prej katër dekadash kishin bërë efektin e tyre.

Prandaj vitet 1990 ishin një Rilindje e madhe për të gjithë shqiptarët. Ata do të kishin një mundësi për të parë brenda vetes e për ta njohur më mirë atë, në raport me botën dhe krijuesin e saj. Pa këtë hap, shoqëria nuk mund të ecte në rrugën e duhur drejt demokratizimit të të gjithë fushave të jetës, në rradhë të parë në atë të lirisë së besimit. Nga zemra e besimtarëve dilte lutja për bekimin e punës dhe fillimin e një epokë të re. Entuziazmi ishte i madh, në veçanti tek besimtarët e vjetër ungjillorë të kishës së krishterë ungjillore. Historia e saj në qytetin e Korçës i kalon më se një qind vite. Ajo është pjesë e sakrificave nëpër të cilat ka kaluar përhapja e ungjillit në Shqipëri. Kjo histori është e lidhur ngushtë me kontributet e mendjeve të ndritura, të disa

prej përfaqësuesve të Rilindjes sonë Kombëtare, si Vangjel Mekshi, Kostandin Kristoforidhi, Gjerasim Qiriazhi e motrat e tij, Sevasti dhe Parashqevi. Ata janë edhe veprimtarët e parë të saj. Si vizionarë largpamës, veprimtaria e tyre për mësimin e gjuhës dhe përhapjen e shkollës shqipe është zhvilluar krahas përkthimit dhe predikimit në shqip të Biblës. Ky mision ka çimentuar themelet e kësaj kishe. Historia e këtij besimi është lartësuar me veprat dhe përkushtimet e jetëve të këtyre rilindasve.

Në vitet 20-30 të shekullit XX, këtë traditë e vazhduan dhe ruajtën brezi i besimtarëve më të rinj të kësaj kishe. Ata ishin nxënës të shkollës së misionarëve Phineas B. Kenedy dhe Edvin Jacques.

Phineas B. Kenedy jetoi në Shqipëri nga prilli i vitit 1908 deri 1939 dhe bashkëpunoi me Sevasti Qiriazin në Shkollën e Vashave deri në vitin 1914. Kohë kur familjet Dako e Kenedi do të largoheshin për në Amerikë për shkak të Luftës së I Botërore.

Familja Kenedi do të kthehet përsëri në Korçë në vitin 1917. Shkolla e vajzave do të vazhdonte deri në vitin 1921. Shkolla Amerikane për vajzat do të hapet më vonë në ndërtesat e reja. Në vitet e pleqërisë zoti Kenedy do të marrë djem për të punuar me ta, lart në kodrën e qytetit. Ndërsa shkollat private do të mbylleshin në vitin 1933, ata do të ishin të lirë për të punuar vetëm me kishën. Ndërsa misionari Edvin Jacques jetoi e zhvilloi veprimtarinë e tij më vonë, në periudhën kohore të viteve 1932-1940.

Nxënësit e tij jetuan dhe punuan para, gjatë dhe pas Luftës II Botërore. Ata ishin pesë djem, që në vitet e diktaturës e ruajtën të shenjtë besimin të Zotit, si besnikë të kishës përballë propagandës ateiste. Jeta e tyre është shembulli i besimtarit të devotshëm, i sakrificës dhe bindjes së asgjë s'e ndal besimin e lirë në fjalën e Perëndisë. Me Lajmin e Mirë, nga njëri brez në tjetrin, bashkësia e


krishterë ungjillore shqiptare dhe sidomos ajo korçare u bë modeli i mirë i këtij besimi. Sot janë të shumtë ata, të cilët e ndjekin këtë besim dhe janë mirënjohës për kontributin që paraardhësit e tyre kanë dhënë për ruajtjen e ungjillizimit në vite.

Këto kujtime i shkruaj dhe për dy djemtë e mi, Josifin dhe Enin, për t'iu përgjigjur kërkesës së tyre për të reflektuar mbi bashkësinë e krishterë ungjillore, si histori e njerëzve të thjeshtë. Në procesin e të shkruarit ka qënë e përhershme ndihma e motrës sime Mimoza dhe këshillat e vëllezërve të mi.

Ju lexues dhe besimtarë të kësaj kishe, në rreshtat e këtij libri, do të gjeni fare pak nga historia e veprimtarisë suaj humane, që ju e shkruani përditë pranë njerëzve në nevojë, me forcën e besimit tek Zoti dhe në drejtësinë e tij. Duke guxuar ju kini ndryshuar jetët tuaja, ju përulem me mirënjohje!

Falenderimi në mënyrë të veçantë ju shkon gjithë mbështetësve, në veçanti misionarëve të huaj Michael Brown e David Young, Lerry e Dana Stucky, Ian e Caralee Albarian Loring e etj. që me materialet e mendimet ndihmuan në qartësimin dhe saktësimin e dokumentimit të veprimtarisë së tyre themeluese e inspiruese në Kishën Ungjillore të Korçës e më gjërë. E vlerësoj shumë të çmuar ndihmesën e tyre.

Autorja Dhjetor 2011 - mars 2016



*Ndërtesa e Fondacionit Kenedi “Rezidenca e të moshuarve”
me një shërbim njëzetë e katër orë mjeku, sanitarë dhe administratë.*



Aktivite të kishës nëpër fshatra me fëmijët.



Ceremoni kurorëzimi në Kishë



*Ndërtesa e Kishës Ungjillore në qendër të Korçës .
Zbukuruar për Krishtlindje. Pamja jashtë e brenda kishës.
Jezus është dhurata më e madhe për ne,
kisha është dhurata jonë për Zotin.*



Prolog

Siç po ndodhte gjithnjë e më shpesh, ata po takoheshin çdo ditë në mëngjes. Këmbët i çonin drejt një rruge, që e kishin bërë me mijëra herë që nga fëmijëria e tyre. Ajo i çonte në mes të qytetit të Korçës, në atë vend që ne e njohim me emrin Ambulanca e Vjetër. Për çudi, aty ndalonin.

Nuk kishte më as ndërtesë, as derë që të hapej dhe ata të vraponin si dikur nëpër dhoma dhe të uleshin nëpër stolat e drunjte. Sytë e mendjes u shihnin ndërtesën, ashtu siç kishte qenë dikur, pesë dekada më parë. Plot njerëz e jetë! Udhëtimi i tyre imagjinar ishte i ngjashëm me punën që bën njeriu për të ndezur zjarrin. I përplas gurët me njëri-tjetrin pa u lodhur, deri sa të dalin shkëndijat. Që të ndezësh zjarrin, duhen dhe drutë edhe era. Një zë së larti u kumtonte: *Rindize zjarrin në jetën tënde, prite erën, sepse pa zjarr dhe pa erë, ditët janë një robëri errësire. Për të ndriçuar zemrën dhe për të ngrohur shpirtin, duhet që dielli të ndriçojë çdo ditë errësirën tonë. Përveç dashurisë, çfarëdo që sheh, nuk do të qëndrojë!*

Ata kishin kaluar aty fëmijërinë dhe rininë. Ishte e njëjta rrugë, po ai kalldrëm, por pa ndërtesën me katet e saj, pa derën kryesore të hapur, dhomat e gjithçka. Sa u mungonte ajo “*fole ungjillorësh*”! Si në një vegim u kalonin kujtimet nga ajo kohë e

artë. Tani vetëm një pìrg i ngritur dheu, një ndërtesë e braktisur, një grumbull gërmadhash, por që kishte një histori të madhe të gërmës brenda saj, që u dhimbte fort në shpirt e u përndriste shpresat.

Kristaq - i thotë Ligorì, - të shkojmë e të bisedojmë me Kocin Treskën dhe Koçon Tilin, se çfarë duhet të bëjmë për të ribërë kishën tonë. Ata ishin ndër të paktët, në mos të vetmit, që kishim mbetur nga brezi i më të rinjve, grupit të fëmijëve ungjillor të viteve 1930. Si ylberi nën re, ata do të shërbenin si një shenjë për të përfunduar një besëlidhje, që jetonte thellë në zemrat e tyre.

Gjymtyrët e rënduara nga vitet, me hapat që oshëtinin mbyturazi në rrugicën e boshatisur dukeshin sikur psherëtinin: nxito, nxito, nxito! Jehona e hapave të tyre shumëfishohej përreth. Ata bashkoheshin si atëhere me hapat e shokëve të kishës, kur ishin të rinj dhe kjo rrugë i përthithte plot gjallëri e jetë, sepse në çdo fëmijë të lindur, Zoti sheh një yll në rritje. Vitet kishin rrjedhur dhe ata të shtyrë në moshë ndienin mall e nostalgji. Mbi supe mbanin kryqin e vuajtjeve dhe sakrificave. Por çfarë ishte kryqi i vuajtjeve të tyre para vuajtjeve në kryq të Krishtit?! Para tij, ata ngjanin si hëna, që merr dritë nga dielli.

Në të njëjtën kohë, para teatrit “Andon Zako Çajupi”, nga autobuzi i linjës Korçë – Selanik do të zbriste një turist. Flladi i mëngjesit dhe rrezet e diellit i jepnin fytyrës e trupit të tij, tiparet klasike të një statuje antike prej atleti. Në blunë e syve të tij ishte derdhur sa e kaltra e Oqeanit Atlantik, aq edhe ajo e Mesdheut. Me çantën mbi supe ai i ngjante një pelegrini, që kishte shkelur në vendet e shenjta. Prej vitit 1989 misioni i tij e kishte dërguar në Ballkan me qëllim që të studionte gjuhën shqipe.

Ndërkohë, që mësonte në Prishtinë, nga kreu i misionit i ishte dhënë adresa e një besimtari, tashtme në moshë të thyer, të Kishës

Ungjillore në Korçë. Adresa e Kristaq Treskës. “Kështu, në prill 1991, vajta në Korçë duke u nisur nga Selaniku, - kujton Michael Brown, dhe u përpoqa t’i gjeja shtëpinë”. Pas nja dy orë vërtitjesh nëpër qytet, djaloshit i dukej se kishte kapur zemrën e Ballkanit në trekëndshin Prishtinë - Selanik - Korçë. Ai po familjarizohej me rrugët e qytetit, pa e ditur se ato do ta çonin në rrugët e historisë së kishës ungjillore. “E gjeta shtëpinë në rrugën “Kostandin Kristoforidhi” dhe Kristaqin e takova bashkë me familjen e nipit të tij, Nestit. Pas një kafeje dhe muhabetit të këndshëm, ai më tha se do të më çonte për tek shtëpia e xha Ligorit, - do të vazhdojë kujtimet Majku. U nisëm... Kur hymë në shtëpinë e xha Ligorit dhe u përshëndetëm, ai më pa në sy dhe më citoi një varg nga Bibla, që gjendet te Romakët 8:28,

...“të gjitha gjërat bashkëveprojnë për të mirë për ata, që e duan Zotin dhe që janë thirrur sipas qëllimit të tij”.

U habita nga citimi i këtyre fjalëve të mirënjohura. E kisha fare të qartë që ai e kishte fjalën për gjithë ato vite të monizmit kur besimtarët kishin mbetur pa pastor, pa predikime, pa ndërtesë kisha dhe pa u mbledhur bashkë. U çudita edhe më shumë kur ai filloi të këndonte hymnin e njohur “Ç’mik na është Jezu Krishti!”. Ai dhe Kristaqi kujtonin çdo fjalë të kësaj kënge të famshme edhe pse kishin kaluar pesëdhjetë e një vite nga koha kur kishte ikur Edvin Jacques, pastori i tyre i paraluftës”.

Majku do të ishte misionari i parë ungjillor, që erdhi të banonte në Korçë në periudhën e ndryshimeve, korrik 1991. “E lavdërova Zotin dhe e falenderova, shprehet ai, sepse e pashë sa të fortë e kishte besimin Ligori edhe pas kaq shumë viteve. Më pas ata të dy më çuan për t’u takuar me Koci Treskën. Pasi isha takuar me këta tre burra, - tregon Majku, e kuptova që asgjë në këtë botë, qoftë edhe diktatura më e egër, që sapo kishin kaluar, nuk mund të mposhtë besimin e fortë, që njeriu ka tek Perëndia e gjallë.

Besimi i tyre kishte mbetur i gjallë dhe i fortë! Pas këtyre takimeve, xha Ligor më ftoi për një darkë në shtëpi, ku u njoha me gjithë familjen e tij. Para se të kthehesha në Greqi, Ligor më tha, se u duhej një misionar të vinte e të rifillonte gjithë punën e kishës ungjillore. Këto fjalë i mora si ftesë që të vija dhe më pas misioni ra dakord që të vija të banoja në Korçë. Ja takimi i parë dhe frytet e tij”. Kujton pas njëzetë e pesë vitesh ai, kur e ndjen se i kthehet në zemër e gjithë e kaluara... Fëmijët e Majkut, Nathanael dhe Anastasia në Nuneatonin e largët të Anglisë do të përmendin gjithnjë se nëna e tyre Suela Pulaha është nga qyteti i Korçës dhe një ndër besimtare të kishës së ringritur prej babait të tyre. Ata janë të lidhur pazgjidhshmërisht me këtë qytet, me kishën dhe njerëzit e tij.



*Nathanael, Majku, Anastasia dhe Suela Brown
(nga e majta në të djathtë)*

... Aty, në pronën e Kishës Ungjillore të blerë nga Ph. Kenedi më 1925 (për Conservative Baptist Foreign Mission Board) dhe të kthyer nga qeveria shqiptare në shtator të vitit 1996, por për më shumë se dy dekada do të vazhdonin të jetonin njerëz të pa strehë deri në vitin 2002. Vit kur filloi ndërtimi i godinës së re. Kjo godinë është një nga ndërtesat më funksionale të qytetit të Korçës, ku ushtron veprimtarinë “Fondacioni Kenedi”. Emri i Kenedit lidhet me veprimtarinë vizionare të misionarit ungjillor. Këtë detyrë ai e kreu me devotshmëri si shërbëtor i përunjur ndaj Zotit, duke mbjellë në zemrat e familjeve korçare shpresën, dashurinë për njëri-tjetrin, forcën ripërtëritëse të fjalës ungjillore. Ai dhe veprimtaria e tij u bë pjesë e qytetarisë korçare si mbartëse e vlerave më përparimtare të kohës. Ky vizion i dha atij respektin qytetar dhe pavdekësinë.

Ndërsa mbi kodrën e qytetit, që njihet me emër tij, pas njëzet vitesh të demokracisë hedh shtat një tjetër ndërtesë e re, Ajo u ngrit mbi themelet e rrafshuara të ngrehinës së vjetër. Por nuk ishin rrafshuar themelet e asaj historie të vjetër sa fetare, aq qytetëruese në kujtesën e korçarëve. Ndërtesa e re e bën të prekshme humanizmin e të mos ndihesh i vetmuar. Njerëzit në nevojë, paraplegjikët, tetraplegjikët gjejnë aty mjete për të lehtësuar jetesën. Pleqtë e vetmuar, një pjatë të ngrohtë dhe përkujdesje. Fëmijët me aftësi të kufizuara, edukim, argëtim dhe përpjekje për të qënë pjesë e jetës së bashku me moshatarët e tyre. Ndihmë dhe kujdes mjekësor të të gjitha specialiteteve. Specialistë, që zhvillojnë falas veprimtari sportive dhe argëtuese. Kjo është “Rezidenca e të moshuarve” në Kodrën Kenedi me një shërbim njëzet e katër orë mjeku, sanitarë dhe administratë.

Të dyja ndërtesat si dikur janë aty, njëra në mes të qytetit dhe tjetra lart në kodër, tashmë të rindërtuara dhe presin besimtarët e njerëzit në nevojë për t’i përndritur shpirtërisht në dekadat e para të këtij shekulli të ri.

Për ugjillorët e vjetër, të huaj dhe shqiptarë, që vunë gurin e themelit e që sot prehen në paqen e bekuar, si të fjeturit e lumtur në Zot, janë të bindur se ... Shpresa dhe ëndrra e tyre vazhdon...



Ligori dhe Kristaqi

*“Ishte e njëjta rrugë, po ai kalldrëm, por pa ndërtesën me katet e saj,
pa derën kryesore të hapur, dhomat e gjithçka.
Sa u mungonte ajo “fole ungjillorësh”!*




Foto: Pastor Majku dhe poster i për predikimin e misionarit ungjillor nga Shkolla Amerikane e para Luftës së II Botërore Edwin Xhekjs, bashkëpunëtor me z.Kenedy. Ky predikim u zhvillua pas 50 vjetësh, ditën e premte ora 17.00 në katin e dytë të Pallatit të Kulturës në qytetin e Korçës.



*Për të ndriçuar zemrën dhe për të ngrohur shpirtin,
duhet që dielli të ndriçojë çdo ditë errësirën tonë.
Përveç dashurisë, çfarëdo që sheh, nuk do të qëndrojë!*

Stinët e jetës janë si stinët e vitit. Njeriut, që i takon t'i kalojë të katër stinët, vjen një ditë dhe ai shkëputet nga dega, si një fryt i pjekur, i arrirë. Koha rrjedh në ditët e secilit prej nesh, ashtu siç rrjedhin në natyrë ndërrimi ciklik i ngjyrave. Ne dehemi në harmoninë e mrekullisë së saj. Natyra njerëzore është lakmitare ndaj bukurive natyrore e materiale. Njeriu mendon se këto mrekulli i përkasin vetëm atij. Por kur rrufetë çjerrin e përflakin qiellin e ujërat e rrëpirta rrëmbejnë gjithçka, nisin dilemat.

Ç'është jeta e vdekja!? Nga përgjigjja e tyre ndahet besimtari dhe ateisti. Kuptojmë se jemi kalimtarë edhe kemi vetëm një jetë tokësore. Por Ligori mendonte ndryshe. Jetën na i ka falur Zoti dhe shpirti pas vdekjes kalon në përjetësi pranë krijuesit të tij. Atij i takoi t'i kalonte të katër stinët e jetës. Dhe u shkëput nga dega e pemës së tij, për t'u prehur si i barabartë mes të barabartëve. Prej besimit tek Zoti, ai mendonte se kishte jetën e pasosur. Ky ishte dielli i ditëve të tij, që i ndriçonte mendjen dhe e ndihmonte ta shihte jetën me optimizëm. Për moshatarët e tij të viteve 1930 - 1940, lumturia ishte një mollë e ndaluar, që s'mund të kafshohej. Ishin vitet e krizës dhe të debateve të mëdha. Ata të rebeluar mendonin, se duhet të riskonin me plane e ëndrra. Kjo është e vërteta e madhe e jetës. Edhe për Ligorin ajo ishte një sfidë. Ne punojmë, Zoti na ndihmon.

“Prandaj, ai që i dëgjon këto fjalë të mia dhe i vë në praktikë, mund të krahasohet prej meje me një njeri të zgjuar, që e ka ndërtuar shtëpinë e tij mbi shkëmb. Ra shiu, erdhi përmytja, frynë erërat dhe u përplasën mbi atë shtëpi; por ajo nuk u shemb, sepse ishte themeluar mbi shkëmb.” (Shtëpia mbi shkëmb)

Bibla: Mateu 7: 24, 25.

Korça në shkurtin e 1995

Sapo kishte festuar me miq e të afërm datëlindjen. Kishte mbushur shtatëdhjetë e pesë vjet dhe mendonte se ky fakt ishte një bekim për të. Ai ishte babai edhe gjyshi i një familje të madhe. Shkurti në Korçë është muaji më i ftohtë i vitit. Ligori, në këtë muaj prej disa vitesh, kishte pasur probleme me shëndetin. Muajt e dimrit ishin muajt e pushimit, siç i quante ai, pas muajve të lodhshëm të verës. Kohën e kalonte me shëtitje dhe lexime, por më të shumtën e herës me meremetimin e koleksionit të kallëpëve, që i përdorte gjatë verës për lyerjen me tapicari të dhomave të pritjes. Kujdesi ndaj tyre ishte dhe një kërkesë e djalit të vogël të tij, Vangjos, sepse ato pas çdo lyerje dëmtoheshin. Por ai nuk përtonte të punonte me orë të tëra. Ato janë ruajtur mirë e përbëjnë një koleksion mjaft të pasur të punës së tij si bojaxhi.

Dimër. Zjarri digjte dru të thatë nga mëngjezi deri në darkë. Në qilar drutë e një dimri zinin dimrin tjetër, që nusët e djemve të tij të mos mundoheshin e të mbaronin punët e tyre shpejt, sepse siç u thoshte ai: - “drutë e thatë, lëvdojnë gratë”. I pëlqente të merrej edhe me ndonjë punë në oborr. Dilte tek dera e shtëpisë vështronte banorët e mëhallës dhe këmbente ndonjë fjalë me Perikli Mingën,

Neta Kallçon, Sofika Napuçen, Hariklinë etj. Kujdesej të bënte çdo ditë pazarin e dëshironte, që shtëpisë mos i mungonte asgjë. Ruajti gjithë jetën të njëjtin trup të drejtë e të gjatë mbi mesataren. Në fytyrë i endej një buzëqeshje e sytë i flisnin plot mirësi. Xha Ligori ishte pjesë e qytetit të Korçës dhe nuk u largua asnjëherë prej tij. Në zemër ndiente dashuri të madhe për njerëzit. Ishte plot jetë, paçka se pesha e viteve i kishte rënduar këmbët, por jo shpirtin. Ai ishte si ai prushi, që mjafton ta përziesh me mashë dhe do të kuptosh se sa zjarr ka brenda. Vitet e tij kishin hyrë në stinën e bardhë të jetës, si dëbora e stinës së dimrit. Prej saj ai kishte marrë jo ftohtësinë e thëllimeve, por ngjyrën edhe shkëlqimin e saj të artë. Ndihej mirë shpirtërisht, sepse besonte se kishte *“një mik”* që nuk e tradhëtoi kurrë, ndaj zemrën e kishte të mbushur me gëzim.

Dimri është një nga stinët më të bukura të kësaj treve. Tablotë befasuese, që ravijëzojnë rrjeshjet e borës në rrugë, mbi pemë, mbi çatitë e shtëpive, krijojnë në shpirtin e çdo njeriu një lidhje shpirtërore, që të zgjojnë meditime e reflektime të pashmangshme mbi harmoninë e mrekullisë së krijimit të krijuesit dhe ne si pjesë e planit të dashurisë e mirësisë së tij. Korçës në këto ditë të ftohta i shkojnë bukur dy detaje, dielli dhe dëbora. Ishin ditë të acarta, të ftohta, tipike shkurti, pa rreshje bore. Megjithëse në pikun e dimrit, dielli me rrezet e tij përndriste dëborën e kristalizuar, që kishte veshur gjithçka dhe u jepte vlagë bimëve të fjetura nëntokë. I ftohti i dimrit, të thonë korçarët, në krahasim me viset e tjera të vendit është i ëmbël, i shëndetshëm. Ashtu si klima janë edhe njerëzit. Të butë, të kulturuar si do t’i kishte dashur dhe vetë Zoti në këtë copë tokë, që ua kishte bekuar për të jetuar. Zemra e Ligorit e ndiente, se pranvera po trokiste ngadalë pa u ndierë. Syri i dehej nga bardhësia e dëborës, që kishte mbështjellë Fushën e Korçës. Ai e ndiente begatinë e saj, sepse nën tokën e mbështjellë me ngrohtësi, ruhej embrioni i farës së mbjellë në vjeshtë, që priste përtëritjen e

tij në pranverë. Ai ishte vetë një *farëhedhës i Lajmit të Mirë*. Që nga viti 1991, për pesë pranvera me radhë e kishte ndierë buisjen e tyre në zemrat e bashkëqytetarët e tij.

“Xha Ligori ishte njeri me besim të gjallë e të fortë, me karakter të formuar, i butë në zemër e në të folur, gjithmonë i sjellshëm e i matur në fjalë, i respektuar nga të gjithë. Aktiv si në punët e familjes ashtu dhe në veprimtaritë e kishës. Do të përsërisë në kujtimet e pashlyera të tij, - pastor Majku. Të gjithë besimtarët e kishës ungjillore e respektonin pa përjashtim. Ishte vërtet shumë punëtor, dhe në vitet e fundit të jetës së tij, akoma ngrihej në orën dy të mëngjesit, që të zinte vend në radhën e qumështit. E hapi shtëpinë për takimet tona gjatë javës, që të studionim Biblën së bashku. Mblidheshim në kuzhinën e tij për ndonjë orë. Unë i shkoja t’i merrja edhe ndonjë këshillë atëherë kur e ndieja se e kisha nevojë. Ligori u bë vëllai im i afërt në Krisht dhe një mik i vërtetë. Vizitat e mia në shtëpinë e tij ishin të shpeshta. Unë besoj, që ai i ishte tepër falenderues Zotit, që kishte privilegjin të përjetonte ditët e hershme të ungjillizimit pas rënies së monizmit, pasi kishte kaluar kaq e kaq vite pa qenë i lirë për ta shprehur lirisht, atë, që mbante si thesar në zemër, pra ungjillin e Krishtit”.



*Një grup besimtarësh dhe jo besimtarë
që përcjellin Majkun në shkurt të 1992 për një pushim 4 javor
për në Angli...*

Kurora e maleve mbyllte horizontin e vështimit të fushës pllajore. Dëbora, si një shall i bardhë tretej mbi shpatet e malit të Moravës, që tek - tuk nxirrte kurrizin e murmë dhe të zhveshur. Ligori i kujtonte vitet e jetës, të cilat i kishin rrjedhur si në një hapje e mbyllje sysh. Jeta e njeriut u ngjan sekuencave të një filmi që e ka një *“the end”*. Por kur mendon se nuk të ka shkuar kot, se ke mundur t’i japësh kuptimin, ndihesh i realizuar me veten dhe të tjerët.

Atij i kujtohej Nasi Lubonja, shoku i fëmijërisë dhe rinisë, që ishte ndarë nga jeta rreth viteve 1980. Edhe ata, si zoti Kuanrud sot, vinin fshatrave të fushës e malësisë së Korçës për të përhapur

Lajmin e Mirë. Është punë e gëzueshme, shprehej ai, se Krishti thotë, doli mbjellësi, kështu që ajo farë, që u mboll atëhere ka dhënë rezultate në kohën e tanishme...

Në vitin 1993, kur besimtarët si grup mbollën kishën ungjillore në Ersekë, disa prej tyre u takuan me një grua kolonjare, e cila gjatë bisedës që po bëhej u nxori Dhiatën e Re nga shtëpia e saj. Ajo u tregoi, se e kishte marrë në dorë nga ca ungjillzues nga Korça, pesëdhjetë e ca vite më parë. Që atëherë ajo e kishte ruajtur fshehurazi në shtëpi. Kur e pa Dhiatën e Re, Ligori qau, do të kujtojnë për këtë rast miqtë e tij. Gjithë mundimi nuk u kishte shkuar kot...

Ligori kishte kohë, që jetonte mes kujtimeve të së shkuarës dhe të së tashmes. Ato ishin të lidhura pazgjidhshmërisht si historia e Dhjatës së vjetër me Dhjatën e re. Ajo, që kishim mbetur ëndërr e bukur dikur, ishte sot një realitet i bekuar dhe i shumë pritur.

...Korça shtrinte trupin e saj nën rrezet e diellit. Gjithçka përumbte në mjegullën e tymit, që dilte nga çdo shtëpi, si dëshmi e zjarrit të brendshëm të çdo familjeje korçare. Ndryshimet e thella historike, që ndodhën mbas viteve 1990, vunë në provë vlerat e krijuara. Qyteti dhe njerëzit janë bashkudhëtarë dhe shkrues të historisë së tyre gjurmë identifikuese materiale e shpirtërore. Në këtë simbiozë ata nënkuptojnë e përjetojnë njëri - tjetrin. Mbyllja e uzinave dhe fabrikave solli në qytetin e Korçës papunësinë në përmasa drastike e të panjohura deri atëhere. Njerëzit përpiqeshin të mbijetonin me një asistencë, që nuk u siguronte kushtet minimale të jetesës. Dy djemtë e mëdhenj të tij, Koçua dhe Alberti, familjarisht kishin shkuar prej tre vitesh në Greqi. Ishin të shumta familjet e reja korçare, që do të shihnin emigrimin në vendet fqinj, Itali e Greqi si shpëtimin nga kjo situatë. Ata u nisën pa dokumenta duke vënë në rrezik dhe jetën. Më të privilegjuarit do të ishin ata, që do të

aplikonin e do të fitonin dhe do të shkonin me loto në Amerikë. Siç bëri djali i dytë i tij, Alberti në vitin 1995.

Një qetësi drithëronjëse ndihej në trupin e qytetit e nëpër rrugicat e tij. Ai po jetonte pa rendjen e përditshme të njerëzve për në punë, pa gëzimet e jetës, siç dinë t'i shijojnë korçarët.


Ai nuk u jepte sigurinë për të ardhmen e familjeve dhe të fëmijëve të tyre. Qyteti i dashur, Korça nuk po i mbante!? A thua se ishin të huaj në vendin e tyre? Këto rrugë e këto shtëpi, si të ishin krijesa të gjalla, përpiqeshin të memorizonin shqetësimet, debatet, përsëndetjet, largimet dhe kthimet e imponuara nga policia greke. Heshtja e shtëpive të boshatisura, të vriste. Dukej se kishin humbur rritmin normal të jetës. Secila prej tyre mbarte historitë emocionale të fateve të njerëzve të saj. Po iknin intelektualë, mjekë e poetë, inxhinierë e mësues, punëtorë të kualifikuar të uzinave dhe fabrikave të qytetit, fëmijë, të rinj e të reja. Boshllëku që po krijonte ikja e tyre ishte i madh.

Mungesat ekomomike, dimri i gjatë i errësirës shpirtërore të viteve të monizmit i kishte lodhur njerëzit në pritje. Korçarët të shquar për mendjen e tyre të hapët prej kohësh kërkonin një rilindje. Historia prej katër dekadash kishte marrë një kthesë të panatyrshme. Njerëzit vërtiteshin rreth boshit të tyre. Kishte ardhur koha e momenteve të kthesave të mëdha. Shkruheshin fatet e kombit. Njerëzit ishin më pranë njëri - tjetrit dhe kërkonin reflektim për ndryshim. Kur flitet për Korçën e njerëzit e saj, të huajt e identifikojnë me rrugët e drejta e të pastra. Ajo bulevardin kryesor e ka në formën e një zemre. Aty rreh zemra e qytetit. Kalldrëmet karakteristike, arteriet e saj kishin marrë plagë. Prej kohësh, ato merrnin frymë të shqetësuar, të asfiksuara nën rritmin e bijëve e bijave, që nxitonin të arrinin kohën e humbur në të tjera rrugë brenda e jashtë Shqipërisë.

Emigrimi ekonomik solli rrudhjen e plakjen e qytetit. Korça është një nga qytetet e Shqipërisë, që i ka njohur prej kohësh pasojat e dhimbjen e mërgimit. Nuk ka familje korçare, që të mos ketë emigrantë. Mërgimtarët e rinj, si të parët e tyre rreth një shekulli më parë, do të lakmonin të shkonin përtej kufijve në lindje, në Greqi edhe në perëndim, Itali e Evropë nëpër botë përtej oqeanit, larg në Amerikë e Kanada. Atje, ku fati i thërriste. Si asnjëherë këto rrugë, s'e kanë ndierë këtë hutimshpengues. Shpërfillje rreziqesh dhe të panjohurash. Të gjithë bënë plane ndryshimi dhe ikjeje. Si në shtegëtimet biblike një forcë e brendshme u përndriste të ardhmen.

Për ku? Pyet zemra e mardhur e qytetit tek kthen fytyrën për t'u ngrohur tek ky diell shkurti. Cila do të ishte ajo forcë, që do të shkrinte akullin e vështirësive e do t'u ngrohte zemrat njerëzve për të ringjallur shpresat e vrara? Ngutje e nxitim. Pritja kishte qenë e gjatë. Mbyllja e kufijve dhe kontaktet me njerëzit jashtë shtetit kishin qenë fatale dhe të dënueshme. Njerëzit ishin dehur nga era e lirisë pas kësaj hapjeje të Shqipërisë drejt botës demokratike. Kishte ardhur koha e ndryshimeve të mëdha. Ajo po punonte për Shqipërinë si pjesë e ndryshimeve demokratike të Evropës Lindore. Ndryshonin mentalitete, kristalizoheshin marrëdhënie të reja në të gjitha fushat. Njerëzit po përjetonin një epokë të re. Epokën e lirisë së mendimit. Dhe në rradhë të parë atë të lirisë së besimit. Shkurti dhe dielli i acartë i tij janë simboli i përmbysjeve të mëdha dhe fillimi i ndryshimeve.

Lum njeriu, që nuk ecën sipas këshillës së të pabesëve, që nuk ndalet në rrugën e mëkatarëve dhe nuk ulet së bashku me tallësit, por gjen kënaqësinë e tij në ligjin e Zotit dhe që mendon natë dhe ditë mbi ligjin e tij. Ai do të jetë si një pemë e mbjellë gjatë brigjeve të ujit, që jep frytin e tij në stinën e tij, gjethet e të cilit nuk fishken dhe gjithçka bën do të jetë mbarësi...




*Njerëzit ishin më pranë njëri - tjetrit dhe kërkonin reflektim
për ndryshim.*

Besimi dhe njerëzit

Hapja e Shqipërisë mbas viteve 1990 do t'i ngjante një furtune. Era e së cilës do të ndante bykun nga fara e shëndoshë e grurit. Pas kësaj stuhie, dielli do të vriste frikën brenda nesh. Shoqëria shqiptare kishte nevojë për një familje të madhe shpirtërore, sepse varka e saj kishte marrë ujë. I duhej guxim dhe besim për të prekur bregun e shpresës. Varkëtarin që mposhte stuhinë ai, njeriu shqiptar e kishte njohur qysh herët. Dishepujt e Krishtit në kohët e hershme, kishin predikuar dëshminë e tyre me Lajmin e Mirë në arteriet e rrugëve të perandorisë së madhe, që lidhnin Shqipërinë si pjesë e saj me vendet e tjera të Ballkanit. Në këtë rrugë ata do të kenë ndeshur jo pak shqiptarë, ilirianë. Nuk është hamendësim, që Apostullin Pal ta kenë dëgjuar drejtpërdrejt vetë shqiptarët dhe kanë reflektuar në besim. Ekzistenca e kishave më të vjetra në rrugën Egnatia, janë pjesë e këtij procesi. Rruga e historisë së përhapjes së besimeve fetare në Shqipëri është rruga e vështirësive dhe flijimit. Ajo është përballur me forcat e errëta mëkatore të natyrës njerëzore, por edhe me politikat fetare të perandorive pushtuese. Edhe kombi ynë si gjithë popujt e tjerë ka historinë e besimeve në fe. Ato fillojnë me besimin pagan, ilirian dhe më pas, nën ndikimin e predikimeve të dëshmisë

së Apostullit Pal, në shekujt e parë pas Krishtit, kemi kalimin në besimin kristian. Shumë nga studiuesit e pranojnë se shqiptarët janë ndër të parët, që u njohën me besëlidhjen e re. Nga mesjeta deri në ditët tona, besimit kristian i është dashur të përkundet, në djepin e dy feve klasike, të katolicizmit dhe të ortodoksisë. Me një ndarje heterogjene do të jetë më vonë edhe islamizimi i një pjese të madhe të popullsisë. Qëndresa e shqiptarëve nën udhëheqjen e Skënderbeut në shek XV, përveç qëndresës kombëtare ishte porta, që mbrojti krishtërimin dhe qytetërimin evropian. Proçesi i islamizimit është haraçi i pa merituar i ballkanasve. Por e përgjithshmja e besimeve në Shqipëri e pranuar prej të gjithëve është bashkëjetesa dhe toleranca. Edhe si për të kërkuar ndiesë, motivimi e legjenda urbane, se Zoti është një. Dhe kur u duhej konjunkturave të caktuara politike, siç ishte Rilindja Kombëtare, kalohej në thirrjet patetike poetike, se feja e shqiptarit është shqiptaria dhe Shqipëria një vend i bekuar prej tij. Pra rruga e ushtrimit të këtyre besimeve ka patur problematikë dhe vështirësi jo të pakta.



Në Ersekë. Viti 1992.

Ligori, Ian, Berti, Ilo. (nga e majta ne te djathtë)

“Unë i ngre sytë nga malet; nga do të më vijë ndihma? Ndhma ime vjen nga Zoti, që ka bërë qiejtë dhe tokën. Ai nuk do të lejojë që të të merren këmbët, ai që të mbron nuk do të dremitë. Ja, ai që mbron Izraelin nuk dremit dhe nuk fle. Zoti është ai që të mbron, Zoti është hija jote, ai ndodhet në të djathtën tënde. Dielli nuk ka për të të goditur ditën, as hëna natën. Zoti do të të ruajë nga çdo e keqe; ai do të ruajë jetën tënde. Zoti do të ruajë daljet dhe hyrjet e tua, tani dhe përjetë”.

Psalmi 121: 1-8

Mungesa e adhurimit në besim për një kohë të gjatë në vitet e regjimit monist, kishte tjetërsuar të gjitha dimesionet njerëzore. Në emër të edukimit të njeriut të ri me moralin komunist, ai sistem synoi të formonte breza të rinj ateistë. Platforma e këtij edukimi dha efekte të kundërta morale me ato të dhjetë urdhëresave të Moisiut. Ajo, që ishte propoganduar si arritje e formimit të bindjeve të personalitetit dhe e virtyteve të një shoqërie ku sundon shumica, rezultoi fals. Ngjarjet dhe shkatërrimet barbare, që ndodhen në ato vite treguan, jo vetëm shteti dhe prona nuk u ruajt, por si të ishin të urryera deri në mohim u shkërmoqën prej njerëzve të tij, si mall pa zot. Njerëzit kishin humbur moralin, ekuilibrin e kohës. Nën propogandën populiste të barazisë së vlerave, pa mundur të baraspeshonin argumentet dhe përparësitë mbi të cilat do të ndërtonin të ardhmen, shkatërroan gjithçka!! Vetëm urrejtje dhe mohim i asaj, që ishte ndërtuar me aq mund prej një gjenerate. Mallkim apo dënim. Nga kush dhe përse!? Vitet e para të trazincionit si për të gjithë qytetet e Shqipërisë edhe për Korçën ishin rënuese. Një luftë absurde me vetveten. Njerëzit e kuptuan se ishin larguar nga udha e Zotit. Prona e të gjithëve nuk po i shërbente më askujt,

si vlerë e si trashëgimi. Pas kësaj beteje të pashmagshme njerëzit mbetën të papunë. Fabrikat dhe uzinat u braktisën në pamundësi për t'i rinovuar. Të dëshpëruar, ata do të kërkonin ndihmën e idhujve dhe motivim për të ardhmen. Në memorjen e tij historike, populli kishte ruajtur nderimin për personalite të shquar të kombit, që në udhëkryqet e historisë, atdheun e kishin quajtur të zgjedhurin dhe të bekuarin e Zotit. Në këto momente kyçe të historisë moderne, ata po kërkonin bekimin e tij me fjalën e shenjtë. Dhe bekimi u erdhi. *Fjala hyjnore* do t'i vinte popullit shqiptar në këtë fundshekulli, mbas katër dekadash ndalimi shtetëror e institucional të besimit fetar. Sado e egër të ishte ushtruar përndjekja edhe persekutimi mbi personalitetet e kishës dhe besimtarët e thjeshtë, ai nuk mundi të vriste besimin në Zot, që kishte ushqyer thellë ndërgjegjen e lirë të njerëzve.

“Mos mblidhni për vete thesare mbi tokë, ku i brejnë tenja dhe ndryshku, dhe ku vjedhësit shpërthejnë dhe vjedhin, përkundrazi mblidhni për vete thesare në qiell, ku as tenja as ndryshku nuk prishin dhe ku vjedhësit nuk shpërthejnë dhe nuk vjedhin. Sepse ku është thesari juaj do të jetë edhe zemra juaj.”

Mateu 6: 19-21

Ishte vera e vitit 1992, i fillon kujtimet Ali Duro, fundi i gushtit. Ishte ajo kohë, kur përjetonim ethshëm ndryshime sistemi dhe përmbysjesh të mëdha. Njerëzit ishin gjithë kohës në lëvizje. Të dukej sikur kërkonin gjithandej, por nuk po gjenin atë, që do t'i kënaqte plotësisht. Unë sa kisha filluar një veprimtari të vogël tregëtare, së bashkë me djemtë e mij, vazhdon ai. Ishim të kënaqur, megjithatë e ndienim, se përsëri nuk e kishim atë, që do të na kënaqte shpirtin. Një shoku im, Llambro Karanxha, mjek kirurg në spitalin e qytetit, erdhi një paradite në pazar dhe më ftoi në mënyrë

të prerë: - Eja me mua, më thotë, leri djemtë këtu, se do të shkojmë diku. I pakënaqur e ndoqa pas. Por koha do të tregonte, se që atë ditë do të fillonte një jetë e re për mua. Do të njihja njerëz, të cilët do të më ndihmonin të njihja të vërtetën, për të cilën kisha dy vjet, që e kërkoja dhe nuk po e gjeja.

Llambroja, shoku im, më prezantoi me një njeri i cili, që në fillim m'u duk se nuk ishte shqiptar. Është anglez, më tha. U prezantuam dhe u çudita kur e dëgjova që fliste shqip. Siç mësova më pas, ai quhej Majk. Ishte misionar. Më foli pak për krishtërimin dhe Lajmin e Mirë. U habita jo vetëm me shqipen e tij të shkëlqyer, por dhe me ato që po dëgjova. Në fund të ligjëratës së tij, ai më ftoi të takohemi edhe me disa burra të tjerë shqiptarë. Disa prej tyre janë të krishterë prej vitesh, që e kanë ruajtur besimin në fshehtësi. Misionari i huaj më përmendi edhe disa emra. Mes të cilave edhe emrin e Ligor Çinës. Do të kalonin ditë dhe javë të tjera dhe unë do të dëgjoja për xha Ligorin plot opinione të mira. Jam takuar me xha Ligorin në shtëpinë e tij. Shkova atje me Llambbron dhe mora pjesë në një bisedë të lirë prezantimi. Ishim pesë-gjashtë veta; mes tyre dhe dy vajza të reja. Na priti në shtëpinë tij, vetë xha Ligor. Më bëri përshtypje trupi i tij i gjatë dhe një buzëqeshje tepër e ngrohtë e dashamirëse. Ai më zgjati dorën e tij dhe dora ime humbi në pëllëmbën e tij të madhe e të ngrohtë. Duke më shprehur mikpritje dhe dashuri. Ai kishte vërtet një pamje prej babaxhani! Do të ishte shtëpia e tij, që për vite të tëra do të qe një vatër, ku do të ngroheshin zemrat tona të ftohta duke dëgjuar mesazhet e Biblës. Mbaj mend një mbasdite, pasi mbaruam kohën e studimit biblik (Predikimi në mal, Mateu: 5: 1-12,) ku flitej për lumturinë *"Lum të varfërit në shpirt, se e tyre do të jetë mbretëria e qiejve"* - thoshte shkrimi. Xha Ligor më kapi për krahun dhe më ftoi të rrija edhe pak. Më bëri një çaj dhe më pyeti për jetën time, për nevojat e mia shpirtërore dhe jetën në komunitet. Nuk do ta harroj atë ambient miqësor, që më

krijoi. Ai fliste si një at i mirë. Më përcolli deri te dera dhe më tha: - Kur të kesh nevojë, eja të bisedojmë, pimë nga një çaj dhe lutemi për njëri-tjetrin. Faleminderit, i thashë. U largova duke ndierë se m'u lagën sytë. Fjalët e tij më ngrohën zemrën.

Ishte mezi i muajit, gushti i vitit 1994. Bashkësia e krishterë Ungjillore në Korçë ishte rritur mjaft, - vazhdon të më tregojë Aliu, i bindur se po thotë shumë pak nga jeta aktive në besim. Nga kisha jonë u nis për në qytetin e Pogradecit një grup i madh besimtarësh. Do të merrnim pjesë në pagëzimin e disa prej tyre, në liqen. Mes atij grupi isha edhe unë. Seç kisha një emocion të veçantë. Zemra më regëntinte nga gëzimi. Mbjaj mend, që m'u afrua xha Ligori, më hodhi dorën në qafë dhe me shumë dashuri më tha: - "Lum t'i që do të ndiesh gëzimin e pagëzimit! Me këtë dëshmon para botës, që i përket Krishtit dhe se jeta jote ka filluar të ndryshojë. Lum ti Ali!"

Sa foto të bukura ruajnë besimtarët e kësaj kishe nga pagëzimet e bëra prej Ligorit, pastor Jenit dhe Lerrit! Sa emocione të papërshkruara! Sa i bekuar ishte Liqeni, që po përjetonte një mision të tillë! Atë ditë u pagëzua një grup prej trembëdhjetë-pesëmbëdhjetë vetësh. Aliu ishte ai, që do të pagëzohej i pari. Emocioni dhe gëzimi nuk ishte vetëm i atyre, që po pagëzoheshin, por i të gjithëve. E veçanta ishte shpallja e dëshmisë së besimit prej secilit të pagëzuar. Të ulur nën hijen e pemëve mes një lëndine, do të shpallin para botës besimin dhe premtimin për t'i qëndruar besnik tërë jetën Zotit, Jezu Krisht. I bukur ishte fakti që të parët që do të dëshmonin ishin dy vetë, Aliu dhe Harrilla. Njëri vinte nga feja bektashiane e tjetri nga feja ortodokse. Njëri e kishte pasur gjyshin myhyyp të bindur, tjetri e kishte pasur babanë prift.



Në Pogradec, një grup besimtarësh pas pagëzimit.

“Sa foto të bukura ruajnë besimtarët e kishës nga pagëzimet.

Sa emocione !

Sa i bekuar ishte Liqeni, që po përjetonte një mision të tillë!”



Pagëzimi i Irenës

Veprimtaritë predikuese fetare pas viteve 1990, ashtu si në qytetet e tjera të Shqipërisë dhe në qytetin e Korçës, nisën me predikimin e fjalës së Perëndisë, me studimin e Biblës. Fillimisht u predikua nga të huajt. John Quanrud, Van Golder dhe Najua Diba predikonin në Tiranë, David Hosaflook Shkodër, John Miler në Krujë, Dadly Power në Berat, Mike Brown në Korçë, etj.

Idea se kishte pasur edhe më parë të krishterë ungjillore dhe po ktheheshin në besim, prania e tyre i frymëzonte ata, që dëgjonin rishtas fjalën e Zotit e të ktheheshin në besim duke patur identitetin e shqiptarit. *Thirrjes* së këtyre misionarëve të kishës së Korçës do t'u përgjigjeshin edhe vendasit. Ndër besimtarët vendas ishin edhe besimtarët me moshë të vjetër. Ungjillizimi i parë mbas rënies së komunizmit në Korçë është bërë në qershor të vitit 1991. "Pas disa javësh plot takime me njerëz të ndryshëm, e nisëm takimin tonë të parë. Në dhomën që e kisha zënë me qira në shtëpinë e Nestit, erdhën 14 njerëz, përfshirë edhe xha Ligorin, - dëshmon pastor Majku. Kënduam disa këngë dhe u lutëm së bashku. U dhashë një mësim të thjeshtë nga Bibla. Ligori donte që të fillonim të shkonim menjëherë nëpër fshatrat, për të bërë ungjillizime dhe predikime. Ai kishte një zell të vërtetë. Dhe dalëngadalë e filluam këtë punë... Pas një viti e gjysëm, e ftuam xha Ligorin të bëhej plak në kishë, dhe më pas ai u ftua dhe nga "Vëllazëria Ungjillore" në Shqipëri, për t'u bërë President nderi i kësaj organizate ungjillore kombëtare. Kjo përkon me kohën kur Ligori i është bashkuar thirrjes së tyre për fillimin e punës për ungjillizim, jo vetëm në qytetin e Korçës, por dhe përreth. Sipas një harte, ata do të shkonin jo më pak se tre herë në javë nëpër fshatra të ndryshme edhe ai do të shkonte shpesh me ta. Ajo, që më bën ta risjell në memorje me një nderim të veçantë këtë takim, është pjesëmarrja në të e Koci Treskës. Për të ky ishte takimi i fundit, sepse shëndeti i rënduar nuk i jepte mundësinë fizike për të vazhduar ashtu siç dinte ai, Koci, që korçarët e thërrisnin dhe e njihnin me emrin *Koci shenjt*i. Kjo ishte aureola e indentitetit ungjillor, të cilin ai nuk e mohoi kurrë. Koci Treska do të ishte drejtuesi i kësaj kishe pas ikjes së pastor Edwin Jacques (Xhejksi) në vitin 1940. Ligori dhe Koci ishin trajnuar më 1939 për shërbesë në fund të kohës, që Xhejksi qëndroi në Shqipëri. Mjafton ta shohësh Kocin në fotot e bëra në ato kohë, për të

ndjerë gëzimin e brendshëm të tij, martirizimin e pabujshëm dhe të kuptosh sakrificat, që kishte kaluar. Ata i kishin mbijetuar regjimit komunist duke ruajtur besimin në vitet e diktaturës. Qëndresa e tyre përbënte një mbështetje e shembull për edukimin në besim të brezit të ri. Harta ishte shtruar në tavolinë për të vazhduar rrugën e dishepujve si dy mijë vjet më parë.



Në mes të fotos Koci, që korçarët e thërrisin dhe e njihnin me emrin Koci shenjti.

Zhuljeta Grabocka (Çina)



Dana dhe Lerry Stucky dhe fëmijët



David Young me bashkëshorten.

Nëntor 1992. Teatri i Kukullave në Tiranë. Një sallë e mbushur me të rinj. Studentë të ardhur nga rrethe të ndryshme të Shqipërisë, që studionin në Tiranë. Por dhe banorë të moshave të ndryshme, qytetarë të Tiranës, që dëgjonin në heshtje predikimin. Kisha Emanuel predikonte për herë të parë.

Pastori John Kuanrud i ardhur nga Prishtina me një shqipe të rrjedhshme zotëronte sallën, që përthithte çdo fjalë. Dy burra të moshuar të ardhur nga qyteti i Korçës, Ligori dhe Kristaqi u ngjiten në podiumin e skenës. Do të bënin lutjet e asaj dite të paharruar. Fjalët e zgjedhura, prekja njerëzore, që ata krijuan, na bashkoi me mendje e zemër njësh të gjithëve. Ishim të rinj, - do të kujtojë për ato vite, Zefan Nikolla dhe në dilemë për këtë rrugë që kishim nisur. Ndërsa dëgjuam xha Ligorin, fjalët mjaltë me të cilat ai bëri lutjen, mbetëm pa fjalë. Kuptuam se kishte në Shqipëri njerëz të kulturuar e të kalitur në besim, jo vetëm të huaj, por edhe shqiptarë. Nuk kishte më mëdyshje. Shembulli dhe sakrifica e tyre për të ruajtur besimin dhe për ta ushtruar në kushte të vështira u bënë model për jetët tona.

Nëntor 1994. Zhvillohet tek Piramida ceremonia përkujtimore e 100 - vjetorit të Gjerash Qiriazit. Edhe Xhon Kuanrudi merrte pjesë, por Dana Stucky dhe Margaret Rid kujtojnë. Ishte ngjarje inspiruese. U mbodhën figurat më të shquara të kulturës shqiptare. Ndër ta edhe Xhevat Lloshi, gjuhëtar e studiues, admirues i veprimtarisë ungjillore. Aty foli edhe xha Ligori. Patriarku i kishës sonë me moshën dhe devotshmërinë në besim. Ai na kishte mrekulluar me thjeshtësinë, që shkonte natyrshëm në madhështi.

Në ato vite, kur ai kreu detyrën e Presidentit të Kishës Ungjillore, vinte shpesh në Tiranë. Flinte në shtëpinë time. Do të më tregojë vite më vonë John Kuanrud, gjatë një takimi që pata me

të. Ai kishte ardhur për të festuar 20- vjetorin e Kishës Emanuel. Gjëja e parë, që më ra në sy tek Ligori, thekson ai, ishte përshtypja se ai ishte shumë i lodhur nga jeta dhe nga puna. Ishte i thjeshtë dhe pa pretendime. I ambientueshëm e komod. Por jo i thjeshtë në mendime. I thellë për shkak të vuajtjeve, që kishte kaluar në jetë, sepse në themel të qënies së tij, ai kishte besimin tek Zoti. Besimin ai e kishte të shenjtë duke i qëndruar besnik Jezuit. Shpirtbutë e praktik, Ligori nuk mburrej, kur rrëfente për vete. Dukej si një xhevair i kalitur. I tillë ishte besimi i tij, që rrezatohej me shkëlqimin e përndritur të syve të tij sa herë shfaqte mendimet e tij të paqta e të urta.



Xhon Kuanrudi kishte ardhur për të festuar 20- vjetorin e Kishës Emanuel.



Përrshëndetja e Ligorit në 100 vjetorin e Gjerashim Qiriazit.

Nëntë janar i vitit 1995, Kisha Ungjillore e Korçës filloi një shkollë biblike, kujton mes të tjerash Dana Stucky. Për shkak të motit të ftohtë, ne i filluam mësimet në shtëpinë tonë prapa kinemasë. Herët në mëngjes atë të hënë, erdhi Xhaxhi Ligor për t'iu lutur Perëndisë dhe për të nxitur përkushtimin e studentëve të parë të kishës sonë pas monizmit. Qëllimi ishte që disa të studionin më thellë Biblën dhe për t'i shërbyer më mirë Zotit. Ligor ishte mjaft i lumtur atë ditë, që Zoti kishte plotësuar lutjet e tij, jo vetëm për punëtorë si ne, Majku, Shirli, Jeni, Karolina, dhe Margarita, por edhe nga populli i tij. Nuk do ta harrojmë kurrë gëzimin e Ligorit për shpalljen e fjalës së Zotit në shumë e shumë fshatra të rrethit të Korçës ku ai, Kristaqi e të tjerët e kishin bërë rreth 60 vjet më parë. *Ëndrra e tij për të pasur ndihmën e misionarëve të huaj* dhe puna e palodhur e tyre, po jepte rezultatet e dëshiruara. Të pashlyeshme do të ishin për Ligorin, mbresat e rezultatet e projektit të Kishës Ungjillore në korrik 1994. Atë verë, ne bëmë një trajnim në Voskopojë, dhe kemi shpallur Biblat në shumë fshatra dhe brenda


qytetit të Korçës, vazhdon të kujtojë Dana Stucky. Në fund kemi pasur një takim të madh, në Pallatin e Oficerëve në Korçë. Kohë kur Lerri, Ligori, Majku dhe Jenin ishte njohur si pleqtë e Kishës së Korçës në atë kohë.



Trajnim në Voskopojë

Njerëzit e lodhur nga dimri i gjatë komunist, po gjenin në dliresinë e predikimeve fetare shtegun e humbur, shpresën për të mbushur jetët e tyre me besim e bekim. Në njerëzit e moshës së tretë si Ligori, Koci, Kristaqi, Koçoja, Berti e Harrilla, Zhani e të tjerë, entuziazmi ishte edhe më i madh. Të formuar që në fëmijërinë e tyre si besimtarë e ndienin se fjala e Perëndisë, jo vetëm do të predikohej hapur, por do t'i jepnin kishës së tyre qytetarinë e munguar padrejtësisht. Pasues nga të gjitha moshat ndiqnin

me interes predikimet, sidomos rinia, vajza dhe djem nga bankat e shkollës e të rinj, që kishin dalë në jetë. Të shumtë ishin edhe intelektualët nga të gjitha fushat, që mbushnin shpesh në këto aktivitete sallën e madhe të bibliotekës “Thimi Mitko” të qytetit të Korçës.



*Aktivitet pëmbyllës në sallën e Shtëpisë së Oficerave
të qytetit të Korçës*

Gjithmonë na inkurajonte dhe na thoshte, kujton Plator Çollaku, - “Është koha të punojmë, të shpallim Krishtin mbret. Duhet të punojmë, se tani jemi të lirë. Duhet të plotësojmë punën e Jezu Krishtit, që për shumë vjet ka mbetur mangët”.



Ligori dhe besimtarë të kishës

Dërgojini këta djem “Si Timotenjtë e rinj” të përhapin Lajmin e Mirë, kujton këshillën e Ligorit, Olger Dashi në takimin e parë me të, në vjeshtë të vitit 1991, në shtëpinë e Majkut, atëherë kur Olgeri ishte përkthyesi i tij.

Ai do ta bekonte Elidan për të shkuar në Tropojë, Nikaj Mërkur në vitin 1993, dhe do t’i jepte edhe disa të holla, se ishte vajzë, dhe po nisej misionare në veri, në një vend të panjohur. Babai im nuk më dha lekë, kujton Elida Jorgoni, por xha Ligori më kuptonte, se të përhapësh fjalën e Zotit, e të predikosh Biblën, të hapen zemrat dhe jo më shtëpitë.



Karolina: Sa shumë e ndjejmë mungesën e tij dhe sa të bekuar jemi, që e kemi njohur dhe kemi bashkëpunuar me xha Ligorin.

Ditët e fundit të jetës

Ligor Çina priste dhe përcillte njerëz. Vazhdonin mbledhjet e rregullta në shtëpinë e tij çdo të enjte. Por dhe nëpër shtëpitë e tjera të besimtarëve të krishterë ungjillorë, Nesti, Niko, Athina e Xhimi. Numri i besimtarëve ishte rritur. Mbledhjet bëheshin dhe në ambiente të marra me qira, aty-këtu në grupe të vogla. Në këto momente kur ai e ndjente se kontributi i tij i duhej kishës më shumë se kurrë, Ligori sëmuret.

Gjendja e bronkeve të tij ishte shumë shqetësuese. Pasojë e problemeve jo të lehta, që ai kishte pasur me shëndetin vitet e fundit. Shëndeti i brishtë e bënte gjendjen e tij edhe më të rënduar. Shtëpia ishte plot me besimtarë. Të martë në darkë, ai nuk ndihej mirë, shtrohet në spital e i nënshtrohet analizave e mjekimit.

Të gjithë e kishim ndierë se kohët e fundit kollitej më shpesh, ecjen e kishte më të rënduar, në fytyrë një çere e zbetë e mavijosur s'po i hiqej. "Një ditë dikush erdhi e më tha, që xha Ligorin e kishin shpënë në spitalin e Korçës, - vazhdon me kujtimet e tij pastor Majku. U nisa menjëherë ta shikoja. Kur arrita, ai u ngrit më këmbë dhe kaluam disa kohë duke biseduar së bashku. Në shpirt ishte tepër i gjallë dhe i fortë, edhe pse kuptohej, që shëndeti

po i keqësohej nga dita në ditë. Më thanë besimtarët, që ai ishte duke i inkurajuar dhe duke u lutur për të sëmurët e dhomës së tij, deri në minutat e fundit të jetës...”

Ai nuk ankohej, nuk shprehte shqetësim apo frikë për sëmundjen dhe shëndetin e tij. Deri në momentet e fundit të jetës nuk e dha veten. Mjekët dhe personeli i spitalit po i jepnin ndihmën e tyre. Ata menjëherë i përcaktuan diagnozën. Trompboza e mushkërive s’mund të na jepte asnjë shpresë për shërim. Në pamundësi për t’i bërë diçka, vuanim në pritje. Ndërsa ai i qetë e ndiente, se kishte filluar rrugën drejt jetës së amëshuar... .

Pranë tij, të gjithë ishim bashkë. Pati dhe shenja përmirësimi. Edhe mjekët shpresonin. Interesohej për familjet dhe problemet tona. Porosiste Mimozen, motrën e vogël për djemtë e saj, Vasianin dhe Johanin. Irenën, nusen e shtëpisë për Vangjon dhe djalin e tyre Grigorin, që ishte ende i vogël, e që ai e donte shumë. Borizin dhe Evrin, të cilët sapo kishin nisur një aktivitet privat e u jepte mendime inkurajuese për ndërtimin e lokalit. Përvoja e tij ishte një bekim për fillime të mbara. Nuk kishte probleme, që ne fëmijët e tij të mos i diskutonim me të. Në ditët e asaj jave, që qëndroi i shtruar në spital, ai u takua pothuajse me të gjithë njerëzit e afërt. I falenderonte dhe u lutej të vazhdonin punën dhe prokupacionet e përditshme. Vetëm ti e ke punën këtu me mua, - më thoshte. Ai e ndiente se kish ardhur ora e ndarjes dhe po na përgatiste për ikjen e tij. Në përthumbjen e herëpashershme e pyesja dhe gjithnjë më përgjigjej i papërtuar dhe kthjelltasi. Gjithë jetës, ai kishte qënë një bashkëbisedues i këndshëm e mirëkuptues. I tillë mbeti në kujtesën tonë. Ato ditë më rizguam edhe detajet e këtyre kujtimeve, që po i shkruaj. Shpesh themi, se jeta është e shkurtër, lum kush lë kujtime të mira. Për Ligorin këto ditë e momente ishin prova e tij, që po i kalonte qetësisht. Ai linte pas pasqyrën e një jetë plot sakrifica e të pabujë. Qetësia atij i buronte së brendshmi dhe ishte hyjnore. Por

ne ishim të shqetësuar. Ndiqnim çdo ndryshim të gjendjes fizike dhe emocionale të tij. Rreth shtratit ishim pa pushim familjarë dhe besimtarë. Ai më dha dorën. Unë ndieja rrahjen e zemrës së tij në dorën time. Në këto momente njeriu përjeton kufirin midis jetës e vdekjes. Ndien se sekondat e minutat ecin shumë ngadalë. Në ankthin e pritjes se çfarë do të ndodhë, ato e humbim kuptimin. Koha në pritje të së pabesueshmes merr një dimension të ri. Akrepët e saj dikush i kurdis. Për herë të parë fillova të mendoj, sa i kotë kishte qënë dyshimi mbi ekzistencën e jetës së amësuar. Për të cilën, ai nuk ishte lodhur së predikuari. Po merrja forcë. Me motrën dhe dy vëllezërit shkëmbenim vështrimet. Për ne tani çdo gjë ishte e qartë.

Spitali i Korçës në ato vite të vështira ekonomike kishte mungesa të mëdha. Në këto kushte puna e mjekëve e përkushtimi i tyre ishte për t'u admiruar. Ai komunikonte me mjekët dhe zbatonte me përpikmëri porositë. Në dhomën e thjeshtë të spitalit (reaminacion) kishte edhe të sëmurë të tjerë. Ai u jepte zemër me fjalën e Perëndisë dhe pacientëve të dhomës. Mes të sëmurëve ishte edhe një vajzë e re. Duke ecur, ai ndalet pranë asaj dhe lutet. Në fjalët e hapjes së lutjes ai ishte i veçantë, edhe ne të përqëndruar në adhurim, ndienin lutjen në shpirt. Në heshtje, lutemi edhe ne. Në jetën e tij nuk ishin të pakta momentet në të cilat Zoti kishte vënë në provë besimin e tij. Kishte humbur në moshë të re, babanë e më vonë nënën, në moshë kritike gruan e motrën e tij. Por asnjëherë nuk e lëkundti besimin tek Perëndia. Me fjalën e Biblës në zemër, rriti dhe bekoji të gjashtë fëmijët e tij. Jeta për të nuk e humbi kuptimin edhe pse mund të vuante e të lëndohej shpirtërisht. E jetoi atë pa iu ankuar njeriu. Vështirësitë e dallgët e saj ishin sprova nëpër të cilat kaloi besimi i tij. Jo pak herë në dallgët e saj i është dashur të mbijetojë. Forcën e gjente tek leximi i Biblës. Libri i shenjtë ishte miku i përhershëm i tij. Mësimet dhe simbolika e personazheve, do

të ishin bindja dhe besim i tij i palëkundur referues. Dhe tani me vështrimin e lehtësuar të syve, se peshën e kësaj jete po e lëshonte në krahët e sigurt të atij, që i kishte dhënë jetën, Zotit, priste gjykimin e tij.

Me frymën e fundit në kraharor, kur zemra luftonte për të kapur heshtjen, fjalët që u dëgjuan të shqiptuara prej e tij ishin: - “Sa bukur është këtu, çfarë harmonie! Një lulishte me lule ngjyra - ngjyra, shestuar mbi një gjelbërim të ri e plot freski, shihnin sytë e tij përtej dritareve të dhomës. Vërtet, sytë e tij shihnin një ylber të harkuar mbi një shatërvan, ku ai endej si në krahët e një ëndrre. Ligori, tashmë kishte prekur *vizionin e parajsës*, pjesë e së cilës do të ishte përjetësisht”. Por përreth, ishin ambientet e spitalit të Korçës së tij të dashur. Koridoret, dhomat, oborri dhe gjithçka ofrohej në asistencë dhe aparatura shëndetsore. Në ato vite të vështira të tranzicionit si kudo dhe në spitalin e Korçës, këto ambiente e kishin humbur shkëlqimin e dikurshëm. *Kotësi, kotësi*, pëshpëriste duke u dyzuar midis dy botëve, asaj reale që *vërtitej rreth hiçit, për qëllimit të hiçit*, dhe parajsës, vendit të paqes e dashurisë, ku ndihej i lumtur e i gëzuar në krahët e atit të tij, Zotit.

Mungesat në medikamente dhe bazë materiale gjithandej ishin të mëdha. Ai i shpërfillte ato, nga dashuria e madhe dhe adhurimi i tij në fjalën e Perëndisë. Është truri i pa oksigjenuar, do t’i thoshin motrës mjekët, që i prodhon këto pamje. Por, ato ishin *dhurata*, që besimi po ia falte, për t’ia shtruar lehtësisht, rrugën ku do të ecte. Miqtë dhe besimtarët që ndodheshin pranë tij do të ishin dëshmitarë të këtij rrugëtimi vegimor parajsësor. Mbasi na përshëndeti u ul në buzë të krevatit.

Nga thellësia e zemrës i buroi vargu i një kënge e shoqëruar me një iso të lehtë, sikur kërkonte dhe këngëtarë të tjerë që t’ia mbanin. Muret e dhomës së spitalit e përcollën jehonën e saj.

Thellësia e ndjenjës, që buronte prej fjalëve e melodisë të shtynin thellë në kohë. Ato ishin vegimprurëse si mall dhe brengë. Ndoshta kërkonte të mbështetej diku ose tek diçka, që i kishte munguar prej kohësh. Fjalët e këngës, që ai shqiptoi në ato çaste, për mua ishin të padëguara. Ai kishte motivet e preferuara, që i këndonte qysh nga rinia e tij. Kënga i kishte buruar nga shpirti si bashkudhëtare e pandarë. Edhe atëhere kur hallin, siç thoshte shpesh, s'ja kuptonte njeri. Kënga dhe ai ishin dy miq të mirë. E pranonin njëri-tjetrin. Ajo e shoqëronte në momente pune dhe nëpër festa familjare. Motivi i sapo kënduar e kishte kodin në vargjet e tij. Ishin ndoshta pengu i fundit i një jete të gjatë me të cilën ai po ndahej. Nga fjalët e kësaj kënge po shkëput vargun e vetëm, që shqiptoi qartë dhe thekshëm:

“ Ajde moj myzeqare, se do të marr për fare”. Ndoshta ishte dora e zgjatur, që bashkëshorja e tij, Donika e ndarë nga jeta para shtatëmbëdhjetë vitesh, me origjinën e prindërve të saj nga Myzeqeja, por e lindur në Voskopojë dhe e rritur në Korçë, ia jepte për të kaluar pragun e përjetësisë ashtu siç i ishin betuar njëri - tjetrit në emër të krijesit të tyre.

“Prandaj njeriu e lë babanë dhe nënën bashkohet me gruan e tij dhe këta të dy bëhen një.”

Bibla: Zanafilla, fq: 3



Ligori dhe bashkëshortja e tij Donika

Çdo mbrëmje të dy së bashku, por jo rrallë edhe me ne fëmijët bënte leximin e fragmenteve me episode të ndryshme nga Bibla. Ai kishte një bibël të vjetër në gjuhën rumune. E vetmja, që i kish mbetur si literaturë biblike në ato vite të persekutimit komunist. Ne atëherë nuk e kuptonim se çfarë ishte ai libër. Njëherë motra, ende fëmijë, pasi ishte kthyer nga studimi i pianos dhe po dëgjonte pjesët klasike të kompozitorëve të mëdhenj, që shpërndante në dhomë radioja jonë e vjetër CGE. E kureshtuar e pyet, se ç'ishte ky libër i madh e i kuq, me fletë të ndritura me ar, që ai e shfletonte për natë?

- *Ashtu siç kemi nevojë të thithim ajrin, të pimë ujin e të ushqehemi, kemi nevojë edhe për një ushqim shpirtëror, - ishte përgjigjja e tij me dhimbjen, që s'mund t'i thoshte se ai libër ishte Bibla.*



Ligor Çina me Biblën në gjuhën rumune, 22 mars 1993. Fotoja është bërë e botohet me lejen e Dana Stucky, kur ajo dhe bashkëshorti kanë ardhur për herë të parë në Korçë. Ajo tregon se kur e pyeti xhaxhi Ligorin: - Ku ke fshehur Biblën tënde gjatë komunizmit? Ai i është përgjigjur: - Nën shtratin tim! Gjithashtu ajo kujton në shënimet që shoqërojnë fotografitë, se Ligori e kishte lexuar Biblën 200 herë gjatë gjithë kësaj kohe.

“Njeriu nuk rron vetëm me bukë, por me çdo fjalë që del nga goja e Perëndisë”

Bibla Mateu 4:4

E fshinte në nënkresë e kudo ku mund të mos i gjendej. Donika ishte dëgjuesja e rregullt dhe e pandarë e tij, atëhere kur feja ishte herezi dhe e dënueshme për çdo njeri, sikur vetëm emrin t'i përmendej, dhe jo më të mendohej leximi dhe interpretimi i saj. Por Ligori mbrëmjeve në gjirin e familjes, në raste jo të rralla ishin të pranishëm dhe njerëz të farefisit, që i dëgjonin historitë e Biblës e si predikime i përthithnin. Ai dinte t'i lidhte bukur fabulën biblike

me problemet e jetës së tyre të përditshme. Ligjërimi i tij kalonte natyrshëm nga historitë e Zanafillës, tek Besëlidhja e re në Krishtin, nga Psalmet dhe Fjalët e urta të Salomonit deri tek Zbulesa. Sa vlerë të madhe kishte në këto raste, jo vetëm njohja e shkrimit të shenjtë, por dhe rilindja shpirtërore e të gjithëve që e rrethonim! Kjo ishte sipas tij edhe një nga rrugët më efikase, që së bashku me leximin individual, të ndante me të tjerët edhe predikimin në rrethin familjar. Në këto mbrëmje nuk mungonin këngët popullore e qytetare, që familjet korçare i ruajnë dhe kultivojnë. Ai na këndonte atëhere edhe disa nga këngët e shenjtëruara, që i kishte mësuar i vogël në kishë. Burrë e grua në jetën e përtëjme do të ishin sërish të bashku, ashtu siç kishin besuar e lutur në jetët e tyre. Ishin këto, momentet që ai po i ndante me njerëzit më të dashur të familjes edhe pse dy prej djemve, Koçoja dhe Alberti, nuset Liliana e Rajmonda, mbesa e tij e dashur Herisi së bashku me nipërit Jorgo, Stivi dhe Tomi ishin në Greqi, dhe në pamundësi për të ardhur. Ata ishin në emigrim dhe pa dokumentacionin e duhur. Sa e sa njerëz, që mërguan në ato vite, vuajnë pengun e mos përcjelljes së prindërve, apo njerëzve të tyre të dashur! Ata luteshin për shëndetin dhe marrjen e bekimit prej tij. Dhe ai na i dha bekimin duke na mbledhur së bashku, jo vetëm si njerëz me lidhje gjaku, por edhe si njerëz të një bashkësie, të bashkësisë së vëllazërisë së madhe në Jezu Krisht.

Ishte e diel para dite. Mëngjes lutjeje. Kur njerëzit luteshin, shpirti i tij nga kori i njerëzve, fluturoi për të kapur korin e engjëjve. Ai tani i përkiste jetës së amëshuar, së cilës i besoi dhe u lut gjatë gjithë jetës së tij.

E diel,

19 shkurt, ora 10. 00,

zemra e tij pushoi së rrahuri.


Në ceremoninë mortore, të gjithë kishim çfarë të ndanim si kujtim për babain, gjyshin e mikun e shtrenjtë. Për të nderuar kujtimin e tij morën pjesë të afërm e miq e qindra bashkëqytetarë. Ajo, që i bashkonte ishte besimi në Zot. Rruga që sapo kishin nisur, kishte të bënte dhe me kontributin e brezit të Ligorit si besimtarë të vjetër. Kontribut që shënonte vazhdimësinë e këtij besimi nga Rilindja Kombëtare, si urë lidhëse me vitet e errësirës shpirtërore të Diktaturës Komuniste deri në fillimet e Demokracisë. Realiteti i viteve 1990, tregoi se Kisha Ungjillore ishte tani një realitet i prekshëm me tipare krejtësisht të veçanta nga fetë klasike, që kultivohen në besimin e njeriut shqiptar. E veçanta qëndronte në format e përjetimit të besimit në Trininë e Shenjtë, në komunikimit shpirtëror me Zotin, me krijuesin, me lutjen intime, individuale, të drejtpërdrejtë në adhurim dhe pendim, me veprimtaritë shërbyese masive si bashkësi besimtarësh të krishterë me të cilat ajo realizohet. Përpjekjet dhe shembulli i nismëtarëve të ushtrimit të këtij besimi kanë treguar, se ky besim e meriton motivimin e konceptit, se feja ungjillore është shprehje e një feje të moderuar jo vetëm në botë, por edhe në Shqipëri.

“Pasi ndërroi jetë, më kërkuan si pastor, - kujton për këtë rast pastor Majku, që të shërbeja në varrimin e tij. Kur e pashë turmën e madhe, që ishte mbledhur jashtë shtëpisë së tij, e kuptova se sa njeri i çmuar kishte qenë për shumë njerëz dhe jo vetëm për besimtarët e kishës. Ne e deshëm shumë xha Ligorin, si vëlla besimtar. Me lejën e familjes i ndryshuam nga pak ato zakonet e varrimeve shqiptare për rastin e babait të tyre. Pra, kur ishim tek varri e kënduam po atë këngë, që kishte kënduar ditën e parë kur e takova në qershor 1991, *“Ç’mik na është Jezu Krishti”*. Ishte kënga e tij më e preferuar, dhe unë besoj, që ai u kënaq atë ditë duke na dëgjuar prej qiellit ku ishte.

Ishte diçka tepër e përshtatshme! Xha Ligori gjithmonë do të mbetet në zemrën time! Ka qenë privilegj për mua që isha pastori i tij nga viti 1991 deri në 1995. Jeta e tij ishte një dëshmi dhe shembull i një besimi që ka peshë domethënëse, që nuk dorëzohet në ditët e vështira, që ua bën ballë problemeve të jetës, që sillet me qetësi, urtësi dhe ndershmëri, i tillë mbetet deri në fund. Një predikues i njohur britanik më tha njëherë, që një njeri i vërtetë i Perëndisë njihet, jo thjesht nga jeta e tij, por edhe nga vdekja e tij. Dhe kjo thënie vërtet u reflektua dhe te xha Ligori. Ligor Çina ishte vërtet besimtar dhe njeri i Perëndisë. Qoftë i përhershëm kujtimi, shprehet Majku për mikun e tij! ”

Ceremonia mortore, që u zhvillua për Ligorin, ishte e veçantë. Ata i treguan qytetarisë korçare, se Kisha Ungjillore vinte me një risi ritualesh të pa ushtruar më parë në kësi rastesh. Aty kishte jo vetëm respekt, dashuri e dhimbje për njeriun e dashur, por edhe lehtësim, që u shpreh në bindjen se tani Ligori, si besimtar prehet në paqe e në parajsë. Përcjellja e tij me këngën *“Ç’mik na është Jezu Krishti”*, këngë, që ai e kishte kënduar vetë në mbledhjet e veprimtarive të para të grupit të kishës. Vargjet e saj ishin shkëputur nga poezitë e Gjasim Qiriazit, të botuar e ruajtur mirë në kujtesën e brezit më të vjetër të besimtarëve ungjillorë. Ai e kishte ruajtur me kujdes një botim të vitit 1927. Këngët e tij, ai i këndonte fshehurazi kur takoheshin me Cacin, siç e thërrisnim shkurt Kristaq Treskën, shokun e fëmijërisë dhe të besimit në vitet kur përndiqeshin nga ateistët. Kjo këngë po këndohej edhe tani nga të gjithë pjesëmarrësit në varrim. Fjalët e saj na i ngrohën thellë në shpirt zemrat e u përcollën mbi shpatet e zhveshura të malit të Moravës e si një jehonë ato zbritën lehtë mbi gurët e bardhë të varreve duke i përshëndetur me mesazhin e saj, atë botë të paqës të të pafjeturve në Krisht. Të gjithë ndiheshim të lehtësuar. Në varrim kishte edhe qytetarë, që nuk ishin besimtarë e që u bënë dëshmitarë

të një bashkësie besimtarësh të krishterë. Ata u ndanë, jo vetëm me kujtimin për nderimin e figurës së pastër morale, që iu bë një besimtari të devotshëm si Ligori, por mësuan shumë për vlerat e këtij komuniteti. Ceremonia e varrimit u komentua dhe u ruajt gjatë në memorjen e pjesëmarrësve të qytetit të Korçës. Për besimtarët e krishterë ungjillorë, ajo ishte një dëshmi bashkimi. Fjalët, që u thanë në këtë rast nuk kishin të bënin vetëm me njërin nga njerëzit, që sakrifikoi e mbijetoi në diktaturë, por me njeriun, që besimin e rinisë së vet e ktheu në një realitet. Ishte ngritur kisha ungjillore me veprimtari dhe anëtarësi, që premtonte shumë, që në fillimet e saj.



Koço Tili

Fjala e Koço Tilit, bashkëmoshatar e mik i vjetër i tij e i besimit, e mbajtur në këtë rast.

Të dashur vëllezër e motra besimtare, të dashur miq, dashamirës e farefis i të ndjerit Ligor. Trupi i tij ndodhet këtu para nesh, por shpirti i tij i pastër, tani ndodhet në duart e krijuesit të tij, Zotit. Ligori qysh në moshën tetëmbëdhjetë vjeçare hyri në rrugën e besimit. Që në atë moshë të re, ai pranoi në zemrën e tij Jezu Krishtin, si Zot e Shpëtimtar të jetës së tij. Me jetën me veprimtarinë e tij u bë një shembull për rininë e asaj kohe. Ai kishte një dashuri të madhe për Jezu Krishtin dhe sakrifikoi çdo gjë për të përhapur fjalën e Zotit, dhe jo vetëm në Korçë, por në shumë fshatra për rreth, bile edhe më larg, kudo që ndodhej. Ai në rini u vu në provë, sepse autoritet e asaj kohe e internuan pa shkak, pa asnjë arsye, vetëm e vetëm sepse ishte besimtar. Por Ligori diti, që edhe këtë kohë internimi ta shfrytësojë duke ndarë Biblën, Fjalën, duke perdikuar Ungjillin, Lajmin e Mirë.

Edhe pas internimit, ai me shokët e tjerë bashkëbesimtarë nuk e ndërpreu punën për ungjillizimin, por ndodhej kudo, ku e kërkonin Fjalën. Ai e kaloi këtë sprovë me dinjitetin e një besimtari të vërtetë. Ligori u bë shembull i një dishepulli të vërtetë të Jezu Krishtit për shumë të rinj të asaj kohe dhe deri më sot. Edhe gjatë atyre viteve të vështira ai nuk u thye, nuk u mposht, nuk e braktisi besimin e tij pavarësisht nga propoganda antifetare. Ai ishte i bindur se RRUGA, E VËRTETA DHE JETA, janë në Krishtin Jezus, shpëtimtar dhe me këtë besim dhe bindje te Zoti, ai rriti dhe edukoi edhe gjashtë fëmijët e tij. Ai i ushqeui e mëkoi me dashurinë për Zotin dhe njëri - tjetrin.

Ligori ishte njeri punëtor, ai ishte i ndershëm, i sjellshëm e fisnik. Ai ishte aq i dashur edhe gojëmbël me cilin do që takohej

e kishte marrëdhënie. Në çdo shtëpi ku hynte për të punuar ai rrezatonte dritë e mirësi. Ndonëse jeta e keq trajtoi ai nuk u dorëzua. Humbja e bashkëshortes ishte një goditje për të. Ai e donte aq shumë gruan e tij të dashur, e kishte aq shumë nevojë për të, por Fryma e Perëndisë i ishte pranë. Ajo e ngushëlloi edhe inkurajoi. Në momente të vështira ligështimi, ai këndonte një këngë të krishterë, të cilën e kishte shumë për zemër: “Ç’mik na është Jezu Krishti”. Ja dy strofa të këngës.

Ç’mik na është Jezu Krishti!

Në çdo rast ai na mbron.

Ç’privilegj t’i shpiem Zotit

Çdo gjë zemrën na lëndon.

Oh, ç’gëzim shumë herë largojmë!

Oh, ç’mundime heqim kot!

Vetëm s’e s’ja bëjmë të njohur

Me lutjen tonë Jezu Krishtit.

Xha Ligorin këtë njeri të dashur e fisnik nuk do ta shohim këtu mes nesh, do të na mungojë. Do të na marrë malli për buzëqeshjen e tij, për fjalën e tij të ëmbël. Do t’u mungojë të rinjve, që e deshën si një at’, si një baba, si një udhëheqës shpirtëror edhe që sot ata ndiejnë mungesën e tij. Ai e kaloi këtë jetë të shkurtër për të fituar jetën e amshuar.

Të dashur vëllezër, të dashura motra! Le të ndjekim shembullin dhe rrugën drejt Zotit ashtu siç e ndoqi Ligori ynë.

Korçë, më 20 shkurt 1995.

Në ceremoninë mortore morën pjesë për të ndarë dhimbjen me ne përfaqësuesi i Aleancës Ungjillore Evropiane Mark Tedder, sekretari i VUSH Zefjan Nikolla dhe misionari Xhon Kuanrudi etj. Gjithashtu morrën pjesë edhe disa përfaqësues të kishës ortodokse të qytetit. Do ta ndienin shumë këtë dhimbje e do të gjenin forcë në lutje e adhurim tek Perëndia edhe pastorët e kishës së Korçës; Lerri e Dana, Jeni e Karolona, Shirli etj. të cilëve ai u ishte bashkuar në veprimtarinë e tyre për realizimin e ëndrrave të tij. Tani, ata kishin kishën e tyre e një besim të lirë. Në zemrat e të gjithëve do të ishte i gjallë shembulli i tij.

Në shtëpinë tonë për disa vite jetoi Margaret Rid. Ja si do të shprehej ajo për të, në ato ditë: - “Ligori e njihte shumë mirë Fjalën e Zotit. Ajo ishte themeli i jetës së tij. Unë mësova shumë duke biseduar me të dhe duke vënë re qëndrimet e tij të urta e të durueshme ndaj problemeve të jetës.

Qëndrimi pranë Ligorit më ka bërë shumë mirë, sepse kam zbuluar në mënyrë reale, që pasuria e njeriut nuk përbëhet nga gjërat materiale, por nga njohja e Fjalës së Perëndisë dhe bindja ndaj saj. Dashuria, gëzimi, durimi, mirëdashja, mirësia, besimi, zemërbutësia dhe vetëkontrolli rriten dhe zhvillohen në mes të provave të jetës”.



Në shtëpinë tonë për disa vite jetoi Margaret Rid (në mes)

Besimi në Zot dhe rilindja shpirtërore është rruga më lehtë për një shoqëri, që kishte marrë goditje dhe vuante nga plagë të rënda. Jeta e Ligorit ishte shembulli i besimtarit, që mund të ndiqej. Me fjalët e këngës së tij të preferuar u bashkuan zërat e të gjithëve. Aty thuhej se Miku, që atë nuk e braktisi edhe atëhere kur të tjerët e lanë, ishte Jezu Krishti. Ai ishte drita prej së cilës duhet të merrnin dritë, për ta bërë më të lehtë jetesën mbi dallgët e kësaj bote mëkatare.

Kemi ngasje dhe mundime?

Jemi mbushur me hidhërim?

Le t'ja bëjmë të njohur Zotit,

Na dhuron Ai paqtim.

Mund të gjëjmë mik të tillë?

Tjetër mik si Zotin Krisht?

Jo! Pra zemrën hap, tregoi!

Ç'të mundon, ty kotësisht.

Në je rëndë i ngarkuar

Edhe barrën nuk mban dot

Ngri lart sytë, vështro Zotin

Veten mos mundo më kot.

Të mërzhitin njerëzia?

Nuk të mbeti mbi dhe një mik?

Thuaja të gjitha Zotit

Ai është mik besnik.

Ndarja me njeriun tonë të dashur s'mund të ishte ndryshe. Bashkim, reflektim, lehtësim. Të gjithë nëpër këtë rrugë kemi për të shkuar dhe nuk do të jemi të vetëm.

Pastor Majku mes të tjerash në fjalën e tij do të kumtonte:

“Zoti është bariu im, asgjë nuk do më mungojë. Ai më çon në kullota me bar të njomë, më prin tek ujërat e qeta. Ai ma përtërin shpirtin, më prin nëpër shtigjet e drejtësisë për hir të emrit të tij. Edhe sikur të ecja në luginën e hijes së vdekjes, nuk do të kisha frikë nga asnjë e keqe, sepse ti je me mua; shkopi yt dhe thupra jote janë ato, që më japin zemër. Ti shtron para meje tryezën në prani të

armiqve të mi; ti vajos kokën time me vaj; kupa ime po derdhet. Me siguri pasuri dhe mirësi do të më shoqërojnë në gjithë ditët e jetës sime dhe unë do të banoj në shtëpinë e Zotit ditë të gjata.

Bibla: Psalmi 23 i Davidit:

Këto ishin fjalët, që po e shoqëronin përndritjen e dheut nën rrezet e bekuara të diellit të shkurtit, për të përciellë Ligorin në jetën e amëshuar e të pasosur.

Njerëzit po ndaheshin me vëllanë, shokun, mikun, inkurajuesin, ngushëlluesin, të krishterin xha Ligor.

Me vdekjen e tij, - do të theksonte pastori i kishës së tij, Mike Brown kemi humbur, jo vetëm një shok e vëlla në Krisht, i cili ishte shumë i dashur, por një shtyllë të kishës dhe të Ungjillit në këtë vend. Ai e kishte dëgjuar Lajmin e Mirë rreth 60 vite më parë nga misionarët e huaj në Korçë. Dihet se fillimisht kjo punë është nisur nga Gjerasim Qiriazi në vitin 1891. Por dihet se kundërshtimet ndaj veprimtarisë ungjillizuese në fillimet e viteve 1900, ishin në rritje. Në këto kushte është marrë vendimi për të ftuar misionarë amerikanë në Korçë. Me shpresë se një lidhje e tillë do ta forconte veprimtarinë dhe do të ofronte mbrojtje ndaj atyre, që donin t'i jepnin fund këtyre veprimtarive ungjillizuese. Në vitin 1908, Phineas Kenedi dhe gruaja e tij u bënë misionarët e parë të huaj, që u vendosën në Shqipëri. Në vjeshtë të vitit 1908 dhe për t'u larguar pak muaj më pas në Elbasan, erdhën Telford Eriksonët. Ndërsa Edvin e Dorothia Zhejks do të vinin në vitin 1932. Kenedi themeloi në Korçë një shkollë për djem, në atë vend, që sot njihet si "Kodra e Kenedit". Kurse Xhejksi, që e njihte mirë gjuhën shqipe i përqëndroi përpjekjet e veta në veprimtarinë e kishës dhe të ungjillizimit. Këta njerëz patën ndikim të madh tek Ligori në rritjen e tij si besimtar i ri. Bashkë me djem të tjerë të moshës së

tij, ai punoi pranë Edvin Xhejksit. Nga fundi i viteve 1930, Kisha Ungjillore në Korçë, kishte mbi një qind anëtarë të rritur dhe një program për fëmijët, që ndiqej nga qindra njerëz çdo javë.

Si ungjillor, Ligor do të lidhte të sotmen me të kaluarën, ndërkohë që pasonte stafetën e besimit duke e transmetuar ungjillin nga brezi i vjetër në brezin e ri.

Pas rënies së komunizmit në vitin 1991, ai e priti me shumë gëzim mundësinë për të shpallur haptazi ungjillin e Jezu Krishtit. Së bashku me kishën e rithemeluar të Korçës, ai filloi të predikojë përsëri duke dëshmuar pa frikë për fuqinë jetëndryshuese të ungjillit.

Si drejtues i dalluar dhe shembull i besimit të patundur në Jezu Krisht, Ligor Çina shërbeu si drejtues në Kishën e Korçës. Në qershor të vitit 1993 në Kongresin rithemelues të Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë, ai u zgjodh njëzëri President i parë i saj. Pas kësaj, ai do t'u shprehej shokëve: “Eh, tani në pleqëri, duhet të punojmë më shumë për Perëndinë, sepse Jezu Krishti është i gjallë dhe koha po afron.” Përmes jetës dhe dëshmisë së tij shumë njerëz përjetuan hirin e Perëndisë. Asnjëherë dhe as ndonjërit, ai nuk i tha një fjalë të rëndë apo të vrazhdë dhe u bë për ta shembëlltyra e Jezuit, duke folur me fjalët e tij. Gjithë jetën do të punonte si një punëtor i thjeshtë. Por ndikimi i tij në Korçë ishte i madh. Zoti, Perëndia bën këtë premtim.

“Ashtu si shiu dhe bora zbresin nga qielli dhe nuk kthehen prapa pa vaditur tokën, pa e bërë pjellore, pa bërë që të mbijë në mënyrë që ai që do të mbjellë të marrë farën e të sigurojë bukën për të ngrënë, kështu do të jetë fjala ime e dalë nga goja ime. Ajo nuk do të kthehet bosh pa e kryer atë, që dëshiroj dhe pa e realizuar plotësisht atë për të cilën e dërgova.”

Isaia 55: 10, 11

Premtimet e Perëndisë janë të sigurta. Fjala e Mirë, që Zoti foli në këtë vend më shumë se një shekull më parë, përmes njerëzve si Gjerasim e Gjergj Qiriazi e të tjerë dhe që vazhdoi në brezin e Ligorit e po vazhdon edhe sot e do të vazhdojë me brezat e besimtarëve të rinj, derisa dëshira e Tij të përmbushet dhe qëllimi i Tij të arrihet.

Këshillat e tij

“ Ne duhet të jemi më të shpejtë për të dëgjuar dhe të ngadaltë për të folur”, - kujton mbas njëzet vitesh, fjalët e tij Karolina. Vërtet Ligor ju mungonte fizikisht, por jo përvoja e shembulli i tij. Ai nuk kritikonte, por vetëm këshillonte. Ai nuk thoshte kurrë unë, por Zoti. Jeta dhe veprimtaria e kishës nuk mbyllej vetëm me studimin e Biblës. Vazhdonin përpjekjet për ta zgjeruar rrethin e pjesëmarrësve, kujdeseshin që të mos i trajtonin me mendjemadhësi anëtarët e rinj e të thjeshtë të kishës. Shpesh ai u tregonte për gëzimin, që kishte ndierë bariu i njëqind deleve, kur gjeti delen e humbur e të shkëputur prej të tjerave. Gëzimi ishte më i madh për delen e gjetur se sa për nëntëdhjetë e nëntë delet e mbetura. Secili besimtar është pjesë e kësaj harmonie, asnjëri prej tyre s’duhet të humbte rrugën. Edhe plangprishësit nuk duhet të braktisen. Të qenit vëllezër në Krisht do të thoshte më shumë se një shoqëri. Më të rinjtë duhet të ndienin respekt për besimtarët më të vjetër. Por edhe shqetësim për problemet që mund të kalonin. Kujtoj Arjanin Larashin, Nikon dhe Monda Treskën, e të tjerët, vajza e djem, që sa herë babai ishte i sëmurë do t’i qëndronin pranë për të na ndihmuar edhe ne pjesëtarëve të familjes së tij. Jo vetëm

me fjalën e ngrohtë, por edhe me shërbimin. Ata, si të ishin bijtë e tij do t'i shërbenin dhe do të përkujdeseshin si për babain e tyre. Sa forcë na dhanë këta njerëz të mrekullueshëm! Ndihehim si pjesëtarë të një familje të madhe. Kërkonim t'i bëhej gjithçka, pavarësisht se nga dita në ditë gjendja po rëndohej. Kishin kaluar shtatëmbëdhjetë vjet nga vdekja e mamasë dhe babai për ne ishte shembulli i durimit e i sakrificës. Ai na i kishte lehtësuar dhimbjen e mungesës së saj. Pyetjes së motrës së vogël, Mimosës (atëhere njëmbëdhjetë vjeç),

- Kur ti, babi na thua, që Zoti është kaq i mirë, pse na i mori mamane tonë kaq të re edhe me shpirt aq të bukur?! Ai do t'i përgjigjej duke i thënë, *se Zoti në mbretërinë e tij nuk do vetëm pleq e të liq, por edhe të rinj e të bukur si ajo në shpirt. Ajo, tani është e lumtur në shtëpinë e tij, në parajsën e tij*. I afërt me shqetësimin e përhershëm të prindit për të mos na munguar asgjë, si në kuptimin material dhe shpirtëror. Ai ishte paqja dhe shembulli i përkushtimit familjar në mirëkuptim e dashuri. Fjala dashuri tek ai ishte e shenjtë. Ai e falte atë në çdo moment, me mirësinë që buron prej saj pa çmim. Ne jemi një familje e madhe, e bekuar. Gjashtë fëmijë, katër djem dhe dy vajza. Të gjithë të martuar. Ligori ishte gjyshi i dhjetë nipërve Josifit, Jorgos, Enit, Vasjanit, Kristit, Johanit, Stivit, Tomit, Grigorit e Andreas dhe tre mbesave Herisit, Donikës e Sofias. Dëshironte të gjithë t'i kishte pranë edhe të na mblidhte së bashku në tavolinë, siç thoshte shpesh “sa është babai gjallë”. Dhe i bekonte me mirësi ditët tona. Sa shumë dashuri ka mbajtur ajo shtëpi e vogël! Kush s’e ka ndryshuar rrugën dhe s’ka ardhur aty!? A të gjejë kohën për ty kthyer tek ajo! Kujt s’i ka shijuar një pjatë gjellë, që shtrohej dhe hahej mes atij muhabeti të shtuar dhe s’të bëhej të ngriheshe!? S’e bollëku nuk ishte vetëm ajo që hahej, por ajo që dëgjoje! Njeriun s’e tregon ajo çfarë fut në gojë, thoshte shpesh ai, por e nderon *çfarë fjalë nxjerr prej saj*. Sa të vogla dhe të pa rëndësishme janë qefmbetjet dhe meritë, që të brejnë shpirtin

përpara asaj drite, që ai na bekonte nëpërmjet shembëlltyrave të Biblës, që ishin bërë filozofi e jetës së tij.

“Mos gjykoni që të mos gjykoheni.”

“O hipokrit, hiqe me parë trarin nga syri yt, dhe pastaj shiko qartë për të nxjerrë lëmishten nga syri i vëllait tënd.”

Bibla: Mateu 7: 1-5,

Lum ai që i dëgjon dhe i beson fjalët e Biblës. Lum ai që fal. Paqja dhe dashuria do të mbretërojë për ta. Dhe kur diskutonte për fjalën e Biblës e dashurinë që rrjedh prej saj, ai do t’na thoshte, se dashuria, që predikonte Bibla është shumë më shumë se të duash veten, gruan, duhet të duash tjetrin. Ke dy këmishë, njëren fale. Të ranë në njëren faqe, ktheje të të godasin edhe faqen tjetrën. Falur për çdo gjë, merak për asgjë. Çdo njeriu ia jepte këto mësimë në mënyrë të veçantë, atëhere kur i nevojiteshin në momente të vështira, por edhe të gëzuara të jetës. Me thjeshtësinë e një këshilluesi të mençur e praktik, ai dinte dhe ishte i mirëpritur nga të gjithë. Nuk mburrej, nuk fliste për veten. Heshtja fliste me modelin e prindërimit në një familje të madhe, që nuk i mungonte lumturia.

Çdo njeri duhet të jetë i shpejtë në të dëgjuar, i ngadalshëm në të folur dhe i ngadalshëm në zemërim. Dua je të afërmin tënd si veten tënde. Perëndia i zgjodhi të varfërit e botës, që të jenë të pasur në besim dhe trashëgimtarë të mbretërisë që ua premtoi atyre që e duan. Ç’dobi ka në se dikush ka besim, por nuk ka vepra, në qoftë se nuk ka vepra është i vdekur në vetvete. Nga e njëjta gojë del bekimi dhe mallkimi, nuk duhet të ishte kështu. Mos vallë burimi nxjerr nga e njëjta vrimë ujë të ëmbël e të kripur... mundet të bëjë fiku ullinj ose hardhia fiq? Kështu asnjë burim nuk mund të japë ujë të kripur dhe të ëmbël. Por urtësia që vjen që nga lart, së pari është

e pastër, pastaj paqësore, e butë, e bindur, plot mëshirë dhe fryte të mira, të paanshme dhe jo hipokrite.


Bibla: Letra e Jakobit

Ligori ishte një njeri punëtor dhe i thjeshtë. I donte njerëzit pa i diferencuar, duke i pranuar me të mirat dhe gabimet e tyre. Rrallë mund të gjesh njeri, që të jetë mik i të gjithëve. Dhe nuk ishte e vështirë ta bëjë mik. Ai ta hapte zemrën e të linte vend në të. Rrugën për në zemrën e tij, ta hapte singeriteti, që vihej re në modestinë prezantuese. Ëmbëlsia e fjalës së tij buronte prej besimit në krijuesin e gjithësisë. Asgjë nuk mund të ekzistojë jashtë rregullave të ndërtuar prej tij. Ligji i shenjtë ishte kodi i perceptimit të jetës së tij. Ai së bashku me shumë të rinj korçarë të viteve 1930 - 1940 kishin ndjekur predikimet e misionit dhe ishte i edukuar në besim ungjillor. Pas vitit 1940, kujton Kristaq Treska, ne vazhduam të mblidheshim nëpër shtëpitë e besimtarëve. Në këto takime Ligori na inkurajonte e na thoshte, se do të vijë dita, që besimi do të jetë i lirë e ne do të çlirohemi shpirtërisht nga zgjedha e Satanit. Prandaj fillimin e ushtrimit të fesë mbas viteve 1990 e priti me gëzim të veçantë së bashku me miqtë e tij. Erdhi koha të ngremë kishën tonë, do të shprehej me gëzim. Ai besonte në jetën e besimtarit dhe kulturimit në fe, sidomos të brezit të ri. Sa dëshironte të ishte edhe më i ri! Që të punonte sa më shumë në kushtet e reja, që u krijuan nga liria e ushtrimit të besimit. Karolina do të kujtonte se, kur kishin vajtur në një fshat të Pirgut për të predikuar ungjillin, disa njerëz, makinën e tyre e kishin goditur me gurë. Ligori kishte qënë edhe më parë aty, edhe e njëjta gjë kishte ndodhur, por nuk u kishte treguar vetëm e vetëm për të mos u tërhequr e provuar përsëri. Edhe në një prezantim në rrugët e Maliqit të disa posterave të kishës të tyre, kur e pyetën si shkoi veprimtaria, ai u përgjigj:

- Rruga e dashurisë për te Krishti shkon përmes zemrës. Në rrugë kalojnë si njerëzit e mirë edhe njerëzit vesellinj. Zoti e di kur duhet të hyjë në derën e zemrës së tyre.

Ai nuk tërhiqej nga vështirësitë. Kjo i kishte dhënë kuptim jetës së tij, prandaj e shpallte Krijuesin kudo dhe me këdo. Sot, ata ishin shumë. Me të në këtë rrugë po ecnin të lirë për ta besuar dhe ushtruar Kristaqi, Koço, Niko e Monda, Vangjo, Irena, Olgeri, Çimi, Marinela, Elida, Polikseni, Ilda, Liria dhe qindra e qindra të tjerë. Historia e re e jetës së tyre po shkruhej tani. Për Berti Theodhosin, pesha e viteve të rënda të burgut politik, që jeta ia kishte sevitur në moshën më të bukur, në vitet e rinisë, do të ishte tashmë një kujtim i largët. Ai nuk ankohej më për to, por me sytë, që i shndrrisnin nga një lumturi e brendshme e ndiente veten të rilindur në këtë komunitet të ri. Falë Zotit, ai kishte një jetë të re mes miqve të rinj, vëllazërisë në Krisht. Ai kishte gjetur balsamin e plagëve të tij në adhurim e lutje, I papërtuar do të gjendej kudo. Në ndërtimin e shkollës në Progër, në predikimet në Vloçisht e Libonik. Jeta e lirë, që po jetonte linte pas errësirën shpirtërore dhe ua mbushte me gëzim edhe jetët e të tjerëve.

Kjo ishte jeta e besimtarëve, që Ligor e kishte ndierë shpirtërisht dhe jetuar denjësisht. Ai ishte gjithnjë në lëvizje e i gatshëm duke i nxjerrë shpesh edhe punë vetes. Kur i thoshim, babi mos u lodh, mjaft punove, se tani do të punojmë ne për ty. Ai me buzën në gaz na përgjigjej: - “Vetëm kur të zë shtratin do të kuptoni e do të më thoni. Babai nuk do të jetë mirë”. Dhe kishte të drejtë. Asgjë s’e gjen njeriun nga puna e qëllimet e mira që e udhëheqin. Kjo është jeta. T’i përgjigjesh asaj atje, ku e ndien se e bën më mirë.



Ligori dhe Berti duke suvatuar në shkollën e Progërit



Çast pushimi mbas studimi biblik në Ersekë

Jeni zemërgjërë deri në ardhjen e Zotit. Ja bujku po pret frytin e çmuar të tokës dhe e pret atë me zemërgjërësi derisa ajo të marrë shiun e parë dhe të fundit.

Bibla: Letra e Jakobit

Për besimtarin ka kuptim, jo vetëm jeta por edhe vdekja.

Jezui tha: "Zemra juaj mos u tronditë. Besoni në perëndinë, besoni në mua! Në shtëpinë e Atit ka shumë banesa, përndryshe do t'jua thoja: - Unë po shkoj t'ju përgatis një vend. Dhe kur të shkoj e t'ju përgatis një vendin, do të kthehem e do t'ju marr pranë meje, që aty ku jam unë do të jeni edhe ju."

Bibla: Gjoni: 14: 1- 3

Jezuesi ka thënë " *Unë jam udha, e vërteta dhe jeta*"

...Ishin momentet kur ai po i jepte kuptim ekzistencial edhe vdekjes së vet. Ai ishte formuar në shpirt si besimtar dhe trupi i tij si pjesë e kësaj jete të përkohshme do të pavdekësohej në frymën e përjetshme të Krijuesit të tij. Ai ndiehej i shpëtuar dhe i falur në Hir, prej Hirit të Zotit kishte jetën e pasosur. Me përunjësinë e modestinë që e karakterizonte, ai të frymëzonte.

Bibla për të ishte libri më çmuar dhe i tillë duhej të jetë për çdo njeri. *Ky libër është i pari dhe i pazëvendësueshmi me libra të tjerë.* Ishin fjalët e kthjera në veprim prej tij. Sa herë do t'u shpjegoja nxënësve të mi, se Evropa moderne mbështetet në tri shtylla të rëndësishme: Bibla, Karta e Drejtave të Njeriut dhe veprat e pavdekshme të Shekspirit. Me sytë e mendjes do të isha me ty baba i dashur, me historitë e Biblës që ti m'i tregoje në ato vite, kur nuk mund të flisje hapur për botëkuptimin fetar. Ato do të ishin jo vetëm çelësi për t'i zbërthyer e interpretuar këto vepra, por edhe ekuilibri që na mbron e drejton në jetë. Jo rrallë herë kemi debatuar për dilemat filozofike të kohës sipas klisheve ateiste, që mësonim në

shkollë. Ndërsa ti, thjesht me pak fjalë u përgjigjeshe pyetjeve tona me shembëlltyrat biblike, universaliteti i të cilave u flet të gjithë kohërave. Ishin këto histori, që më bënë të kuptoja thellësinë e simbolikës së lirikës politike të Nolit, si misionar politik në vargjet e pendesës për “Moisiun në mal”, apo “Shën Pjetrin në mangall” si edhe në vepra të tjera të tij me motive biblike. Nuk mund të interpretohej Dante Aligeri pa njohur doktrinën e krishterë në veprën e tij të madhe “Komedia hyjnore”. Udhëtimin e tij imagjinar në botën e përtejme, synonte të arrinte përsosmërinë morale, përmes përsosmërisë hyjnore, duke u bërë klasifikuesi i veseve të bashkëkohësve të tij dhe theksuar domosdoshmërinë e ripërtëritjes shpirtërore të njeriut. Të pakta këto vepra, që së bashku me autorët e vjetër të letërsisë shqipe trajtonin tematike biblike, atëhere kur unë e bashkëmoshatarët e mi merrnim një edukim formal e ateist. Ishin këto ide e argumenta, që më motivuan për ta përjetuar me humanizëm e drejtësi këtë jetë dhe ushtruar me profesionalizëm mësuesinë si një përtëritje dhe përgatitje shpirtërore e brezit të ri. Ai shpesh do t’u thoshte të tjerëve, se fëmijët e mi janë Krisht në shpirt. Ligori nuk na imponohej me fjalë, por me veprimet e tij. Përveç familjes, ai kishte edhe një familje të madhe, atë të vëllazërisë në Krisht. Edhe unë, ju këshilloj ta lexoni Biblën, do të porosiste të rinjtë, në intervistën e parë dhe të fundit, të dhënë në gazetën: “Letra e Vëllazërisë” organ i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë në numërin e saj parë.

Intervistë dhënë më Shkurt 1994

Ligor Çina

President i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë.

*Sikur të isha ca më i ri, do të vazhdoja të shpërndaja Ungjillin
nëpër fshatra.*

*Megjithë përndjekjet dhe presionet e vazhdueshme, për 57
vjet ai e ka ruajtur të pastër besimin e tij te Jezu Krishti dhe ka ndierë
gjatë gjithë jetës praninë, mbrojtjen dhe dashurinë e Shpëtimtarit.
Sot, në moshën 74 vjeçare z.Ligor Çina është President i Vëllazërisë
Ungjillore të Shqipërisë. Dëshmia e tij është frymëzuese dhe nxitëse
për të gjithë, për ata që e kanë gjetur rrugën e shpëtimit dhe për ata
që vazhojnë të enden në errësirë.*

Në intervistë ai do të dëshmonte:

“Kam lindur në vitin 1920, në fshatin Boboshticë. Babai im punonte në Korçë dhe kur isha katër vjeç na mori edhe ne. Në vitin 1930 në misionin ungjillor, që ishte në Korçë, punonte një misionar amerikan, z.Kenedi. Nën drejtimin e tij, ky mision jo vetëm predikonte ungjillin, por ndihmonte e përkrahte edhe mësimin e gjuhës shqipe, që shqiptarët të shkolloheshin në gjuhën e tyre dhe ta lexonin ungjillin në shqip. Ndihmesa e zotit Kenedi për predikimin dhe leximin e Biblës ka qënë shumë e madhe, jo vetëm në Korçë, por edhe në fshatra përreth, por edhe në qytetet Ersekë e në Bilisht etj. Në atë kohë unë isha në moshë shumë të vogël dhe mbaj mend, se kishte një shkollë të së dielës në të cilën shkonim ne

fëmijët. Atje na jepnin mësim besimtarët e misionit ungjillor. Çdo të dielë ne shkonin atje dhe mësonim pjesë nga Bibla.

Ka qenë viti 1937, kur unë u bëra besimtar dhe e pranova Jezu Krishtin si Shpëtimtarin tim. Ajo ditë më kujtohet shumë mirë. Isha shumë i gëzuar, sikur fluturoja, sikur isha bërë me të vërtet njeri i ri, ashtu siç thotë Bibla. Ky hap, që bëra në atë kohë më ka ndihmuar shumë në jetë, sepse ajo është e mbushur me probleme, shpirtërisht unë kam qenë shumë i lumtur.

Për disa vjet me radhë ne kemi punuar me misionarët e misionit ungjillor, në mënyrë të veçantë me zotin Edvin Xhejks. Ne shkonim nëpër fshatra e rrethe të ndryshme dhe shpërndanim literaturë ungjillore. Këtë punë e vazhduam edhe pas vitit 1940, vit kur zoti Xhejks iku në Amerikë. Bashkë me Nasi Lubonjën, i cili ka rreth dhjetë vjet që ka ndërruar jetë, kemi shkuar fshat më fshat duke shpërndarë literaturë shpirtërore. Atëhere kishim pak literaturë. Kishim katër Ungjijtë: Mateun, Markun, Lukën, Gjonin, si edhe Dhiatën e Re të plotë. Me Nasin kemi vajtur deri në Derviçan të Gjirokastrës duke çuar Lajmin e Mirë. Në çdo fshat që shkonim, përveç shpërndarjes së librave, ne dëshmonim për Jezu Krishtin. Çdo ditë këtë punë bënim. Sot ndodheshin fjala vjen në Boboshticë, të nesërmen shkonim në Dardhë, të pasnesërmen në një fshat tjetër e kështu me rradhë, derisa të arrinim në Derviçan. Disa na pranonin, disa edhe nuk na pranonin. Aty ku nuk na pranonin, bënim ashtu siç thotë Jezui, *shkundnim pluhurin e këmbëve*, si dëshmi për ta.

Puna, që kemi bërë për të shpërndarë Fjalën e Zotit nuk ishte e lehtë. Disa herë kemi patur edhe pasoja. Më kujtohet kur na internuan në Tiranë. Ishim në fshatin Bradëvicë, katër shokë. Pasi ndamë Biblën filluam t'u flisnim fshatarëve për ikonat. U thamë se ikonat nuk janë gjë tjetër veçse figura, të cilat nuk ka

pse t'i adhurosh. Bibla nuk na mëson t'i adhurojmë ikonat. Prifti i fshatit u zemërua dhe lajmëroi Dhespotin në Mitropoli. Në kohën e Zogut, Dhespoti kishte fuqi dhe i dëgjohej fjala. Kështu na morën mua, Koci Treskën, Gaqo Xoxin dhe Nasi Lubonjën e na internuan në Tiranë.

Atje na mbyllën në një dhomë të vogël dhe nuk na pyesnin fare. I luteshim vazhdimisht Zotit, që me ne të bëhej dhe vullneti i tij. Në atë qeli gjetëm edhe një që vuante nga nervat. Ai thërriste nëpër qytet, prandaj e kishin mbyllur në burg. Ne luteshim edhe për të. Në atë dhomë ndenjëm rreth njëzet ditë, dhe sa ishim atje, ai nuk dëgjohej të thërriste. Lutjet, që ne i drejtonim Perëndisë e ndihmuan edhe atë, aq sa shefi i policisë na tha:

- "Si u bë, që ky nuk po thërret më?"

Duke iu lutur Zotit vazhdimisht, pas disa ditësh na liruan nga burgu, por na mbajtën të internuar në Tiranë. Duhej të paraqiteshim në polici çdo mëngjes. Për të jetuar na duhej të zinim ndonjë punë çfarëdo. Nuk dinim ç'të bënim dhe i luteshim Zotit të na ndihmonte. Me vete kishim disa libra shqip, Dhiatën e Re, të katër Ungjijtë, si edhe Zanafillën e ndonjë tjetër nga përkthimet e Kostandin Kristoforidhit. Vendosëm të kërkonim leje për të shitur librat. Në polici ishte një prift, që i pa librat dhe nuk foli keq për ne ungjillorët, por i tha shefit se ato ishin libra të kishës.

Kështu na dhanë leje për t'i shitur. Atëhere morëm një tavolinë dhe zumë një qoshe mu në qendër të Tiranës. I kërkuam z.Xhejks që të na dërgonte libra të tjerë, Dhiata e ungjij nga Korça. Dhe ai na dërgoi. Vinin njerëz e blinin, por edhe ne shkonim nëpër kafenetë e klubet e Tiranës e shpërndanim ungjij. Kur ishte ditë pazari shkonim edhe në Pazar. Kjo na kënaqi shumë, sepse bënim punën e Zotit, shpërndanim Fjalën e tij, shpërndanim ungjij, të cilët populli i Tiranës i lexonte me vëmendje të madhe. Ne e

falenderonim Zotin, që ndihmon gjithmonë besimtarin. Sepse ishte në të mirën tonë, që u internuam në Tiranë, e na u dha mundësia të përhapnim edhe atje ungjillin, i cili në atë kohë ishte i rrallë. Qeveria e Zogut nuk e kishte të ndaluar shpërndarjen e literaturës ungjillore, por nuk e shihte me sy të mirë.

Vazhduam kështu gjer në vitin 1943, kur u ashpërsua lufta e ne s'kishim më mundësi të lëviznim. Megjithatë, në Korçë ne vazhdonim të mblidheshim për të lexuar Biblën e për t'u lutur. Takimet i bënim në një shtëpi të vogël, pranë asaj ku kishte qenë misioni ungjillor. Predikues kishim Koci Treskën. Pas çlirimit, edhe për disa vjet ne mblidheshim rregullisht, derisa një ditë këshilli i lagjes na blloko i dhomën, bashkë me librat dhe ato që kishim aty, dhe ne na ndaluam të predikonim. Më vonë erdhi koha, që u ndalua fare besimi. Megjithatë, ne besimtarët mblidheshim nga dy ose tre nëpër shtëpi, si punë ilegality, që të mos binim në sy të qeverisë, faleshim, studionim Biblën, këndonim ngadalë që të mos dëgjohej dhe lavdëronim Perëndinë. Ky ishte për ne një gëzim shpirtëror, sepse megjithëse Fjala e Perëndisë ishte ndaluar, Ai kishte gjetur mënyra, që ne të ushqeheshim me fjalën e Tij e ta lavdëronim.

Kur u ndërpre mundësia për të shpërndarë Biblën, fillova të punoja bojaxhi dhe këtë zana e kam ushtruar deri vonë. Si bojaxhi punoja mirë, me ndërgjegje dhe kisha shumë kërkesa, shumë klientë. Ndërmarrja më dërgonte tek njerëzit e pushtetit, se bëja punë të mirë, kishin edhe besim. Dhe kjo më ka shpëtuar që të mos internohesha. Në fakt herë pas here kisha edhe ngacmime. Njëherë po lyeja Degën e Brendshme, gjatë punës më thanë:

- *"Edhe ti Ligor je besimtar"*. Po – u thashë, – besimtar jam, por nuk bëj propogandë fetare, besimin e kam në zemër. Edhe Enver Hoxha thotë, që ndërgjegjja nuk ndalohej. Dhe kështu nuk pësova ndonjë gjë. Duke punuar mirë rrita gjashtë fëmijë. Kaloj

mirë dhe jam shumë i gëzuar, që Perëndia po më mbron në pleqëri. Them se Perëndia më ka bekuar gjatë gjithë kohës, jo vetëm kur isha i ri, por edhe kur rrita fëmijët, sepse nuk është kollaj të rritësh gjashtë fëmijë. Mirëpo fuqia e Zotit më jepte forca për të përballuar jetesën, për të punuar shumë edhe në ndërmarrje dhe privatisht.

Në kohën e Enverit nuk kam qenë në burg. Sigurisht, në atë kohë, ishte e vështirë të ruaje besimin tënd. Mësuesit ishin urdhëruar dhe i porositnin fëmijët që të gjenin çdo libër fetar, që kishin prindërit e t'i grisnin. Ata e dinin që unë isha fetar, prandaj detyrohesha ta fshija Biblën andej - kënde, herë nën jastëk, herë nën dyshek dhe e lexoja kur s'kishte njeri. Në këtë mënyrë e ruajta besimin tim. Megjithatë komunizmi e ndaloi fenë, ndërgjegjen e çdo njeriu nuk e ndaloi dot, sepse ajo na është dhënë nga Zoti. Edhe në atë kohë, ne e ndienim gëzimin e Zotit dhe ne e falenderojmë Atë që gjithmonë na gëzon shpirtërisht. Ja, ende kam një Bibël në gjuhën rumune, të cilën e kam marrë në vitin 1939. Kjo Bibël më ka ushqyer shpirtërisht. Jo vetëm më ka ushqyer, por ajo ka qenë udhërrëfyese në jetën time. Prandaj e kam e ruajtur dhe e ruaj me shumë kujdes.

Por lavdi Zotit, që ia arritëm kësaj dite të bekuar nga Perëndia, që Ungjilli i Krishtit po lexohet e po predikohet në çdo skaj të Shqipërisë. Lëvizja ungjillore tani është më e fuqishme dhe më e zgjeruar. Tani ka më shumë punë, kemi më shumë mjete, kemi edhe shumë predikues të formuar, të huaj e shqiptarë, që po punojnë në ungjillizim.

Kështu, që Fjala e Zotit tani po përhapet më shumë. Edhe këtu në Korçë e në rrethet e afërta, si në të gjithë Shqipërinë, bëhet një punë e mirë. Besimtarë të formuar, predikues të huaj e shqiptarë, shpallin ngado Fjalën e Perëndisë. Edhe Vëllazëria Ungjillore është rritur edhe ka bërë shumë përparime. Ne vazhdimisht i lutemi

Zotit, që fjala e tij të përhapet në të gjithë Shqipërinë me fuqi dhe kishat ungjillore të ngrihen kudo. Kur shikoj besimtarët e rinj, që mbushin kishat ungjillore ndihem edhe më i lumtur, sepse e ndiej, që Zoti vepron me fuqi e me dashuri dhe që brezi i ardhshëm i Shqipërisë do të jetë i lumtur. Do të jetë i lumtur, sepse do të bëhen të gjithë besimtarë, do të kenë mundësinë të lexojnë Biblën dhe të ushqehen me Fjalën e Perëndisë. Sepse kanë lirinë dhe kur ka liri, njeriu kurdoherë është i lumtur e përparon. Ata nuk ndiqen më, sepse mësojnë Fjalën e Zotit, Biblën, sepse adhurojnë Zotin dhe i lutemi atij. Prandaj i lutemi Zotit, që lirinë që kemi, ta kemi për ngahera, që populli shqiptar të kuptojë të vërtetën e Biblës dhe njerëzit tanë ta besojnë atë në mënyrë të drejtë.

Brezin e ri të Shqipërisë e këshilloj, që të bëhet besimtar, sepse atje ku është besimi dhe e vërteta, atje vendi përparon edhe njerëzit janë të lumtur, atje ka dashuri, sepse pa dashuri nuk bën dot njeriu, ka bindje sepse pa bindje njeriu nuk mund të përparojë. Prandaj kam shumë shpresë, që tani e paskëtaj në qoftë se do të besojë tek Zoti, ky brez do të ketë lumturinë e vërtetë.

Dëshira ime është që ne t'i lutemi Zotit natë e ditë, po të ketë mundësi, që të ngrejë njerëz nga Shqipëria për t'u bërë predikues dhe mësues për Shqipërinë. Dhe e falenderojmë Zotin, që dërgoi njerëz predikues nga anë e anës për të ardhur këtu në Shqipëri, që të fillojë ungjillizimi e predikimi i Ungjillit dhe të ndihmohet populli shqiptar për të besuar Jezui Krishtin. Dëshiroj, që të lutemi gjithë bashkë, që të gjitha kishat ungjillore ta kenë këtë si detyrë të përhershme, se vetëm lutja me besë dhe pa dyshim ndihmon këdo”.

Dhe këto dëshira ai i shihte të realizuara, i bindur se stafeta e brezave Ungjillore e kishte një rrugë. Nëpër të cilën kishte kaluar ai dhe do të kalonin për të shkruar historinë e përndritjes edhe të tjerët. Kjo rrugë fillon me edukimin në besim nga fëmijëria e rinia e secilit. Por cila ishte fëmijëria e rinia e Ligorit?

Pjesa 2

Po fëmijët kujt ia jep ti?

- Së pari, babait që i ngjiz, pastaj nënës që i lind, pastaj mësuesit që i edukon, pastaj qytetit që i burrëron, pastaj atdheut, që është mëma më e lartë, pastaj njerëzimit që është stërgjyshja .

- Ti nuk po flet për Perëndinë?

- Secila nga këto gradë, babë, nënë, mesues, qytet, atdhe, njerëzim është shkallarja e shkallës, që ngjitet deri tek Perëndia.

Viktor HYGO

Jeta

Ligori lindi më, 2 shkurt 1920, në fshatin Boboshticë. I përmendur për rakinë e mamit, që nxirret prej pemëve të vjetër sa vetë fshati. Boboshtica si edhe fshatrat e tjerë, Mborja dhe Drenova, janë ndërtuar në rrëzë të malit të Moravës, shumë pranë qytetit. Ato janë lagje të saj. Nga shtëpia ku ka lindur dhe jetoi katër vitet e para të fëmijësisë, nuk ka mbetur asgjë. Vetëm vija e një burimi, që shkonte mes për mes oborrit do të ishte dëshmia, që ai na e tregonte sa herë shkonim në Boboshticë si familje për Shën Mërinë tek kushëriri i tij Lipe Dhëmbi. Ai ishte fëmija i parë, që kishte mundur të jetonte mbas vdekjes së njëpasnjëshme në lindje të dy fëmijëve më të mëdhenj në familjen e Kostës dhe Parashqevi Çinës. Ardhja e tij në jetë do t'u sillte të gjithëve një gëzim të pa treguar. Familja kishte zbritur në krahinën e Korçës rreth viteve 1900. Ata, Kosta, Sotiri dhe motra e tyre Parashqevia, Xia (siç e thërrisnin shkurt) e martuar me Sterjo Bandillin, ishin shpërngulur nga fshatrat Miçan e Frashër të malësisë së Përmetit. Aty kishin qënë pjesë e një fisi të shquar, ndër të tjerash përmendeshin si rritës dhe kultivues bletësh. Pësia e kujtimeve të prindërve të tij, ia kishin krijuar Ligorit, imazhin e vendit të të parëve. Bukuritë e asaj natyre

malore, që ata i kishin lënë pas, do të mbeteshin në kujtesë si një vegim i gjallë. Ai vërtet e pohonte se ishte nga Boboshtica, por rrënjët fisnore ishin thellë në tokën e malësisë së Përmetit. Prindërit e tij kishin marrë me vete prej asaj krahine temperamentin e tyre të veçantë. Dalluar si njerëz të butë e të ndjeshëm. Përmetari i urtë e punëtor, kudo ku është shpërngulur e ka ruajtur etnozonën e tij kulturore.

Domosdoshmëria e përshtatjes në rrethinat e Korçës, në vendin pritës, s'e bënte të lehtë largimin pa kthim nga trevat e Dangëllisë. Pesha e barës së ngarkuar nëpër kafshë të asaj prokopie (mall e pasuri) të pakët, që kishin mundur të mbartnin me dhimbje prej shtëpisë, ishte e rëndë. Të rëndë e bënte rrugën pa kthim, hedhja e hapave me përpjekjen për të mos e kthyer kokën pas. Mes tokës dhe qiellit, në ditë të kthjellta e ditë me shi, mes erës e të ftohtit, të gjithë ishin të vendosur për pashmangshmërinë e kësaj ikjeje. Në ikje e në meditim, një kthim koke mund t'u kushtonte shtrenjtë. Kujtimet dhe varret e lëna pas krahëve të të dashurve ishte pengu i tyre i madh. Një dhimbje, që do të mbetej thellë në shpirt. Kthimi i kokës pas, do t'u mpinte gjymtyrët e do t'i kthente ndoshta sërish tek Miçani i ngritur mbi shkëmbinjtë e bardhë. E panjohura, që i priste në vendet e reja, do të ishte më i rëndë se pesha e çdo guri. Dhe tani në ikje ata e ndjenin se guri, rëndon vetëm në vendin e vet. Ky vend ishte Dangëllia. Rrënjët e thella të hedhura në breza, ishin kujtimet sa të gëzuara e të hidhura, që po i merrnin me vete. Shpërnguljet e emigrantëve të të gjitha kohërave dhe emigrimi kanë diçka biblike. Vetëm ata njerëz, familje apo fise, që e kanë provuar këtë lloj shtegtimi apo largimi me ngut nga vendbanimi, mund të shpjegojnë dhe përjetojnë shpirtërisht metamorfozën në rrëfimin biblik, që do t'i ndodhte gruas së Lotit, së cilës "kthimi pas i kokës, i kushtoi me shndërrim në gur kripe". Koha dhe vitet rrjedhin, plagët materiale të mërgimit shërohen

shpejt, por përjetimet shpirtërore mbeten në kujtesë. Njerëzit nuk e kanë të lehtë t'i harrojnë. Është vetë koha, që ua zgjon në rrëfimet e mëvonshme, ku secili këtë rrugëtim e ritregon me këndvështrimin e tij të tretur në nostalgji, sidomos tani në brezin tonë.

“Gjyshi im quhej Sotir Çina e nëna Frosina, më tregon Lirika , vajza e teto Dhorkës, kushërirës së parë të babait tim. Frosina ka vdekur shumë shpejt, kur mamaja ime, ishte pesë vjeç. Di që mamanë e kanë mbajtur disa vjet me radhë tetot, xhaxhallarët e dajoja. I kishin ndarë fëmijët në farefis. I mbanin me radhë, fshat më fshat, sepse i ati duhej të punonte. Kishin edhe një vëlla, Gaqin, prandaj i vura djalit emrin Gjergji. Kur u vdiq e ëma, ai ishte një vit dhe rrinin akoma në Boboshticë. Kur u rrit, ai ishte nxënës i shkëlqyer në Lice dhe studionte për farmaci e në të njëjtën kohë edhe punonte në farmacinë vapor të Korçës. Pati ngatërrim zorrësh në moshën tetëmbëdhjetë vjeçare. I shkreti djalë, vdiq. Kishin shumë vite në Korçës atëhere. Teto Sandën e dhanë në familjen e Boris Plumbit fare të vogël, që ta përgatisnin si shërbëtores. Ajo ishte dhjetë vjeç dhe u mësua. Edhe mamanë e futën në një familje, por ajo qante shumë dhe nuk u shtrua. Kështu që e morën të afërmit me radhë. Pas një jete të tërë pa komunikim me njerëzit e fisit, vazhdon Lirika Piluri, ata u rilidhën e hodhën çdo gjë prapa. E deshën dhe respektuan shumë njëri - tjetrin. Donika, mamaja juaj na lidhi me ju, shumë shpejt. Duket sikur ka rendur të përfitojë kohën e humbur si për vete edhe për ne. Merita në këto marrëdhënie është e saj, gojëmbël, nikoqire, e dashur, e qeshur. I përfytyroj të dy me xhaxhi Ligorin, duke na folur me ngrohtësi. Të bënin ta ndieje veten si në një familje të madhe. Mbaj mend, kur do të martohesha, erdhën të dy tek ne dhe pyetën se çfarë ishte më e mira për peshqeshin tim. Mamaja ime u tha, për një këmishë nate. Ajo e bleu copën dhe e qepi vete. Ishte me të vërtetë e bukur. Përmbledhja e një historie familjare, ku gjaku nuk bëhet ujë.

Si nuk po na bëhet mbarë t'i shohim shtëpitë e ato vende, ku kanë jetuar njerëzit tanë – thoshte shpesh Ligori, mbas vdekjes së nënës së tij. Ishte thirrja e të parëve. Shpërngulja e detyruar. Ishte malli i përhershëm i prindërve të tij, që ruhej në subkoshiençë dhe ia zgjonte këtë kërshtëri. Shtëpitë dy katëshe të vëllazërisë Çina, sipas teto Thomaidhës do të mbaheshin më këmbë deri vonë. Jo vetëm para Luftës II Botërore, por edhe pas saj. Ai s'pati mundësinë t'i shihte ndonjëherë e të çmallej me to, njësoj si do të çmallej me njerëzit e tij.

Hallet dhe puna. Ndoshta edhe rrugët e vështira, sepse që të vije deri në Miçan e Frashër duhej të bëje më këmbë disa orë rrugë. Mundej, veç po të nisej apostafat. Zoti nuk ia bëri kësmet. Nga fisi i babajt në Korçë, kemi shumë pak të afërm. Disa familje kushërinjsh të parë. Ruajtja e lidhjeve fisnore për brezin e moshës së tyre ishte gati e shenjtë. Ai i donte dhe i ndiqte në gëzime dhe halle kushërinjtë dhe kushërirat e tij Sandën dhe Dhorkën, Anastasinë e Elenën, Petrinën dhe Pavlinën, Stelën e Janaqin, Nuçin e Lenin, Thomain, Vangjelin, Llazarin, Nasin e Coken, Luizën dhe fëmijët e tjerë të tyre. Në brezat e sotëm nuk po ruhen lidhjet fisnore si dekada më parë. Arsyet dihen. Shoqëria e konsumit me problematikën e saj, solli individualizmin dhe lidhjet e ndërruarura të interesit.

Babai i tij, Kosta u vendos në Korçë së bashku me të vëllanë, Sotirin e Xien, motrën e tyre. Shkakui i shpërnguljes ishte një konflikt midis dy vëllezërve me të mëdhenj, që punonin si mirëmbajtës kishash në atë krahinë me disa përfaqësues të fesë muslimane. Konflikte të shpeshta këto për kohën. Mbas largimit dhe fshehjes së tyre në Greqi, ato nuk u bënë më të gjallë. Dhe nuk u mësua kurrë asgjë për ta. Ishin lutjet e grave, të cilat për të shpëtuar pjesën tjetër të familjes u detyruan të lënë shtëpitë e mallin. Ishte e vetmja rrugë për të shmangur hasmërinë dhe vrasjet. Mbijetesë.

Të mbetur në qiell të hapur e në dorë të fatit, besonin se Zoti do t'i mëshironte në lutje, adhurim e përulje, ikjen e tyre për të mos mëkatuar. Ditë e natë në udhëtim. Me sytë nga qielli luteshin për mbrojtësin e të gjithëve, Jezu Krishtin. Krijuesi i gjithçkaje, kishte në dorë të ardhmen e tyre. Ata e ndienin këtë së brendshmi, si provë të fatit të tyre. Ishte pranverë. Rrugëtonin dhe shihnin se zgjimi i natyrës ishte njëherazi edhe zgjimi i shpresave të tyre. Ata po mbartnin kryqin e vuajtjeve pa u ankuar e të bindur, se në vullnetin e Perëndisë ishte edhe fati, që shpresonin se do të gjenin me punë dhe mund. Ne punojmë dhe Zoti na ndihmon do të dëgjonim shpesh nga goja e Ligorit. Ishte filozofia e jetës e trashëguar në fisin e tij si histori njerëzore. Motoja e jetës për një njeri, që besimin e kthen në veprim. Karvani i njerëzve dhe i kafshëve nuk ishte i madh. Një familje e gjysmuar në pritje të një fillimi të ri. Diku duhet të mbështeteshin. Të huaj në vendin e tyre. Por ishin të bindur se Zoti kishte një plan për ta.

Gjyshja dhe nëna

U vendosën në fshatin Blush tek njerëzit e nënës nga babai, Nerënxa Blushit. Kujtimi i gjyshe Neranxës do të mbetet i pashlyer për Ligorin gjithë jetën. Asaj i takon sistemimi dhe fillimi i një jete të re në trevën e Korçës. Familja do kishte më në fund normalitetin e munguar. E kaluara do të tretej në tisin e historive. Shpërfillëse ndaj dobësive njerëzore, ajo nuk jepej para vështirësive. Ishte optimiste për jetën. Nerënxa administronte me dorë të fortë. Secili në familje kishte vendin e vet. Autoriteti në familje ishte detyrim edhe respekt i ndërsjellë. Dashuria më tepër se me fjalë shprehej me vepra prej saj. Ligori tregonte gjithnjë ndodhi të ndryshme për të. Disa herë jo pa humor. Njëherë, dy motrat më të mëdha të gjyshes sonë Parashqevisë, Tanka dhe Zoica, ishin nisur më këmbë, që nga Korça në Boboshticë për ta parë. Nerënxa nuk ndodhej në atë moment në shtëpi. Të lodhura nga rruga, e cila kishte zgjatur më shumë se një orë, ato i kërkuan motrës së tyre Parashqevisë, t'u bënte diçka për të ngrënë, por jo nga ato, që mund të ishin të çastit e në dorë të nuses, por nga ato që i qeveriste e zonja e shtëpisë. Jo, - u thotë e motra, - se mielli, sheqeri, vaji janë me shenjë, por Zoica, (motra e vogël) që shquhej për shkathtësinë e saj, i merr vetë masat e duhura

dhe bën shpejt e shpejt, sërish shenjën e kryqit mbi sheqer e miell. Duke justifikuar veprimin e saj me prishjen paktit, që kishte bërë nusja me vjehrrën. Rregulli dhe administrimi i mbarë dhe pa hile ishte bollëku, që i bënte në ato kohë të vështira dhe mungese, të nderohej shtëpia kur vinte njeri papritur si mik. Mbajtjen mënjane të diçkaje të veçantë e të mirë, që do të nderonte mikun, do ta ruante edhe vetë Ligori në kohën kur çdo gjë blihej me tallon (me racion). Nerënxa mishëronte për të, gruan me vullnet të fortë. Autoriteti i së cilës do të respektohej nga të gjithë, jo vetëm në familje, në fis, por edhe më gjerë në fshat. Ajo ngrihej shpejt në mëngjes e do të ishte e para tek burimi, e gratë thoshin është Nerënxa, që nuk do t'ja turbullojë njeri ujin. Përkujdesja për rritjen e nipit, Ligorit, i ka takuar Nerënxës. I përkëdheluri prej saj, aq sa të gjithë mund të ndëshkoheshim për hir të tij, edhe nusja, nëna e tij.

“Djalin, më shikoni djalin, se për të i vras të gjithë”, - do t'u thoshte shpesh ajo, duke u hokatur për Ligorin, që rritej me ledhat e saj, me këngët e saj dhe manurisej në krahët e saj. Shpesh ai kujtonte se hipur mbi kurriz, shkonte me të ndër miq dhe gosti. Prej saj do të njihte njerëz dhe do të dëgjonte histori. Erdhi Ligori, – do të thoshin gratë me të qeshur, tek sa e shihnin në derë të çapitej i kapur prej dore me të gjyshen. E fëmija do të lëshohej prej duarve të saj, drejt krahëve të shëndetshme të teto Tankë Karapataqit dhe duke u strukur në gjoks, do të kërkonte të pinte në gjirin e saj. Ligori ishte vers, bashkëmoshatar me djalin e saj, Janaqin dhe kishin pirë në një gjë, e duheshin gjithë jetën si vëllezër. Mbasi dendej mirë e mirë, sillej nëpër shtëpi, por pa trazuar e bërë rrëmujë siç e kanë zakon fëmijët. Derdhej në oborr pranë burrave të shtëpisë, Halit dhe Dhimitrit, dy baxhanakët e Kostës i kishin shtëpitë në krahë të njëri – tjetrit. Erdhi Golja, do ta përkëdhelnin ata, - punëtori i vogël. Kujtimi për këta njerëz, për Ligorin do të ishte i thellë dhe i pashlyeshëm. Në përfytyrimin tonë nëpërmjet

fjalëve të tij, ky brez vinte i veçantë me thjeshtësinë e ndershmërinë si jetuan dhe zgjidhën problemet në jetët e tyre.

Nëna e tij Parashqevia, ose Parja siç e kanë thirrur shkurtimisht të gjithë gjyshen tonë, ishte një grua e urtë, pa fjalë dhe punëtore. Gojëmbël, dinte të shmangte e zbuste nervozizmin e të shoqit, të lodhur nga rrugëtimet e gjata të qeraxhinjve dhe të administronte familjen në mungesat e shpeshta ekonomike. Jo rrallë herë, Kostës si qeraxhi, do t'i shkonin punët keq. Jo vetëm me kuajt, por dhe me tufën e bagëtive, që mbarështroi mbas shitjes së tyre në periudhën e trazuar të fillimit të Luftës së II Botërore. Dy temperamente të kundërt, Kosta dhe Parja do të ishin gjatë jetës së shkurtër bashkëshortore, një shembull ekuilibri e bashkëjetesë. Ajo u martua me të, kur ende s'i kishte mbushur të pesëmbëdhjetat dhe u rritën së bashku. Në familjen e burrit ajo kaloi adoleshencën, por edhe u bë nënë dhe grua e zonja. Kur binte fjala për vitet e para të nusërisë, nuseve të djemve të saj u tregonte shpesh, se jeta e saj filloi si një lojë. Ku më të mëdhenjtë e shtëpisë së burrit e vinin në provë, të shihnin se sa e zgjuar dhe e shkathët ishte nusja - fëmijë e tyre. Netët e dimrit ishin të gjata dhe përveç historive e përrallave që tregoheshin në familje, ajo do të provonte edhe kënaqësinë e të luajturit me gratë e shtëpisë. Të cilat sajnin sa e sa surpriza të këndshme. Jo rrallë i fshiheshin dhe ajo duhet t'i gjente. Por prej atyre, ajo ruajti bukurinë e rrjedhshmërinë e të treguarit. Me të cilat na nanuriste kur ishim të vegjël. Mbaj mend, se ajo mbulohej me një velenxën të bardhë. Të zgjedhurin e saj, kishte vëllanë e të dytë, Albertin. E mbante pranë kur flinte, sepse ai ishte i qetë dhe nuk përpëlitej natën. Këto përralla i dëgjuam e i mësuam edhe fëmijët tanë, më vonë prej gjysh Ligorit. Ai ju kërkonte të gjenin kuptimin e gjë a gjëzave, sa interesante dhe të vështira. Nuk përtonte t'i përsëriste sa herë t'ia kërkonin t'ua ritregonte. Kishte aftësinë që përralla aq të njohura, si ajo e dhelpres, që binte në qymes dhe

hante pulat, ta lokalizonte në shtëpinë e komshiut tonë Llazo Çelës, që bëhej heroi i vrasjes së dhelprave, por edhe i varjes së bishtit të saj mbi ballin e shtëpisë. Llazoja, heroi ynë, do të ishte më vonë, babai i shoqes sime të punës Vilerminit. Dhe bota e përrallës, që përvijohet para nesh, ishte reale, konkrete me ato virtyte, që duhet t'i ketë njeriu për të përballuar jetën e vrasë frikën. Tregimet me suspansin e të papriturave, si ato të nuses së Kolës, Kolevicës, burri i së cilës shkoi për gjah fshatçe, së bashku edhe me dy vëllezërit e gjyshes sonë, Stefin dhe Sifin që ishin gjahtarë të zot dhe me nam në Boboshticë. Por që s'u kthye më, se koka i mbeti në strofkën e ariut të Bozdovecit. Edhe kur u kthyen në fshat, gjahtarët e pyetën Kolevicën: - "Kishte kokë Kola, apo nuk kishte?!"... dhe ne, që mbeteshim në mëdyshje me gojën e hapur. Si mund të shtrohej një pyetje e tillë!?

Por edhe historitë për pjesëtarët e tjerë të familjes të treguar prej saj, edhe më vonë prej babait, ishin një libër i hapur për ne. Ata jetuan me thjeshtësinë e privacionet e një familjeje të sapo ardhur, në një vend ku çdo gjë duhej të fillohej nga e para me dinjitet e duke bërë një emër të mirë. Historitë e marrëdhënieve të saj me të shoqin i tregonte me plot humor dhe kanë vlerën anekdodike të gruas së nënshtruar edhe të pagojë në ato kohë, që të kujtojnë humorin therrës të Çajupit tek komedia "14 vjeç dhëndër". Kosta punonte dhe udhëtonte larg me qeraxhinjtë duke i munguar me ditë shtëpisë. Gjyshes sonë i duhej, që e vetme të përballonte rritjen e fëmijve, por edhe të ndiqte se bapet (lindje, dasmë, vdekje etj.) edhe të mos ndahej nga njerëzit. Njëherë ajo u nis për në Boboshticë, për tek vëllezërit, sepse nusja e Sifit, vëllait të saj, martonte të vëllanë. Mbasi e priti të shoqin, Kostën dhe ai s'po vinte, u nis me fëmijët në derën e babës, tek i vëllai. Duhet t'i bënte hatrin kunatës, por Kosta ndërkohë që kthyer dhe i zemëruar, që nuk e gjeti në shtëpi, u nis me inatin që e brente dhe kur arriti në dasmë iu zbraz

së shoqes. Por burrat e ftuan në tavolinë me filxhanin e rakisë së mamit përpara, shpejt inati i ra dhe dasma vazhdoi për mrekulli.

Nënë Parja jetoi gjatë. Për të vërtetuar, se në jetë njeriu ka kohë për t'i provuar të gjitha. Ishin këto dy gra, Nerënxa gjyshja dhe Parashqevia nëna, që do të ndikonin fort në formimin e Ligorit. Do të ishin të parat, që do t'i jepnin modelin e përballjes me jetën, forcën e brendshme që buron prej hirit të Perëndisë. Por, vallë është e mjaftueshme vetëm kjo? Brenda rrethit familjar ai i kishte krahët e ngrohtë dhe padyshim që e ndiente veten shumë mirë. Shpërngulja e familjes dhe vendosja e tyre në qytetin e Korçës ishte sprova, që ai ende i vogël po i kalonte me familjen. Ai po rritej dhe i duhej të hidhte hapa të sigurt në rrugën e jetës. Kjo rrugë do të niste në qytetin e Korçës si jeta e një të riu të zakonshëm, prej një familje të thjeshtë, por me ambicie për të qenë vetëvetja dhe i plotësuar.

Shtëpia e Zotit

Historia e vendosjes së familjes së tyre në qytetin e Korçës në fillim të viteve 20 të shekullit të kaluar, lidhet fillimisht me sistemimin e tyre në dy shtëpi me qira. E para, një shtëpi private në lagjen tre, diku buzë lumit të Shetros siç e thërrisin lumin e Moravës, që e ndante qytetin në dy pjesë. Pjesë që dalloheshin edhe prej besimeve fetare që praktikonin banorët. Në ujrat e këtij lumi, në pritën e parë, diku tek fabrika e birrës është bërë edhe pagëzimi i tij prej Xhejksit. Ndërsa e dyta, që shënon fillimin e kujtimeve të fëmijërisë së hershme, më të bukurat për Ligorin, lidhet me oborrin e Pjastos, që rrethohej nga shtëpi përdhese. Ato ndodheshin pranë vilës së bukur të doktor Polenës. Sotir Polena ishte mjeku më i mirë dhe më popullor i qytetit. Prej të cilit ai do të kujtonte detajet e bërjes me sukses të operacionit të apendisit, më 13 korrik 1938. Së bashku me ta, në këtë oborr jetonin edhe disa familje të tjera të varfëra, të ardhur rishtazi në Korçë, si Kokoneshët, Simakët etj. Harmonia dhe dashuria midis brezave e moshave, që u krijua në këtë oborr ishte pasuria më e madhe që ata kishin. Në këtë shtëpi, në këtë oborr siç e quante shpesh, ndau edhe humbjen e babait të tij, Kostës. Historia më tej vazhdon me ndërtimin e shtëpisë së

re, në rrugën e Bilbilave, asaj kohe jashtë vijës së verdhë të qytetit. Shtëpia u ngrit në faqen ballore të kodrës, midis kishave të Shën Thanasit dhe Shën Dëllisë. Kishte dy kate, në katin e parë dy dhoma ose soba, siç ju thonë korçarët dhomave të ndënjes. Në katin e dytë përsëri dy dhoma, koridor e ballkon. Nëpërmjet dritareve dhe ballkonit ofrohej një pamje tërësore dhe e mrekullueshme e qytetit dhe e gjithë Fushës së Korçës. Në këtë shtëpi lindëm edhe ne, katër fëmijët e parë të Ligorit. Familja jonë jetoi aty së bashku me familjet e vëllezërve të tjerë të babait, deri në vitin 1957. Vit kur u shpërngulëm dhe u ndërtua shtëpia, ku jetojmë edhe sot, në lagjen tre të Mitropolisë. Shtëpinë e rrugës së Bilbilave ai do t'ua falte vëllezërve. Për këtë bujari, ai do të kujtonte shpesh fjalët e së shoqes, Donikës: - “Zëre, se i ra zjarri dhe nuk do ta kishe, kështu ua jep më mirë vëllezërve të tu”. Ndërtesa e shtëpisë rruhet ende edhe sot, por në të nuk jetojnë xhaxhallarët tanë. Në vitin 1960 dy vëllezërit e babait, Petroja dhe Vasili, u detyruan të shpërngulen pas rrëshqitjes së tokës, që pësoi atë vit dhe shpalljes së saj të pabanueshme.

I solla këto detaje të shtëpive, që lidhen me jetën e Ligorit, me të vetmin fakt. Vitet e fundit ai e ktheu shtëpinë e tij në kishë. E ndihej shumë i lumtur. Rastësisht gjej të hedhur në internet foton e saj. E kishte bërë një turist polak. Në fokusin e saj ishte Katedralja ortodokse madhështore e hije rëndë, që ngrihet në mes të qytetit të Korçës. Si duket turistit i kishte bërë përshtypje ambienti nga prapa e rreth saj. Por pa e ditur, ai kishte fiksuar edhe atë shtëpi të vogël. Shtëpinë e tij. Ku me largësi të barabartë nga Katedralja dhe Mitropolia, për shumë kohë kishte ndriçuar hiri i Fjalës së Shenjtë. Dhe kjo ishte një dëshmi. Lum ai, që shtëpinë e tij e kthen në shtëpi të Zotit!



*Shtëpia e tij ishte kishë, do të kujtojnë anëtarët e hershëm të saj.
Këndonim, gëzonim, qeshnim, luteshim e mësonim fjalën e Perëndisë,
Biblën. Adhuronim Zotin me zemrën dhe këngën tonë dhe iknim
me paqen, që na shoqëronte gjithë kohës...*

Shkolla, fëmijëria dhe rinia

Mbas Ligorit, në Korçë lindën dhe tre fëmijë të tjerë: Marika, Petroja dhe Vasili. Ligori do të ndiqte në fillim kopshtin dhe më vonë shkollën “Papa Llambro Ballamaçi” të arumunëve. Kjo shkollë i përkiste komunitetit arumun të vendosur në lagjen numur një të qytetit. Përveç lëndëve në shqip, jepej mësim edhe në gjuhën arumune. Rrugët e drejta me kalldrëm të kësaj lagje bien pingul prej kodrës në bulevardin kryesor, Republika. Familjet, që jetojnë këtu e i përkisnin këtij komuniteti e kanë populluar hershëm qytetin.

Zakonisht flisnin shqip, por në familje ruanin gjuhën arumune, gjuhën e nënës. Secila familje ka historinë e vendosjes së tyre në Korçë. Ato kishin ardhur nga drejtime të ndryshme të Shqipërisë së jugut, nga Myzeqeja, Frashëri, por edhe nga Voskopoja, Plasa dhe Dishnica. Ky komunitet shquhet për bashkëjetesën me shtresat e tjera të qytetit dhe ka vlera të spikatura. Ata i kanë dhënë dhe i japin qytetari Korçës së tyre të dashur. Disa prej këtyre familjeve në atë kohë merreshin me tregëti, shumica ishin zanatçinj të mirë të prodhimit dhe qepjes së rrobave të shajakut, të tjerët përpunonin dhe shpërndanin prodhime të bulmetit sidomos para Luftës së Dytë Botërore. Gratë shquheshin për përpunimin e leshit

dhe endjen e qilimave. Marika, motra e babait ishte mjeshtrë e kërkuar për t'u bërë vajzave, qilimat e pajës. Ky komunitet kishte edhe kishën e vet, kishën e shën Sotirit. Por në vendin e saj në vitet 1950 - 1960 u ndërtua një apartament, në katin e parë të tij, ishin dyqanet e pionierit me veshje për fëmijë. Kisha ngrihej në bulevardin Republika me një arkitekturë të spikatur, me ornamente e piktura me vlerë. Ky ishte vendi i konstitucionit shpirtëror të tyre. Bota e brendshme e këtij komuniteti shpaloset në një folklor me valle e këngë plot vlera. Mjeshtri Pavllo Sholla ishte njohës i mirë i motiveve popullore e vijës së tyre melodike. Me zërin e bukur të Eli Farës janë kënduar një pjesë e mirë e këtij repertori. Ky komunitet këto këngë ia fali gjerdanit të këngës qytetare korçare si perla, që nuk humbasin kurrë shkëlqimin. Shkolla "Ballamaçi" kishte emër të mirë. Ajo mbante emrin e njërit prej atdhetarëve të Rilindjes, Papa Llambros Ballamaçi. I shquar si mbrojtës i çështjeve kombëtare. Komuniteti arumun e shihte veten si pjesë e qytetarisë korçare dhe i ka dhënë e i jep njerëz të shquar në të gjitha fushat e jetës. Rritja dhe edukimi i fëmijëve të familjes Çina është i lidhur me arsimin, që mund t'u ofrohej të rinjve nga familjet e thjeshta me gjendje jo të mirë ekonomike në atë kohë. Të dy prindërit ishin të interesuar për arsimim dhe edukim, pavarësisht nivelit ekonomik. Vullneti për të mësuar dhe zgjuarsia natyrale do ta veçonin Ligorin, jo vetëm me rezultatet shumë të mira në mësim, por edhe në sjellje e në formimin e karakterit. Në kujtimet e bashkëmoshatarëve, shokëve dhe shoqeve të fëmijërisë si Elisabeta Sholla, Petrika Mushi, kur ne i takonim në Tiranë, na thoshin, se babai juaj Ligori, ishte i veçantë në gjeneratën tonë. Ai ishte shembull në të gjitha drejtimet për ta. Shokë klase me të ishin edhe Rita Marko, zyrtar i lartë moneklaturës komuniste edhe mjeku Zisa Cikuli. Por në rrugën e jetës Ritën do ta kujtojnë si njeriun, që vuri Partinë mbi gjithçka, Zisan, si intelektualin e mjekun humanist e progresist. Ndërsa

Ligorin, si njeriun e ndershëm e të punës, besimtarin e përkushtuar në përhapjen e Lajmit të Mirë. Ndjenja e përkushtimit ndaj punës si veti e ndershmërisë dhe e rritjes së mirëqenies do të ishte motoja e kësaj familje të thjeshtë. Për të nxjerrë bukën e gojës ai dhe vëllezërit e tij, do të bënin edhe punë krahu të ndryshme. Ishin kohë të vështira. Por nuk do të mjaftonte vetëm kjo. Familjen do ta godiste një fatkeqësi e rëndë dhe e papritur.

Humbja e babait

Nëntor 1943. Ligori do të kujtonte, se ndërsa kthehej për në shtëpi, përcillte i shqetësuar dhe me ankth prapa krahëve pëshpërimat e njerëzve, që thoshin: - “Djalit të gjorë, ja vranë babanë!” Nuk po e kuptonte, se ç’lidhje mund të kishte ai me këto fjalë. Kosta Çina do të ishte viktimë lufte e i pafajshëm. Më i vogli i djemve të tij, Vasili, atëhere vetëm trembëdhjetë vjeç e kujton kështu më vonë këtë ngjarje të dhimbshme.

Ishte Kiço Panariti, i cili e thërret, që tutje e i thotë: - Kostë më dridh një cigare. E Kosta i afrohet t’i japë cigaren pa ditur gjë, se Kiçoja ishte arrestuar prej gjermanëve. Milicët e marrin edhe atë me vete për ta pushkatuar tek fabrika e miellit, në hyrje të qytetit të Korçës. Kosta ishte në punën e vet dhe e morën pa e gjykuar për ta ekzekutuar nga gjermanët. Të cilët u hakmorrën mbi civilët, që u gjetën rastësisht buzë kodrës së Belvederes, në të dalë të qytetit rrugës për në Dishnicë. Njësi gueril i qarkut të Korçës i kishte bërë pritë autokolonës gjermane, që po hynte në qytet dhe i kishin shkaktuar disa viktima. Babai i katër fëmijëve, Kosta e mbylli jetën pa i patur borbh askujt.

Trupin e pa jetë të të atit, Ligori e gjeti në shtëpi. Shtëpinë e kishte pllakosur zia. I tronditur e me dhimbje, sheh plagët e hapura nga plumbat në kokën e të atit.

Plagë, të cilat e ëma, ia kishte mbushur me tul buke. I afrohet trupit të pa jetë, me duart që i dridheshin e muskujt e fytyrës, që shtërگونin nofullat për të mos thënë asnjë fjalë. Përpiqet të mbahet fort dhe të gjejë ngushëllim në krahët e së jëmës. Lotët e së motrës dhe dënesat e vëllezërve thyenin heshtjen mortore. Humbja e babait dhe dhimbja për të ishte e madhe në familjen e tyre. Kjo ishte goditja e parë në fatkeqësi për Ligorin, djalin e madh të familjes, por edhe prova e parë në besim. E gjithë familja do të gjente ngushëllimin në besimin tek Zoti. Tek forca, që Ati na jep, për t'u ngritur mbi plagët e kësaj bote të kallur në luftë e pasiguri, të bindur në ardhjen e ditëve të drejtësisë së tij. *Në këtë rrugëtim jete të shkurtër, është Zoti, ai që na i jep jetën dhe vetëm ai ka të drejtë të na i marrë. Asnjë njeri nuk ka të drejtë të prekë shenjtërinë e jetës së tjetrit.* Duke u lutur, që i ati të prehet në paqe e në jetën e amëshuar, Ligori si besimtar e dinte, se jo vetëm lufta dhe viktimat e pafajshme të saj, por gjithë natyra mëkatore njerëzore e kishin një kurban të flijuar në Kryq, dhe ky ishte Jezu Krishti. Durimi për të kaluar sakrificat e kësaj jete do të kishin një shpërblim, jetën e amëshuar.

Gjatë gjithë jetës, Ligori do ta kujtonte shpesh të atin, gjithnjë si njeri shumë të vrazhdë, por shumë të drejtë e besimtar. Kosta ishte modeli i prindërimit autoritar. Bashkëjetesa me të, për të gjithë anëtarët e familjes nuk kishte qënë e lehtë. Nuk ishte problemi, se duhej ta pranoje si të tillë me huqet dhe temperamentin e veçantë. Për kohën, që i referohemi sjellje të tilla ishin normale. Kur e dëgjonim, që na fliste për gjyshin, ne fëmijët e tij ndienim respektin e thellë, që ai kishte për të atin. Duke respektuar figurën e babait të tij, ai reflektonte atë dashuri të madhe dhembshurore të fëmijës për prindërit. Ai ishte bërë vetë baba. E na thoshte: -

“Babain duaje dhe respektoje, Zotin besojë”. Sepse prej tij buron dashuria për njerëzit e afërt të gjakut, por edhe për familjen e madhe shpirtërore, që njerëzit formojnë në emër të besimit. Kur fliste dhe tregonte shumë ngjarje e mbresa për të, nuk e gjykonte asnjëherë. Ligori do të ishte për ne një prind krejt i ndryshëm nga ai, në komunikim e marrëdhënie. E gjithnjë do t’na thoshte, se gjyshi po të rronte, do t’u donte shumë. Por mua, më ka mbetur në mendje një histori e treguar nga gjyshja ime, Parja për Kostën, gjyshin tonë, që ne fatkeqësisht nuk e njohëm për së gjalli.

... Era e fortë e përplasi derën. Në mesin e saj, drita e zbetë e dhomës ra mbi trupin e sapo të ardhurit. Silueta e një burri u duk nëpër errësirë.

Baba, belbëzoi fëmija i vogël, që nxitoi të rendte drejt tij, me sytë që i shndrisnin prej gëzimit. Fustani i gjatë, që i rrotullohej nëpër trup e pengoi dhe u rrëzua me fytyrë në dysheme. Burri shtangu. Bëri dy hapa dhe e mori në krah. Aroma e foshnjës e përmendi. Në duart e mpira nga të ftohtit ndieu ngrohtësinë e trupit të të birit. Afroi fytyrën e tij për ta puthur, fëmija i trembur filloi të qajë. Duart e vogla të Ligorit kapën mjekrën e gjatë dhe të dendur të të atit. Parashqevia afrohet për ta përkëdhelur e gënjyer foshnjën, dhe i thotë të shoqit: “Mirë se erdhe! Vështtrimet e tyre u kryqëzuan. Kosta kishte dy javë larg shtëpisë dhe po kthehej nga rrugëtimet e gjata së bashku me qiraxhinjtë e tjerë. Rrugëtimi kishte qënë i lodhshëm. Dhe dimri i atij viti kishte qënë i gjatë dhe i vështirë. Rreshjet e dëndura të dëborës kishin zënë shtigjet dhe e kishin bërë udhëtimin plot të papritura. Ngrohtësia e dhomës, ambienti çlodhës, që i afronte shtëpia e bënë, që t’i ndiente edhe më tepër gjymtyrët e lodhura e të ftohta. Ajo e ndihmoi të hiqte gunën e rënduar nga copëzat e vogla të akullit. I përgatiti ujë të ngrohtë me kripë për të çlodhur gjymtyrët dhe vënë në lëvizje damarët e mpirë prej të ftohtit. Filloi t’ia hidhte dalëngadalë ujin në legenin e

bakërtë. Në fillim ujë të vakur dhe më pas duke ia rritur ngrohtësinë për të mos ndierë dhimbje. Mbasi bëri edhe banjën, Kosta filloj të rruhej. Por brisku nuk po i bindej në mjekrën e dëndur dhe të rritur shumë. E la briskun, e lidhi mjekrën me një shami. Do të shkoj të rruhem tek berberi, i tha të shoqes. Nuk ka derman kjo punë. Ndërsa i biri këmbadoras i u afrua duke gëtitur dhe skërmitur me gishtat e tij, nofullën ku kishin buitur dhëmbëzimet e dhëmbëve të parë. E hoqa nga gjiri dhe nuk kam me çfarë ta gënjej, i tha nën zë Parja. A i ke sjellë ndonjë karamelle djalit? Kosta i uli sytë e pa thënë asnjë fjalë iu afrua vatrës dhe mori kusinë, që po ziente në zjarr. Pula, që ziente në të, me kusinë fluturoi nga dritarja jashtë. Bëri të dalë. Dera u mbyll vetë duke lënë të shtangur Parashqevinë dhe fëmijën që s'kuptonte gjë. Ai ecte në rrugë duke u grindur me veten dhe erën, që frynte e dukej sikur s'pajtohej me të.

Fjalë të urta

Të ndihmohet atë, që ka nevojë quhet njësoj sikur t'i japësh hua Perëndisë. Ai do të ta rikthejë. Rriti fëmijët e ty me rreptësi, atëhere mund të kesh shpresë tek ata. Mos lejo të shkojnë drejt rrënimit të tyre.

Marrëdhëniet e Kostës me djemtë ishin të diferencuara në raport me temperamentin e tyre. Ligorit, si djalit më të madh do t'i kërkonte ndihmë e t'i merrte mendime kur ishte në mëdyshje për një ndërmarrje të madhe në punët e shtëpisë. Petros, djalit simpatik, që e tërhiqte më shumë jeta e lirë dhe plot zhurmërime e qytetit, do t'i tërhiqte veshët e do të shqetësohej për rastet kur kthehej vonë në shtëpi. Atij s'i pëlqente simpatia, që shprehte për këngët italiane dhe pa e parë në sy do t'i thoshte: - Hë mo, se mos më ke ndenjur me breshkaxhinjtë. Por Petroja ishte i dashur dhe shumë punëtor e tërë jetën mbeti mbi timonin e skodës, që iu bë shtëpia e dytë. Vasili ishte i vogël dhe rritej nën hijen e vëllezërve, Marika e përkëdhelura e tij ishte pjesë e edukimit të së jëmës. Ai e vështronte tek rritej si

vajzë e qetë dhe shumë punëtore. Së bashku me Ligorin e Petrina Dhëmbin, ajo do të ndiqte predikimet e kishës ungjillore. Babai i tyre Kosta, u nda nga jeta pa marrë asnjë gëzim prej fëmijve. Shtylla tjetër, ku ata do të gjenin mbështjen dhe qetësinë shpirtërore tani do të ishte e jëma.

Parashqevia e mbetur e ve, me barrën e dyfishtë do të mblidhej me fëmijët e do të bëhej edhe më e fortë. Fatkeqësia e lidhi më shumë familjen. Djemtë dhe vajza u bënë të mbarë. Do të nisinin ndërtimin e shtëpisë së re. Do të krijonin familjet e tyre. Do të ndërtonin jetët e tyre.

Fjalë të urta

“Një grua e aftë është xhevahiri më i çmueshëm, që mund të gjejë njeriu. Burri i saj mund të mbështet tek ajo; ajo e ruan dhe shumon pasurinë e tij. Gjatë gjithë jetës së tij ajo e gëzon dhe nuk e zhgënjen kurrë.”

Dhe mundimet e këtyre grave nuk mbeten pa shpërblime për atë, që ato bënë, mbetën të lavdëruara për të gjithë sa i njohën.

Çdo gjë ka stinën e vet, çdo situatë ka një kohë nën qiell, një kohë për të lindur dhe një kohë për të vdekur, një kohë për të mbjellë dhe një kohë për të korrur, një kohë për të vrarë dhe një kohë për të shëruar, një kohë për të rrënuar dhe një kohë për të ndërtuar, një kohë për të qarë dhe një kohë për të qeshur, një kohë për të vallëzuar dhe një kohë për të mbajtur zi, një kohë për të flakur gurët dhe një kohë për t'i mbledhur gurët, një kohë për të përqafuar dhe një kohë për të mos përqafuar, një kohë për të kërkuar dhe një kohë për të humbur, një kohë për të ruajtur dhe një kohë për të hedhur tutje, një kohë për të grisur dhe një kohë për të qepur, një kohë për të heshtur dhe një kohë për të folur, një kohë për të dashuruar dhe një kohë për të urreyer, një kohë për luftën dhe një kohë për paqen...

Ligori gjysh

Herisi dhe Josifi ishin fëmijët e parë që e bënë gjysh Ligorin. Ai do të provonte atë dashuri e përkushtrim që ta jep mjalti i mjaltit, kur jeta të fal dhuratën më të bukur, që të bën Zoti. A s'ishte vetë Zoti, që birin e tij të vetëmlindur na i dhuroi me fytyrën e një fëmije? Jezui, si Bir i Perëndisë së vërtetë, si at' i paqes së ardhshme, me gëzimin e lindjes e ringjalljes së tij na dha mundësinë, që të shohim brenda nesh pafajësinë e dliresinë shpirtërore, që buron prej hirit! Si një virtyt i përjetshëm për të ndarë të mirën e të dobishmen nga e ulta, e shëmtuara dhe e keqja.

Njëra vajzë e tjetri djalë, njëra e shtëpisë e tjetri si mik, ata ia mbushnin gjyshit njësoj shpirtin me gëzim. Jepnin e merrnin dashuri nga njëri – tjetri pa kusht. Dhe ne të rriturve na dukej shtëpia më e madhe, me më shumë dritë edhe më e lumtur. Herisit, Donikës, Vasjanit, Johanit dhe Grigorit u takoi të përjetonin kujdesin e tij në mirërritje dhe edukim. Sa e sa kujtime e histori ruhen në atë “lojë” të bukur të fëmijërisë së tyre, që kanë mbetur të pashlyera në kujtesë e në formimin e personalitetit. Me durimin që e karakterizonte, Ligori e ndiente thellë në shpirt se investimi tek fëmijët ishte rruga, që të çon tek ardhmja. Lindja e Jezuit fëmijë

është këmbana e përhershme për të na kujtuar veprat e mira, që duhet të bëjmë për ta pa rreshtur.

Ai e priti me kënaqësi të veçantë vendosjen emrit Josif, si emri i një shenjtë. Njëkohësisht me emrin e tij, Josifi, rriti edhe emrin e stërgjyshit nga ana e babait të tij. Në një kohë, kur lista e gjendjes civile nuk e lejonte vendosjen e emrave fetarë. Argumentit të disave, se ai kishte emrin e liderëve të komunizmit, Stalinit e Titos, ai do t'u thoshte se, nipi tij kishte emrin e Josifit të Biblës, që vëllezërit e hodhën në pus. E kështu avash - avash do ta mbaronte deri në fund fabulën e tij biblike. Me një krenari të përligjur, duke përkëdhelur sedrën e dëgjuesve rreth tij, ai do t'u thoshte, se Josifi nipi i tij do të bëhej “kryeministër”. Se prej Perëndisë nuk mbetet pa shpërblyer asnjëherë ndershmëria e përkushtrim njerëzor. Një pjesë e nipërve e mbesave të tij, sot janë duke studiuar nëpër botë. Ashtu si për fëmijët e tij edhe për nipërit e mbesat, ai do të mbetet njeriu shembull i dashurisë për punën dhe njeriun e kulturës. Gjatë rritjes së fëmijëve tanë, ne shpesh u kujtonim atyre, se si ai me djemtë e tij duke filluar nga vëllai i madh Koçua, Aberti, Borizi e Vangjushi do të konsultoheshin si të ishin lojtarë të një skuadre. Që në moshë të hershme ai u dha njëherazi edukatën e punës edhe korektësinë e sjelljes me njerëzit. Por asnjëherë nuk ka lënë pas dore arsimimin e tyre dhe përpjekjen e vazhdueshme për t'u kualifikuar. Kujtoj se kishim një çantë lëkure, bojë kafe. Në kapakun e saj ishte gdhendur emri i tij. Ligor K. Çina. Të cilën e mbajtëm rradas ne, katër fëmijët më të mëdhenj. Ajo na zëvendësonte “pecen” prej pëlhure, që mbanim në fillore. Ishte çanta, ku babai ynë kishte mbajtur librat e shenjtë. Me atë, shumë vite më parë ai kishte shpërndarë Biblat nëpër fshatra. Atëhere, ajo na shoqëroi edhe ne në rritjen shpirtërore nëpër vitet e gjimnazit. Ne jetuam në të tjera kohëra edhe me të tjera kufizime ekonomiko - kulturore, shpesh shumë të mëdha. Në të shumtën e herës të pa imagjinueshme për

brezin e sotëm. Ajo ishte koha jonë, të cilën nuk duhet ta lëmë të përsëritet. Fëmijët tanë jetojnë në kohën e teknologjisë dixhitale e të internetit. Ata kanë më shumë mundësi për të gjetur veten brenda e jashtë Shqipërisë. Me ambicien për t'u laureuar në fusha të ndryshme të shkencave ekzakte, humane dhe të artit.

Lum ai njeri, që ka gjetur diturinë dhe njeriu që ka përfutur arsyen. Sepse fitimi i tij është më i mirë se fitimi i argjendit dhe fryti i tij vlen më tepër se ari i kulluar. Ajo është më e çmuar se perlat dhe mbarë gjërat më të këndshme nuk mund të barazohen me të.

Fjalë të urta 3 ; 13, 14, 14.



Herisi ishte fëmija e parë që e bëri Ligorin gjysh.



Fëmijët ia mbushnin Ligorit njësoj shpirtin me gëzim. Jepnin e merrnin dashuri nga njëri – tjetri pa kusht. Dhe ne të rriturve na dukej shtëpia më e madhe, me më shumë dritë edhe më e lumtur.



Ligori me djemtë e tij dhe nipin Josifin

Ungjillorët

Në shtëpinë e tij të fëmijërisë nuk kishte ikona. Nëpër të cilat të luteshin e të ndiznin qirinj, siç ishte zakoni në familjet e krishtera korçare. Dashurinë për Zotin e kishin të thellë. Në lutje dhe adhurim ata e ndienim forcën e besimit. Parja, ashtu si e vjehrra e saj Nerënxa, nuk ishte praktikante fanatike në zbatimin e rregullave të besimit të krishterë ortodoks. Intuita jetësore i kishte bërë të besonin, se të puthje e të adhuroje ikonat e bëra nga njeriu, ishte shumë pak nga ajo, që ndienin thellë në shpirt. Se fuqia e Zotit ishte më e madhe se kisha. Se pushteti i tij shtrihej kudo e mbi të gjithë. Se të gjitha ditët ishin të Perëndisë. Se Zoti ishte i kudo ndodhur për t'u falur në besimin e adhurim. Me dashurinë për Zotin u rrit në këtë familje edhe Ligor. Më vonë si dhjetra e dhjetra fëmijë të tjerë, ai do të ndiqte predikimet e misionarëve në shkollën e mëngjesit të së dielës të ungjillorëve Kenedi. E do të rritej në besim. Në formimin si besimtar, kujtimi i misionarit Kenedi dhe puna me Xhejksi do të linin mbresa të pashlyera. Të jatit i pëlqente, që i biri po lexonte ungjillin dhe i kërkonte shpesh t'i tregonte historitë e tij. Në sytë e djalit kishte një dritë, që buronte nga një paqe e brendshme. Ai vërtet ishte rritur në një familje besimtare,

por prindërit e tij nuk e kishin lexuar dhe s'kishin mundësi të lexonin Biblën. Përkthimi i së cilës ishte dhurata më e çmuar, që Shoqëria Biblike, ju bëri besimtarëve shqiptarë duke filluar që nga viti 1824 i shekullit të XIX. Shpërndarja e Biblave nuk kishte qënë punë e lehtë. Njerëzit, që dinin të lexonin ishin të paktë. Pjesa më e madhe e popullsisë ishte analfabete. Por hapja e Shkollës së Vashave dhe puna e saj me ungjillizimin kishte krijuar një traditë në qytetin e Korçës e në zonat për rreth. Me dhjetra të rinj korçarë do të ndiqnin rregullisht mësimet e Biblës prej misionarëve. Veprimtaria e të cilëve nuk ka qënë e mirëpritur nga pushtuesit e ndryshëm si edhe nga qarqet fetare të atyre kohërave. Por për njerëzit e thjeshtë e të ndershëm të qytetit të Korçës ishte ndryshe. Ato mburreshin me vëllezërit e motrat Qiriaz, që shkollonin vajzat e tyre. Të shumtë ishin ata, që nuk mungonin në takimet e mbasditëve, kur adhurohej dhe lexohej Bibla. Ishin këto gra mendjehapura, që do të gjallëronin jetën artistike në qytetin duke vënë në skenë, dramën “Vilhem Tel”. Paçka se dikush do t'i quante masonka. Këto vajza u ngritën mbi mentalitetin e kohës, e do të luanin vetë edhe rolin e burrave, për të sjellë kulturë dhe qytetërim në një shoqëri me mentalitet patriakal. Tanka Karapataqi do t'i fliste shpesh së motrës, Pares për ta njohur me vizitat, që kishin bërë kohë më parë, shtëpi më shtëpi, dhe mbresat që u kishin lënë grave, këto pioniere të para të lëvizjes feministe bashkëkohore iluminizuese. Sevastia e më vonë Parashqevia ishin të parat besimtare ungjillore në Korçë dhe në Shqipëri. Ato janë dy figura të ndritura të historisë dhe arsimit shqiptar. Me punën e tyre ato synonin, që femrat të rriteshin të shëndetshme shpirtërisht për të qënë vajza, gra dhe nëna të emancipuar. Për këtë kishin mbështetjen e të gjithëve, edhe të grave të aristokracisë korçare, po dallim feje. Misioni i tyre ishte një bekim. Pavarësisht përndjekjeve, mësimi i gjuhës shqipes edhe shkrimi i shenjtë hodhën rrënjë të thella në mendjet dhe zemrat e njerëzve. Misionarët e fjalës së Zotit

dhe të kulturës kishin vizione të qarta për kohën. Puna e tyre në ato dekada u frymëzua nga një platformë idealiste, të bindura, se do të luftonin për ta venë në jetë me çdo çmim. Jeta e shkurtër e Gjerasim Qiriazit, siç ndodh rëndom me jetën e njerëzive të mëdhenj e pati famën e madhe. Shembulli i jetës së tij për përhapjen e ungjillizimit në krahinën e Korçës e më gjërë e sfidoi “Me pengun e kaçakëve”. Do t’i sfidonte kaçakët edhe lindja e vajzës së Katerina Cilkës, kur së bashku me miken e saj, Elena Stone gjatë rrugës së kthimit për në shtëpinë e tyre ranë në kurthin e pengut. Kisha Ungjilllore e Shqipërisë, misionarët e huaj edhe besimtarët e thjeshtë shqiptarë kanë shkruar faqe të ndritura në historinë e saj. Me sakrificat dhe përpjekjet e tyre, ata ecën në rrugën e gjurmëve të dishepujve të Krishtit. Duke u kthyer në simbole të shumëfishtë e të bekuar me mirësi e shenjtëri. Ata kishin me vete bekimin e Zotit, forcën e besimit dhe shpirtin e paepur të sakrificës dhe bindjen se kjo do t’i shërbente të ardhmes së brezave, ndriçimit shpirtëror të tyre. Kur fjala e Zotit bën fole në zemër edhe rruga e së vërtetës së madhe është e hapur.

Motrat Qiriazit

Bekimin e morët e do të digjeshit si qiriri
motrat e vogla të Koto Hoxhit e Naimit.
S’pyesnit për prangat, ju shpresën mbillnit,
Punët e mëdha përpara ju prisnin.

Si Zhan’ark i ligjëruat të drejtat e kombit
në tavolinat e Evropës ia mbrojtët trupin.
S’i mundet bijat, këtë marre të duronin!
Kurorë dafine, në krye atdheut i vinit!

kushtuar Katerina Cilkës edhe Elenës

Në kurth ranë dy gra të pambrojtura.
Jetën në besën e kaçakëve e kishin.
Nuk vlente trimëria e pazarit të pistë!
Pengu s'ishin vetëm ato, por dhe fëmija
në barkun e nënës, që po pret të lindë!

Kërkojnë të mbrohen për të dy jetët
Të tyren e të foshnjës. Çuditërisht sa e trishtë!
Një ëngjëll, jetën nisi mes kaçakëve!
Nga të qarat kasollja u zgjua e trembur,
s'kishte djep ta lidhnin, sa pelena nuk kishin...

Si yll i magëve ndrinte, kjo foshnjë e bekuar
në atë pyll me gjethe e mendje të trazuara!
As shpëtimtarët, as lajmësit dot s'po vinin!
Në fillin e perit jetën e saj e ruajnë dy zonjat
Pengu, asnjë vlerë paraje s'mund të kishte.

Sprovë e Zotit, kjo foshnjë, dhuratë e qiellit
në kurthin e pabesisë, shkëlqim drite e dashuri!
Me pëlhurën, që fshinin armët, pelenat u sajuan
Princesha e vogël, fatin e kishte në dorën e Zotit.
Kaçakët, mrekullia e saj i la me zemër të ngrirë!

Kjo ishte atmosfera e punës së ungjillorëve në dekadat e para të Shekullit të Njëzetë me gjurmë të thella në memorjen e kohës së fëmijërisë së tij. Çdo ditë Ligorit i drejtohej ndërtësës, si ndjekës i Krishtit, ai e ndiente së brendshmi zërin hyjnor prej të cilit nuk mund të ndahej më. Tek ndiqte rregullisht ligjëratat e predikuesve, një pyetje i bënte vehtes : - Çfarë duhet të bëj më tej? - A mjaftonte vetëm besimi, adhurimi dhe lutja? Në shpirtin e përndritur, një zë i fliste prej kohësh. Kishte ardhur momenti të vepronte. Ai duhet të dëshmonte praninë e Zotit në jetën e tij. Në këtë rrugë ai nuk ishte vetëm. Me të ishin edhe shumë djem të tjerë. Nasi Lubonja, Koci Lubonja, Koci Treska, Kristaq Treska, Gaqi Xoxi, Tefik Mborja, Bajram Bekteshi e shumë të tjerë. Por edhe vajza, si kushërira e tij Anastasi Sterjo Bandilli. Tashmë e kishte të qartë misionin e tij. Do të shpërndante Biblën nëpër fshatra. Do të predikonte fjalën e Zotit dhe ashtu siç e kishte ndierë vetë rilindjen në Krisht, do ta ndienin edhe të tjerët. Në këtë punë do të mbështetej nga misionari Edvin Jacques.

I jati i Ligorit do të ishte i pari, që do të njihej me Edvin Xhejksin dhe familjen e tij. Njeriu i Zotit siç e thërriste ai. Edhe pse ishte me kombësi të huaj, Xhejksi ishte burri, që i donte shumë shqiptarët dhe që përpiquej me shpirt të mësonte gjuhën shqipe. Predikimi në shqip i librave të shenjtë e sillte misionarin para tij si bekim nga Perëndia. Por dhe familja e Xhejksit do të shihnin tek ai dhe familja e tij, miq në besim. Kjo miqësi do të përcaktonte edhe fatin e jetës së Ligorit. Pavarësisht nga peripecitë historike, lidhja e njerëzve në besim është hyjnore disa herë edhe profetike. Kujtoj, se në mesin e vitit 1986, Ligorit do t'i vijë një letër nga Edvin Xhejksi. Ai do të ishte misionari e parë, që do të vizitonte Shqipërinë e mbyllur dhe ateiste. Nuk do të ndalem në arsyen, që kishte motivuar ardhjen e tij në Shqipëri. Ai vinte i ftuar nga funksionari më i lartë i shtetit të asaj kohe, mbas vdekjes së Enver Hoxhës. Por do të

ndalem në atë, që mund të lexohej në rreshtat e letrës së dërguar prej tij. Si shpresë e fillimit të një komunikimi të ndërprerë prej dekadash. Si një rreze, ajo do të ngrohte zemrat, për ditët e mbara që po vinin. Ligori e priti këtë letër me shumë gëzim edhe tejet i entusiazmuar. Ai ma dha edhe mua ta lexoja. Gjë, jo e zakonshme për të. Babai ishte shumë i kujdesshëm e nuk fliste për çështjen e besimit, sepse na ruante nga pasojat, që mund të kishim. Edhe Xhejksi vetë do të vinte ta takonte thjesht si një mik. As që mund të mendohej ndryshe, se do ta rrezikonte po ta takonte si besimtar. Edhe unë u emocionova shumë, por kuptova sa e fortë kishte qënë lidhja e tyre, të cilën po e përcjell përmes vargjeve kushtuar Edwin Jacques, mikut të tij të shtrenjtë, por dhe të shqiptarëve.

Edvin Jacques

Një letër e rrallë, pas shumë vitesh në dorë më ngriu.

Shkronjat e emrit të misionarit, mikut të tij të vjetër
në zemër trokitën, me forcën e dallgës përtej oqeanit!

Derën e rëndë të kujtimeve para syve do të ma hapnin.

Tek “Ushtari i panjohur” takohemi si burra të vjetër
të kujtojmë rininë, të flasin për ëndrrën tonë të vërtetë!

Mendoja për kohën e gjatë të mungesës, ai mall derdhej
në veprën “ Shqiptarët” dashuria e tij për atdheun e dytë!
Mes rreshtave të letrës dritën shihja, një shpresë të vërtetë.

Por letra Ligorit i erdhi dy javë me vonësë. Pikë takimi në këtë letër ishte parashikuar sheshi tek monumenti “Ushtari i panjohur” në qendër të qytetit të Korçës. Tashmë jo të rinj si dikur, por me dëborën e bardhë të viteve mbi flokë, me peshën e kujtimeve, me merakun për të kapur kohën e humbur. Zhgënjimi për të dy ishte i madh. Xhejksi ishte larguar nga Shqipëria pa mundur të takoheshin edhe pse kishte ardhur në Korçë. Por letërkëmbimi i tyre vazhdoi. Ai mori më vonë edhe një letër tjetër prej tij. Edhe koha do të punonte për ta. Në vitin 1992, Xhejksi do të vinte përsëri e ata do të takoheshin me një mision të madh për ta realizuar. Në këtë udhëtim bashkë me familjen Xhejks do të vinin në Shqipëri edhe David Wedin dhe Roger Draves. Z.Wedin i ka premtuar Ligorit dhe besimtarëve si Kristaq Treska se brenda vitit do të dërgoheshin misionarë nga misioni i Xhejksit. Ishim ne, në mars të 1993, që misioni na ka dërguar për të bashkëpunuar në Korçë, - kujton Dana e Lerry Stucky, për rifillimin e punës së nisur dikur e të lënë përgjysëm nga Lufta e Dytë Botërore e Diktatura.



*Në vitin 1992, Xhejksi do të vinte përsëri e ata do të takoheshin
me një mision të madh për ta realizuar.*

*Në këtë udhëtim bashkë me familjen Xhejks
do të vinin në Shqipëri edhe David Wedin dhe Roger Draves.*

Në imail, që ajo më ka dërguar me relacionet e zotit Edvin Xhejksi drejtuar misionit të tij për veprimtaritë qershor - shtator 1938, del qartë problematika e kishës dhe puna e këtyre djemve të rinj, për ugjillizimin e përhapjen e Lajmit të Mirë në të gjithë qarkun e Korçës. Një punë sa legale aq edhe ilegale, si misionarë të Fjalës në një betejë përndritëse kokë më kokë, nga një vend tek vendi tjetër, për të prekur të vërtetën në zemrat e njerëzve. Sa herë e përmend fjalën misionar, më vjen ndërmend edhe atmosfera patriotike e trevës së Korçës. Historia e burrave të çetës së Themistokli Gërmenjit e Mihal Gramenos do të jenë historia e pashkruar, që gratë korçare do t'ua mësonin gojarisht bijëve të tyre.

Ngjarjet historike të asaj kohe, përbënin subjektet ku korçarët skalitnin forcën e karakterit, tashmë heronj të kësaj treve. Në familjen e hallës së tij Xies, Çerciz Topulli do të kthehej në Floq, sa herë që vinte në Korçë. Burri i saj, Sterjo Bandilli ishte trim po kaq me nam. Emrin e tij për të përjetësuar bëmat e mban një shpellë në Dardhë. Shpella e Tegos. Ashtu si edhe emrin e babait të tij një pemë, pema e Vangjelit. Prej këtyre historive buronte modeli, që ato dëshironin t'u jepnin si idhuj trimëror e burrëror fëmijëve të tyre. Patriotizmi i ushqyer që në familje e bën Korçën në një kuadër më të gjerë, djepin e lëvizjeve progresiste të asaj kohe. Patriotizmi s'ka të bëjë vetëm me simbolet kombëtare, por edhe me kulturën në përgjithësi. Këta personazhe historike, që përmenda kanë mbështetur veprimtarinë edhe aspiratat e misionarëve ungjillore, që vepronin në atë kohë në Korçë. Me ta do t'i bashkonte mësimi i gjuhës shqipe, çështja e alfabetit, hapja e shkollave, botimi i librave në gjuhën shqipe, por dhe përndritja shpirtërore nëpërmjet Fjalës së Perëndisë në gjuhën shqipe. "Kongresi i Manastirit" është pika kulmore e këtij bashkëpunimi historik e biblik.



*Boris e Rina Plumbi, Doroty e Edvin Jacques, Kristaqi, Ligori.
(Nga e majta në të djathtë)*

Misionari i Fjalës së Mirë i tejkalon kufijtë provincialë e kombëtarë. Ata janë të përbotshëm dhe bashkojnë raca e kombe me gjakun e martirizuar të Krishtit në Kryq. Dhe shpalosin kudo flamujt e shpresës, të ngritur mbi drejtësinë Hyjnore të Ungjillit dhe krishtërizimin e shpirtit duke i ndihmuar njerëzit të rriten për ditë në Krisht.



*Tashmë jo të rinj si dikur, por me dëborën e bardhë të viteve mbi flokë,
me peshën e kujtimeve, me merakun për të kapur kohën e humbur.*

Në gjurmë historie

Muzgu kishte filluar të binte shpejt dhe ditët ishin më të shkurta. Qielli pikonte yje. Hëna vështronte nga lart si e vetmja dëshmitare e rrugëve të boshatisura. Ora e qytetit ra nëntë herë. Mbrëmja mbretëronte paqshëm.

I 1 shtator 1938. Befas mbi derën e shtëpisë u ndjenë trokitje të shpeshta. Disa ditë më parë, më gjashtë shtator, Kosta i kishte dhënë aprovimin Edvin Xhejksit për pagëzimin e të birit, Ligorit. Burri ngrihet të shohë se kush mund të jetë në këtë orë të vonë. I drejtohet koridorit për të hapur derën. Diçka jo të mirë i ndjeu zemra. Në këtë orë nuk trokitet për të mirë, mendoi ai. Përmes errësirës dalloj dy silueta, që kishin zënë pragun e derës kryesore. Ishin dy policë. I shikoi me mëdyshje duke ju hedhur vështrimin nga koka në këmbë dhe i pyeti përse kishin ardhur?

Duam djalin, - i thanë, pa ia zgjatur fjalën. Kosta mbeti i befasuar, dhe pa përgjigje. Ai e njihte mirë djalin e tij dhe ishte i bindur në vetvete se i biri, ishte i pafajshëm. Ligori, atëhere ishte tetëmbëdhjetë vjeç. Ai, jo vetëm që nuk i kishte sjellë asnjë shqetësim, por ishte bërë krah pune e ndihme për familjen. Dhe nuk merrej me *punëra*, që mund të sillnin shqetësime e telashe me autoritetet.

Duhet të paraqitet në polici! - i thanë prerë policët. Pa i dhënë mundësinë të pyeste se çfarë kishte bërë i biri. Kosta i hodhi sytë nga djali, që rrinte i mbështetur në minderin pranë vatrës. Në duar kishte Biblën, të cilën po e lexonte me vëmendje. Të nesërmen ai, Nasi Lubonja, Koci Lubonja e Gaqo Xoxi do të pagëzoheshin. Ata do të dëshmonin praninë e Jezuit në jetët e tyre. Sa e kishte pritur këtë ditë! Shpirtin e kishte të mbushur me gëzimin e dritës, që buronte prej dashurisë së Krishtit. Djali kishte kohë, që e kishte ndjerë se bota e kishte shpëtimtarin e saj. Çdo fjalë e librave të shenjtë përthitjej prej tij, si ajri, si uji e depërtonte në çdo qelizë të trupit dhe e ushqente si oksigjeni. Djali i ri, shihte tek fjalë e Krishtit, modelin e përlësisë e mirësisë, dashurisë e sakrificës, dallimin e dritës nga errësisra, shtegun ku duhet të ecte tashme jeta e tij. Prezenca e Jezu Krishtit në jetë e tij e kishte bërë ta shihte botën me një sy tjetër. Këtë mbrëmje s'besonte, se mund të vinte gjumë në sy. Kjo ishte nata e dialogut të tij me Zotin. Ai i fliste shpirtit të tij me zërin hyjnor. Kjo natë s'ishte si të tjerat. As qielli, as kjo hënë e zbetë. Gjithshka shkëlqente. E ndjente veten të ripërtërirë. Vizioni i një drite që i mbushte çdo cep të vetëdijës së tij e kishte bërë ta ndiente thellë forcën e besimit e të ndryshimit. Ai, tani e paskëtaj, nuk do të ishte më i vetëm. Jetën ia kishte falur Zotit dhe fuqinë e tij po e ndiente në çdo qelizë të trupit e të shpirtit të tij djaloshar.

Të kërkojnë në polici, - i thotë i jati, i bindur se do të ishte një keqkuptim. Po atë mbrëmje, këto trokitje u ndjenë edhe në tre shtëpi të tjera në qytetin e Korçës. Me të njëjtin paramendim. Nuk mund të kalonte, si rastësi pagëzimi i katër të rinjve ungjillorë. Dikujt nuk i kishte pëlqyer, ndikimi edhe rritja e besimtarëve të Kishës Ungjillorë në Korçë. Duhej t'i trembnin këta katër djem, që të mos pagëzoheshin. Ky incident do të ndiqej edhe në Tiranë, në Ministrinë e Brendshme nga Edvin Xhejksi, për të sqaruar e liruar djemtë e pafajshëm.

Korce, me 6 Shtator, 1938


Une, Kosta Çina, i jap Ligorit, birit t'im,
lejen t'ime te pagezonet sipas Ungjillit.

 Kosta Çina.....

Deshmues:

Stefan Simaku
Kristaq Dhimitri

Vërtetimi i lejës së pagëzimit me gjurmën e gishtit të babajt të Ligorit.



*Tre të arrestuarit, Ligori ,Gaço, Nasi.
(Nga e majta në të djathtë)*

Policët e marrin Ligorin dhe Biblat që kishte në shtëpi. Era e ftohtë e natës i rrahu fytyrën. Ai ndjeu lehtas të dridhura. Shpejt e mori veten. Hapat e tyre oshëtinin nëpër rrugët e errësuar.

Rruga e të pabesëve është si terri, ata nuk shohin atë, që do t'i rrëzojë. Ai, tani dinte të ruante me shumë kujdes zemrën prej së cilës dalin burimet e jetës.

Fjalë e urta Bibla

Tek- tuk shihej ndonjë i vonuar, që po drejtohej në shtëpinë e tij. Ata përshkuan bulevardin në krah të njëri – tjetrit si të ishin xhelatët dhe viktimat, njëllon si tek personazhet e romanit “Proçesi” të Kafkës. U drejtuan për tek katër pallacinat. Por ndryshe nga Jozef.K, ai kishte diçka të madhe për të dëshmuar:

“Zoti ishte pranë tij dhe do të pengonte që këmba e tij të kapej në ndonjë lak”.

Atje sollën dhe tre shokët e tjerë. Asnjëri nuk e besonte, se kjo punë do të vinte gjatë. Atë natë nuk i mori njeri në pyetje edhe nuk u thanë asgjë. Edhe të nesërmen në mëngjes nuk komunikuan me njeri. Vetëm nga dreka i hipën në një makinë dhe i nisën drejt Tiranës.

Në ato kohë qeveria e Zogut e kishte mbyllur, që në vitin 1933 Shkollën e Vashave. Ndërsa, shkolla e drejtuar nga çifti Kenedi u mbyll, misioni i Edvin Xhejksit ishte e lirë për të vazhduar. Ata zhvillonin takimet çdo të dielë deri në fillim të vitit 1940. Përpjekjet e Edvin Xhejksit për të ndërtuar një qelizë me të rinj ungjillorë, nuk po shiheshin me sy të mirë nga Dhespoti, i cili kishte raportuar zgjerimin e ndikimit të ungjillorëve në qytetin e Korçës. Edvin Xhejksi për këtë rast kujton: – “Rruga për në Tiranë ishte e gjatë edhe e lodhshme. Djemtë në vend, që të diskutonin për

faktin pse ishin arrestuar, ishin harruar në diskutime për problemet e ditës e të moshës”.

Për t’u provuar *fajësinë* policët me vete u kishin marrë edhe shumë libra, që ua kishin gjetur djemve në shtëpitë e tyre si provë.

Pra, me ata në këtë udhëtim, ishin edhe “Biblat”. Librat e shenjtë po shkonin në Tiranë së bashku me djemtë ungjillorë. I futën në një qeli të errët e të ngushtë. E gdhinë atë natë të ulur në çimenton e ftohtë nën thirrjet e britmat e një mashkulli. Fjalët e tij nuk kuptoheshin, ishin më tepër si ulërrima, Në qeli me ata ishte edhe një qytetar i arrestuar, sepse kishte prishur qetësinë e qytetit.

Djemtë u panë në sy dhe filluan të luteshin. Lutjen me zë e bëri Koci. Tre të tjerët i përsëritën me vete fjalët duke kujtuar misionarët e tjerë, që ishin përndjekur dhe persekutuar. Ata janë të shumtë në historinë e përhapjes së Biblës. Të katërt e ndienin shpirtërisht se duhej të bëhej një sakrificë, e cila në vend, që t’i frikësonte e t’i bënte të hiqnin dorë nga besimi, po ndodhte e kundërta.

“Mjerë ata, që e quajnë të mirë të keqen dhe të keqen të mirë, që ndërrojnë terrin në dritë dhe dritën në terr, që ndërrojnë hidhësirën në ëmbëlsi dhe ëmbëlsinë në hidhësi!” Isaia 5, 20 Bibla

Dielli sapo kishte lindur. Ata e ndjenin dritën e tij nëpërmjet dritares së qelisë sipër kokave të tyre. Më tepër se kjo dritë dielli, që vinte e cunguar, një dritë tjetër u mbushte zemrat. Ajo ishte drita, që mposht errësirën. Ishte drita e Jezuit, që i ngrohte e i ndriçonte në këtë qeli të izoluar e të akuzuar. Ishte e vërteta, që do të dëshmonin si e vetmja *rrugë*, që sjell *shpresën e dashurinë, paqen e mirësinë*.

Në pritje për t’i sqaruar, pse i sollën këtu, ditët shkonin dhe me ata s’po bëhej asgjë. Por siç ndodh rëndon, në këto raste, djemtë

po dëshmonin qëndresën e tyre. Policët ju sillnin ushqimet pa ju thënë asnjë fjalë. Burri, që bërtiste po ndihej gjithnjë e më pak.

Po ky ç'ka që s'po thërret, - u tha një gardian. Lutjet e tyre ishin dëgjuar dhe kishin bërë, që ai të qetësohej dhe të gjente pak shërrim. Edhe i çmenduri u shërrua nga lutjet tona, do të kujtonte Ligor për këtë ndodhi, si sprovë e besimit të tij, e pa kthyeshmërisë dhe pranimit të çdo sakrifice. Atëhere kur nuk e pret, Zoti ta jep mrekullinë.


Një ditë në burg thirrën një prift. Atë e pyetën se çfarë ishin librat, që kishin sjellë me vete nga Korça. S'janë me rëndësi, ju tha prifti, libra kishe janë e nuk foli keq për djemtë. Kështu i lanë të lirë me kusht të paraqiteshim në mëngjes edhe në mbrëmje.

Atëhere dolën në pazarin e Tiranës, si Shën Pavli në Romë me një tavolinë dhe filluan të shisnim librat e shenjtë, Biblat.

Ligor Çina dhe Nasi Lubonja u pagëzuan më pas në një lumë. Kështu do të shkruajë David M.Young në veprën e tij “Shqipëria: Çmimi” fq 69.

Himni i tyre i preferuar, gjatë atyre javëve do të ishte “Ein feste Burg” e Martin Lutherit:

Fortesë e fortë është Zoti ynë
Dhe e pa tundur mbrojtje
Mbretëron mbrojtësi ynë
Nga vdekja na sjell rrojtje.
Se gjithë, ai armik
Kërkon të futë intrigë
Të shumtë e ka fuqinë
E mbushur me mëri
Që ky mbi dhe s’ka pasur shok.



Pagëzimi i Ligorit dhe Nasit nga Edvin Jacques në lumin e Shetros.

Dashuria për Korçën e njerëzit e saj

Korça e viteve 1920-1930 rrezatonte një qytetari të ngritur në dy shtylla. Së pari ishte arsimi me “Shkollën e parë Shqipe” e “Liceun Frances”, që u bënë pionieret e formimit të intelektualëve të moderuar në të gjitha fushat e dijes. Liceistët e kësaj shkolle merrnin formim të nivelit evropian dhe shumë prej tyre ndiqnin predikimet e misionit ungjillor, siç ishte edhe Koci Treska diplomuar për filozofi. Ai ishte pagëzuar një vit më parë se Ligori.

Së dyti ishte përgjegjshmëria e banorëve të saj për t’i dhënë qytetit dimension bashkëkohor. Ky mentalitet ndihej në mendësitë e shprehura me guxim në qerfullën e diskutimeve jo konformiste të kohës. Tribunë e këtyre mendimeve ishte revista “Bota e Re”. Lexuesit e saj ishin të të gjitha moshave. Në to do të kënaqnin shijet e tyre edhe të rinjtë korçare, të cilët do të gjenin informacionet më të reja në të gjitha fushat e dijes.

Sa do të rëndësishme, që mund të jenë tërësia e informacionit, ato nuk mund të zëvendësojnë *librin e të gjithë kohërave Biblën*, që ndryshoi botën dhe përligj interesat e të gjithë moshave dhe gjithë intelekteve. I vetmi burim i plotë, që tregon shkaqet dhe siguron zgjidhje për të gjitha problemet e jetës është *Bibla*.

Ligori ndiente krenari për historinë e këtij qyteti, që do të ishte dhe qyteti i vendlindjes sonë. Të jesh korçar nuk i shpëton përgjegjësisë ndaj asaj çfarë paraardhësit kanë bërë për të. Fëmijëria e rinia e tij përkonte me kohën kur investimet private dhe filantropike të familjeve të pasura korçare i jepnin qytetit bibliotekën, spitalin, Kishën e Shën Gjergjit, ndërtesën e Rakollarëve, shtëpinë e doktor Polenës etj, dhe ai rritej së bashku me të. Në gjithçka, që ndërtohej kishte stil dhe kërkesa të larta për të sjellë në qytet një surprizë të bukur. Po veçoj ndërtesën *shtëpia rumune*, që edhe sot i jep qytetit pamjen e një ansambli arkitekturor urbanistik unik. Për historinë e këtyre ndërtimeve ai fliste shpesh, jo vetëm për faktin se me profesionin e tij ai ishte pjesë e mirëmbajtjes së tyre, por e shqetësonte ai uniformitet ndërtimesh me apartamente, që u ndërtuan gjatë viteve 1950 - 1980 dhe nuk siguronin kushte minimale të jetesës. Ato nuk i shtonin asgjë të re pamjes së qytetit dhe urbanistikës së saj. Qytetin ai e quante belvederen e Moravës. E privilegjuar të lidhte Shqipërinë me tre shtete ballkanike. Ajo i kishte të gjitha risurset për të qënë qendër tregëtare e kësaj pjese të Ballkanit. Nuk është rastësi, që pazari i saj është një ndër më të mëdhenjtë në këtë zonë. Ruajtja e bukurisë befasuese së hyrjes së Korçës është detyrimi i çdo gjenerate. Sa më e përndritur shpirtërisht të jetë gjenerata, aq më mbarë do të shkojnë punët.

Gjurmët e formimit ungjillor do të mbeteshin në sa e sa të rinj të qytetit të Korçës, formësuar me virtytet e një njeriu, që di të ekuilibrojë e të ndërmarrë vendime të pjekura. Por në rastin e figurave të shquar, ky dimension bëhet edhe më domethënës. Në një veprimtari përkujtimore të VUSH dhjetor 2012, një lapsus e solli, që të ftohëm edhe të marr një fjalë përshëndetëse si e bija e veprimtarit të kishës ungjillore, Ligor Cilkës, figurë me kontribute të shquara atdhetare e intelektuale. E ndodhur ngushtë në këtë keqkuptim them se unë jam e bija e Ligor Çinës, dhe në sallë

ndodhet një mbesë e Ligor Çilkës, të cilën e ftova që të dëshmonte. Ajo ishte Ines Cilka një vajzë e re, të cilën ma kishin rekomanduar që më parë, se do ta takoja aty. Prezantim më të bukur nuk mund të përfytyrohej. Por, ju them se u ndjeva mirë, që emri i babait tim, një besimtar i thjeshtë e i përunjur, kujtohej sot me një figurë si Ligor Cilka. Predikues ungjillor i zjarrtë, patriot i flaktë, mbështetës i çështjes së pavarësisë së Shqipërisë, bashkëkohës me Gjerasim Qiriazin. Dihet, që brezi i besimtarëve të Ligorit rreth tre dekada më vonë, do të ishin pasues të punës së tyre. Dhe pas këtij incidenti shumë domethënës ndodh dhe tjera. Pranë meje ishin ulur Xhevat Lloshi e Teuta Toska, një besimtare dhe studiuese e historisë së këtij besimi. Teuta më thotë se emrin e babait tuaj, Ligor Çina e kam gjetur në dosjet e sigurimit me materiale rreth lëvizjes ungjillore në Shqipëri, si veprimtari e përgjuar dhe e përndjekur prej tyre. Teuta, kishte shkruar dhe një artikull në gazetën Panorama, më 22 korrik 2010, me titull “Ungjillorët në dosje”. Ky ishte një titull redaksional.

HISTORIKU.

I MISIONARËVE UNGJILLORË (AMERIKANË) KENEDY, HENRY DHE DANIEL LEVIS (NISI LAGO)

Qysh nga viti 1908 kishte ardhur ne Korçe Phineas B. Kenedy me te shoqen e tij Violeta, te derguar nga misioni ungjillor me qender ne Washington (Amerike) per te "propaganduar lidhur me fene protestaneqe te dy keta (bure e grua) ishin Amerikanë dhe ketu u stabilizuan duke marë nje shtëpi me qira. Femije nuk kishin. Aktivitetin e pare e filluan duke shperndare ne femijet e vegjel kartolina te ndryshme e te bukura fetare me fytoren e Krishtit. Me vone shperndanin edhe libra te vogela fetare gratis. Duke vepruar ne kete menyre shtepija e tyre ku banonin frekuentohesh vazhdimisht nga femije te vegjel, te cilët genjeheshin dhe pasionoheshin pas bukuri te fotografive te kartolinave, e ne vazhdim aktiviteti i tyre filloi qe te zgjerohet edhe me shume e gradualisht sepse banesa e tyre frekuentohesh edhe nga femije me te ritur, pastaj femera (gra e vajza) dhe djem e burra. Gjat kohes qe hynin njerez te ndryshem Kenedy u lexonte dhe u predikonte edhe pjese te ndryshme nga te ungjillit dhe te Apostujve te ndryshem, predikime keto qe zenin vend ne nje pjese elementare te pasionuar pas fese keshty influenca e Kenedyt vazhdimisht po rritej dhe ky lloj elementi filloi te kete shume besim te ky.

Aktiviteti i tij (per fene protestane) u nderpre nga shkak i luftes Ballkanike, keshtu ne vitin 1912 Kenedy me te shoqen e tij Violeten laggohen per ne Amerike.

Ne vitin 1924 kur erdhi zogu ne fuqi dhe u stabilizua pushteti i tij, Kenedy bashke me te shoqen e tij rikthehet ne Korçe ne vitin 1925 dhe fillon perseri aktivitetin e tij ne forma me te regullta dhe me me baza. *Cent. i. i. i. 1933.*

Faja protestane ka shume degje, por degje qe ndiqte dhe qe predikonte ky ishte "Baptizmi" d.m.th. "pagezimi" per te cilin me gjere do te flitet edhe me poshte.

Kenedy qysh ne fillim te vitit 1925 qe u stabilizua ne Korçe kishte bere kerkese prane autoritetit te vendit (Prefektures Korces) te lejojehet qe blinte nje shtepi qe ta perdorte per banese e per shkolle. Kjo kerkese me gjith se ishte e ndaluar me vendim te Keshillit Ministruar qe shtetasit e huaj nuk kishin te drejte te blejne pasuri ne shtepi, me gjith ate ish Prefekti i Korces B. Villa me shkresen Nr. 857 date 8/III/1925 qe dergon ne Ministrin e P. Brendeshme Tirane (Seksionit II-te) propozonte dhe qfaqte mendimin qe ne kete rast te behet nje perjashtim dhe Kenedy te lejohet ne kete drejtim, mbasi u aprovua kjo kerkese, Kenedy filloi punen duke blere nje shtepi te madhe ne Korçe per llogari te mesimit ungjillor qe perfagesonte ky ne ate kohe, kjo godine eshte ajo ku sot eshte poliklinika e shtetit.

Duke patur nje teren deri diku te pregatitur qysh me pare sikur se u tha me lart, ky filloi nga aktiviteti i ri, duke shperndare perseri libra te vogla e kartolina te bukura fetare. Puna e tij u zgjerua shume dhe kur pa se shtepija e tij po frekuentohesh nga shume njerez ne menyre te regullte, oakti edhe nje program (orar) lidhur me predikimet. Keto i be te dy here ne javet, te Merkuren me darke prej ores 7 deri 8.30 dhe te Dielen ne mengjes prej ores 9 deri me 10 per femijet, kurse per te ritur prej ores 10-11.30 para dite.

Ne vitin 1925 me aprovimin e qeverise atehereshme Shqiptare (Ministria Aresimit) qeli nje shkolle qytetese me 6 klase ne Korçe, ku ketu

Një faqe e shkëputur nga material i dosjes së sigurimit
mbi veprimtarinë e ungjillorëve

Ajo ma postoi artikullin, bashkë me fotot nga dosjet *për të më shuar kureshtjen*. Kam ndjerë dhimbje edhe një protestë të brendshme e të heshtur për viktimizimin e njerëzve, që mendonin ndryshe nga shumica. Natyrshëm ndieja revoltën e absurditetit të rrezikshmërisë së një besimtari ndaj shoqërisë. Të parit e tyre si bashkëpunëtorë të amerikanëve, në rastin e Ligorit me një figurë e personalitet kulturor si Edvin Xhejksi. Autor i një monografie prestigjioze “Shqiptarët” dhe “Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme”, “Kartë e pendë”, “Lajmi i mirë”, etj. Kjo do të thoshte, jo vetëm të mos njohësh miqtë e vërtetë, por të dëmtosh kombin tënd në rradhë të parë. Prandaj, ai e priti me shumë shpresë ndryshimin e regjimit. Jeta e tyre na bën të jemi më të ndërgjegjshëm për fatet e atdheut dhe lirinë e individit. Në letrat, që babai mori para ardhjes së Xhejksit në Shqipëri në vitin 1992, ai i shkruante, se Shqipëria për të ishte atdheu i dytë, dhe se po shkruante historinë e saj, se kishte mall për dy qytete, për të cilat kishte dëshirë të shkonte e t’i vizitonte, Korçën e Elbasanin ku kishte jetuar për disa kohë. Kuptoj se sa shumë Xhejksi ishte i lidhur shpirtërisht me Shqipërinë edhe njerëzit e saj. Nga ana tjetër kuptova, se sa e kishte vuajtur babai im këtë persekutim. Sa shumë më fliste heshtja e kujdesi i tij për të mbrojtur jetët tona! Sakrificat e lodhja fizike e profesionit, ndërkohë me kulturën që kishte, ai mund të ushtronte edhe një profesion tjetër. Por ai asnjëherë nuk iu ankua njeriu dhe jetoi me shumë dinjitet deri në ditën e fundit. Në fjalën, që ai kishte mbajtur në Tiranë, me rastin e zgjedhjes së tij si President i Vëllazërisë Ungjillore, më tregoi se kishte thënë: - *Nuk duhet të flasim me gjuhën e urrejtjes, nuk duhet të përdorim ato forma edhe mjete, që përdorën kundërshtarët e fesë, gjuha jonë duhet të jetë gjuha e dashurisë dhe e faljes. Ateistët le ta marrin gjykimin nga Zoti. Ne duhet të punojmë për të fituar kohën e humbur.*

Kur kthehem në kohë, e kuptoj pse ai ishte aq tolerant e i durueshëm. Maturia e tij matej me veprim. Në vitet 1960-1970 pati shumë internime të familjeve për agjitacion e propogandë, disa prej tyre ai i njihte mirë. Në orën katër të mëngjezit ndiheshin trokitje të lehta në derën e shtëpisë sonë. Një burri prej familjes Zguri, që vinte nga larg, internuar në fshatrat e malësisë së Voskopojës, më shumë kujdes e fshehtësi do t'i jepte dy pllaka bukë, të cilat i kishte hequr nga racioni i familjes së tij me gjashtë fëmijë. Në punë do t'i caktonin të punonte me djem të rinj, që nuk shtroheshin, por që *disiplina* e tij do t'i kthente për së mbari. Në ndërmarrjen e tij punësoheshin të deklasuarit ose sabotatorët e Partisë dhe ata do të ishin miqtë e tij më të mirë. Fisnikëria e tij buronte nga dëshira për t'iu ndodhur tjetrit pranë e pa mburrje. Si bojaxesha do të punonin me të edhe gra të *familjeve të deklasura dhe ai i respektonte si zonja*. Për vite me radhë punoi me Jorgji Duron që e kishin pushuar nga puna në Komitetin e Partisë, se nuk ju përgjigj thirrjes për të shkuar në fshat. Dhe ai vetë do të ndihej sa e sa herë i kallëzuar se punonte jashtë orarit si privat, që të plotësonte nevojat e familjes. Të gjithë të persekutuar në një vend *ku ishte shkelur e drejta e Zotit*.

Krijoi një familje të rregullt, bëri shumë sakrifica për t'i studiuar të gjithë fëmijët. Nga gjashtë fëmijë, katër prej të cilëve vazhduam shkollën e lartë. Në çdo kohë e në çdo moment kishe çfarë të mësoje e të merrje shembull prej tij.

I vetmi ngushëllim për të do të ishte leximi i Biblës. Edhe në kohët e sotme ky lexim merr dimensionin e shpresës për t'u ringritur e ndërtuar një botë të re, të paqes e dashurisë. Të një botë ku e mira fiton mbi të keqen, ku i pasuri ndihet i varfër shpirtërisht, dhe varfëri i pasur, sepse e ka zemrën plot me dashurinë e Krishtit. Drita e tij i mbush shpirtin dhe mposht errësirën për të ecur drejt një bote në drejtësinë e Perëndisë.

Ungjillizimi, atdhetarizmi fetar

Literatura fetare në Shqipëri, por edhe në vendet e tjera është e lidhur ngushtë me historikun e dokumentimit të shkrimit. Në rastin tonë me shkrimin e gjuhës shqipe. Përkthimet nga kjo literaturë janë quajtur fillime të letërsisë së vjetër shqiptare. Ky bashkërrugëtim datohet hershëm. Fillon me shkrimin në gjuhën shqipe të *formulës së pagëzimit* nga Pal Engjëlli dhe vazhdon me përkthime të fragmenteve të Biblës. Nëpër të çarat e doktrinës së krishterë do të lindte edhe letërsia shqipe. Krijimet e mirëfillta letrare fillojnë me autorë të letërsisë së vjetër si Fran Bardhi e Pjetër Bogdani etj. Kontributi i këtyre pionierëve të letërsisë shqiptare nuk mund të shkëputet nga formimi i tyre fetar. Dhe bindjes se misionin, që po kryenin ishte i shenjtë e i bekuar prej Zotit. Se shqipja, si gjuhë e vjetër dhe letërsia e saj do të përndritej për të qënë e aftë të pasqyrojë e të zbërthejë njeriun dhe botën. “*Gjëma e madhe e mëkatit*” e Mitrush Kutelit është sprovë stilistikore e filozofike e mesazhit të atdhetarizmit fetar, ku toka e qielli, parajsa e ferri, dashuria e pendimi, mëkatimi edhe shëlbimi janë dhuratë e hirit në jetë të jetëve. Në fëmijërinë time kam dëgjuar të kënduar prej tij një poezi të Gjasim Qiriazit “Puno sa është ditë”. Dhe

sot e kësaj dite në vargun e saj ndiej trokun i ditëve nën hapin e kalorësve të dritës. Mesazhi i poezisë ka kuptimin universal biblik të veprimit, pa të cilën *fjala* nuk do të sillte *krijimin*. Pa të cilin edhe besimi nuk do të transformonte *botën e njeriun*. Dhe njeriun ta bëjë hero të kohës së tij, me detyrën që i ka dhënë Krijuesi në krijimin e botës.

Gjerasim Qirazi

“Puno sa është dita”, sot vargu yt po kumbon!
Si kalorës i dritës ëndrrat e atdhetarëve bekon,
nën trokun e saj, dhe koha jonë “ecën dhe shkon”.

Mendimtar e mjeshtër i fjalës, e arta fjalë
shqip buron prej zemre. Mjaltë e qumësht
rrjedhin prej Biblës, errësirën na largojnë.

Puno sa është ditë, “Hero” edhe nata s’ mjafton
dita është e shkurtër, si një kalorës ecën e shkon
“Gjerasimët” që nuk shuhën, brezave u kujton!

Epilog

Nuk ka qënë e lehtë për mua të filloja të shkruaja këto kujtime. Përgjegjësia që ndieja, nuk kishte të bënte me faktin se do të shkruaja për një nga njerëzit më të dashur për mua, siç është babai, por se sa do të arrija ta jepja të vërtetë në thjeshtësinë e modestinë e tij si *një njeri në besim*. Por ndodhi e kundërta, kujtimet u shkruan shumë shpejt. Ato më mbushëm edhe më dhanë një dimension të ri në jetë, që nuk e kisha menduar më parë. Pata vetëm ndrojtjen e të hedhurit të tyre nga dorëshkrimi në botimin e tij. Sa më shumë kohë kalonte aq më shumë bindesha se edhe të tjerët duhet t'i lexonin ato. Sjellja në kujtesë e këtyre çasteve kuptimplotë që më çuan në kohë të largëta, vlejnë për të përmirësuar vetëbesimin për të ardhmen. Kemi nevojë për të shkuarën, për të provuar se kemi një histori sa familjare aq edhe komunitare e shpirtërore. Gjatë kësaj kohe u shkrojtën edhe dy vëllime me poezi “Ditari i gushtit” dhe “Bota pa stinë”.

Fjala e shenjtë

Ku është fjala e shenjtë
Është dera e zemrës!
Është e hapur nuk do trokitur
Mjafton të besosh në mrekullinë e saj
Të gjithë bëhemi
Njerëz më të përunjur e më të përndritur!

Nga vëll. “Ditari i gushtit”

*Ligori e donte jetën e jetoj me stoicizëm,
sepse forcën e gjente tek ungjilli, dashuria për të cilin
ishte amaneti i tij i fundit*

...në vend të pasthënies

Kur shkruhej libri, ngjarje e ndjesi, emocione e vlerësim. E kaluara edhe e tashmja të shkrira në atë, që ka vetëm një kuptim “Kreu i kishës është Krishti”. Të gjithë sa besojnë në Atë dhe pagëzohen në emrin e *Trinisë së Shenjtë* bëhen gjymtyrë e trupit mistik të Krishtit “që është Kisha” (Kolosianët. I:24).

E ardhmja e saj është rruga e përhapjes së Fjalës së Biblës.

Në kërkim për të biseduar me pastor Jan-in

Mëngjesi i 4 marsit 2016 u gdhi i kthjellët. Shiu i rrëmbyeshëm e më pas me llohtë i një dite më parë e uli ndjeshëm temperaturën. Pavarësisht nga kjo pabesi e natyrës, kudo ndihej ardhja e pranverës së hershme. Qyteti i Korçës të fton mikpritshëm me ndryshimet e kudo ndodhura e të kthen gjithandej fytyrën e tij të qeshur. Kurorat e lulëzuara të pemëve janë po aq të pafajshme sa edhe vargjet e shpirtit, që poetet korçare mendojnë të na i dhurojnë sot në mbrëmjen e tyre poetike. Ajo janë buqeta më e bukur në pragon e dy festave ndër më kuptimplotë “7 - 8 Marsi”.

Më pret një ditë e ngarkuar me takime e veprimtari. Nxitoj të printoj programin e eventit e të shkoj në biblotekën “Thimi Mitko”. Dua t’i lë disa kopje mbështetësit të botimit të vëllimit tim poetik “Bota pa stinë” motrës së tij, Flora Lames e të takoj mikun tim të vjetër, Skënder Rusi. Biseda me Skënderin të çon vetiu tek poezia, aty, ai ka gdhendur shpirtin e këtij qyteti. Poeti më dhuron librin e sapo botuar. Në pritje për të më shkruar dedikimin, ai vendos gishtin e ngjyer mbi fletën e librit. Ashtu si gjyshi im, dekada më parë, kishte firmosur vërtetimin e pagëzimit për birin e tij. Edhe poeti po linte në fletë ADN e shpirtit. Me emocione

ndahem prej tij, sepse në orën 9 – 30 do të takohem me Karolinën tek ndërtesa e fondacionit. Duket se rrugët e qytetit jetojnë me shqetësimin të bashkojnë sa më parë njerëzit, që duan të takohen. Pa marrë kthesën e rrugës së Kishës e të Fondacionit Kenedy, takoj pastor Ian. Njeriun që mendoja se tani, që libri i kujtimeve kishte përfunduar, mund të më vërtetonte më mirë se kushdo tjetër, se *secili prej nesh është një art i veçantë në punën me Zotin*. Me mendimin se takimet po më shkonin shpejt, Iani më thotë, se Karolina më priste tek Kisha, dhe se ai, sa të mbaronte një takim, do të ishte i disponueshëm për ne. Me pastor Albanin shkojmë dhe takojmë Carolinën. Me fytyrën e qeshur, me fjalët e zgjedhura tanimë, që edhe shqipen e kupton dhe e flet mirë, ajo është bërë një nga konsulentet e mia për problemet, që më dëlnin gjatë shkrimit të librit. Më fton, së pari në një ambient ku mund të ndiheshim ngrohtë e të flisnim qetësisht. Ulemi në “Vilën Themistokli”. Në dhomën me vatër digjen kërcunjte e trashë e zjarri i kujtimeve tretet në prushin me flakën e ngadaltë. Një djalë i vogël i afrohet zjarrit të shpushpurisë gaca e t’u gëzohet lojës së tyre, pa pasur ndroje dhe habitet me frikën tonë dhe nuk e njeh rrezikun që na shkon ndërmend me lojën e zjarrit. Ai e rrezaton gëzimin e tij në gjithë dhomën, ndërsa mua mendimet me shkojnë larg tek prushi i kujtimeve, që mbante të gjallë babanë.

Karolina është një grua e thjeshtë edhe shumë modeste. Kur i kërkon që të flasë, ajo të tregon vetëm për projektet e Kishës, që tashmë janë bërë realitet. Mjafton t’i hedhësh një sy sallës “Vatra e Vëllezërve” për të kuptuar punën e Kishës që bëhet me moshën e tretë. Ajo me sytë e përlotur të thotë, se këtu mes tyre do të ishte edhe xhaxhi Ligor. Takojmë Ali Duron dhe të birin, të cilët të flasin për punën e tyre me grupin e burrave. Ndërtesa është shumë funksionale. Klinika dhe ambientet e fizioterapisë për kujdesin shëndetsor prej kohësh shërbejnë për njerëzit në nevojë. E tillë është

godina e “Fondacionit Kenedy”. Një godinë shprese dhe e Lajmit të Mirë. Shtëpia e familjes së madhe në Krisht. Kujdesjet nëpër shtëpitë e të moshuarve nga personeli i Kishës vazhdojnë prej disa vitesh. Atyre u janë shtuar “Shtëpia e vajzave” dhe “Shtëpia për mbrojtjen e grave në rrezik”. Veprimtaria e Kishës Ungjillore është bërë pjesë e zgjidhjes së problematikave më të mprehta sociale të qytetit. Nuk mund të lëmë pa përmendur punën e bërë në burgun e Korçës, dhe me familjet e tyre. Kudo, fjala e dora e Zotit, ua mbush jetën dhe i ripërtërin! *Qëllimi është t’i ndihmojnë njerëzit e mirë, jo të arratisen nga vuajtjet e tyre, por t’i mbajnë ata me një zemër të guximshme, me një guxim, që gjen forcën e tij në besim.* Me dhembshuri nëne Karolina të tregon dhe për fëmijët e ndryshëm, por të barabartë para Atij, që u ka dhënë jetën, fëmijët me autizëm apo me probleme të ndryshme, që këtu gjejnë një strehëz të ngrohtë dhe reabilituese. Dhe jo vetëm kaq. Këtu zhvillohen kurset e mësimit të gjuhës angleze, mësim edhe për fëmijët me autizëm, por edhe për fëmijët dhe të rinj në mosha të ndryshme, mësimet në azil etj. Një veprimtari e institucionalizuar me punë e ambicie. Por në sytë e Karolinës kuptoj se ka ende për të më treguar. Me sytë e përplotur më fton të shkojmë tek “Vila Kenedy” residencial. Pak e nga pak duket se po preknim “Qytetin e Zotit”. Rruga për tek vila i ngjitet kodrës. Ajo më sjell kujtime, si për vete edhe për rininë e babajt tim. Mimoza, i thotë Karolina motrës, të shoh që vjen shpesh këtej për vrapin e mëngjesit. Por sot, ishte diçka ndryshe për ne të treja.

Brenda vetes na flisnim zëra. Më shumë se fjalët na fliste heshtja para asaj godine të ngritur mbi kodrën Kenedy. *Lavdi Zotit, që u mbodhën fondet për këtë ndërtesë, është një mrekulli, shqipton me zërin e zemrës Karolina. Këtu do të ishte edhe Berti Theodhosi, vetëm katër muaj më pas si ai u nda nga jeta, u inagurua ndërtesa.* Qyteti shtrihej poshtë i bukur e i lumtur sikur mban në krah këtë ndërtesë për t’ia drejtuar qiellit. E hapim derën e godinës

me kujdesin që të mos ndihemi, e tek vështrojmë koridoret e pastra, e përtej xhameve banorët e saj. Një pjesë e tyre të ulur rreth në një sallë çlodhje ndjekim instalimin e një loje, ku mund të luanin së bashku. I takojmë një për një duke ndjerë në shtërngimin e duarve të tyre dashurinë për njerëzit. Ata kanë shpesh vizitorë, sepse kjo është shtëpia e madhe e tyre.

Kur erdhëm këtu, menduam se jeta jonë kishte përfunduar, por në fakt, jeta jonë filloi këtu të thonë banorët e moshuar të saj, sepse kemi gjetur besimin në Zot!”

Këto fjalë janë një bekim dhe për ata, që ju shërbejnë këtyre njerëzve me dashurinë e perëndisë, ditë e natë, në kushte shumë të mira, për të kaluar në paqe çdo minutë të jetës së tyre. Duke u ndalur në dhomat e veçanta shohim kushtet, që u ofrohen dhe zemra na bëhet mal. Ju urojmë shendet, mes emocioneve të pashlyeshme këmbëjmë edhe disa fjalë. Ata, jo vetëm na njohin, por na flasin për jetën e tyre në Vilë. Të gjithë janë të rrethuar nga përkujdesja e shërbimi, e mrekullueshmja Karolinë së bashku me personelin, si motra e tyre rrezaton mirësi e dashuri. Ndahemi prej tyre duke ndjerë mall si të ishin njerëzit tanë të afërt.

Të ngrohte shpirtin dashuria e Perëndisë reflektohej ndërsa u shërbehej këtyre njerëzve! Lavdi Zotit!



Vizita në rezidencën e të moshuarve

Të ngarkuar emocionalisht zbresim nga makina në qendër të qytetit. Përsëri takojmë pastori Ian. Edhe këtë herë, ai qëndron fare pak me ne. Ndërkohë, që vizitojmë përsëri fondacionin, nisemi në kërkim të Ian. Ai është gjithnjë në lëvizje edhe takimet e le sa në një vend tek vendi tjetër. Si një bari që kujdeset të zgjedhë barin më të mirë për grigjën e tij. Ecim në trotuarin e bulevardit, që është i mbushur plot me njerëz. Herë pas here ndalemi që t'i takojmë. Janë kolegë të mij në vite, por edhe anëtarë të vjetër të Kishës. Si Elda Zavalani, së cilës para pak kohësh i është ndarë e ëma nga jeta. E kujton me dhimbje e bindur se sa më shumë vite të kalojnë, aq më shumë do ta ndjejë mungesën e saj. Ngushëlohem se një ditë këta njerëz të perëndishëm do t'i takojmë në parajsë, i themi ne. Eh, më thotë Elda, edhe xha Ligorin e kishim njeriun e shtëpisë.

Me kujtimet, që trazojnë të gjallë e jo të gjallë më në fund takojmë Ian. Na priste me kafën përpara, mbas përshëndetjeve të përsëritura gjatë ditës, mua më takonte të hyja drejt e në temë.



Takoj pastor Ian njeriun që mendoja se tani që libri i kujtimeve kishte përfunduar, mund të më vërtetonte më mirë se kushdo tjetër, “se secili prej nesh është një art i veçantë në punën me Zotin”.

Jan-it i bëhen njëzet e pesë vjet në Korçë. Jeta e tij, tashmë është e lidhur me njerëzit e këtij qyteti dhe Kishën si pjesë e trupit të saj. Erdhëm të rinj edhe pa përvojë, në një ambient të panjohur për të huajt, fillon të na tregojë ai, i ndërgjegjshëm për vështirësitë e misionarit. Një nga arsyet që Kisha e Korçës ka qënë aq e sukseshme, dhe ndërsa sytë i mbushen me lot prej fjalëve që i burojnë nga zemra, ai mendon se ne në atë kohë, kishim njerëz pleq, të thinjur për të na këshilluar, për të na dhënë orientim kulturë e besimi etj. Ne gjetëm një urë të ngritur nga pastore të tjerë rreth

katër dekadash më parë. Me njerëz të tillë të kalitur në besim ishte shenja e dhënë nga Perëndia për rrugën që duhet të ndiqnim. Nuk kishim njerëz të tjerë për të na folur, mund të pinim një kafe me xhaxhi Ligorin dhe me pak fjalë ai na ka dhënë drejtim, orientim, shpresë. S'kishim telefona ose njerëz të tjerë, që të kishin qenë para nesh për të na drejtuar. Por xhaxhi Ligor ka qenë i aftë për të na orientuar e trajnuar. Ne e kuptuam shumë mirë njeri - tjetrin. Dhe stafetën që njeri brez duhej t'i linte brezit tjetër.

Ligori ka qenë *gjyshi* për të gjithë udhëheqjen e kishës së sotme, - vazhdon bisedën Ian. Arjanit në Bilisht, Donit në Ersekë, Plator në Maliq, Aliut, unë dhe Ollgeri në Korçë. Të gjithë në kohë të vështira i kujtojmë fjalët e tij dhe shembullin e tij. Duke ecur në gjurmët e tij, ne kemi kuptuar, që s'mund të kontrollojmë jetën e njerëzve të tjerë, por vetëm mund të ndikojmë tek ata. Ai ishte njeriu i duhur, që njerëzit e lirë i fuste në orbitën e punëve të përbashkta. Dhe xhaxhi Berti e ka modeluar jetën e tij sipas parimeve të Ligorit. Ishte mrekulli t'i shikojë të dy si punonin për rregullimin e shkollës së Progërit!

Fjala e të krishterit sipas Ligorit, - kujton Ian, duhet të godasë:

- Jo me çekan, por me pupël dhe çdo ditë.

Vendet, ku kemi Kisha sot, janë vendet ku xhaxhi Ligor ka qenë për ungjillizim. Ishte ideja e tij për të shkuar nëpër fshatra. Tani ka kisha në Bilisht, Ersekë, Libonik, Vlocisht, Pojan, Plasë, Maliq, Kamenicë e Sheqeras, gjithashtu zhvillohen rregullisht takime në Mborje, Rëmbec, Maliq dhe Ponçarë të Bilishtit. Të dyja me Karolinën dëgjonim fjalën e tij si një dëshmi, që nuk mundëm ta regjistronim, por ia vlejti të rendje pas pastorit Ian.

Pa e kuptuar koha kishte fluturuar.

"Lëvdimi i përket burrit në arenë, fytyra e të cilit është përbaltur prej pluhurit, djersës dhe gjakut, atij që përpiqet guximshëm, që njeh gëzimet e mëdha, përkushtimet e mëdha, që e tret jetën në një çështje të denjë, që në fund të fundit në rastin më të mirë shijon triumfin e arritjeve të mëdha, dhe në rastin më të keq, nëse dështon, të paktën dështon duke guxuar plotësisht, në mënyrë, që vendi i tij të mos jetë kurrë mes atyre shpirtrave të ftohtë dhe të frikësuar, që nuk kanë përjetuar kurrë as fitore dhe as humbje."

TED ROZVELT

Të nesërmen u nisa drejt Tiranës, duke marrë diellin e pranverës me vete dhe bukurinë e vargjeve të poeteshave korçare, thuaj se kishin lindur për t'i kënduar dashurisë hyjnore. Në zemër i kisha bërë vend Zotit. Në qiellin e kaltër, aty - këtu më përshëndesnin re të bardha ku mbështilleshin puplajat e engjëjve.



*Qyteti shtrihej poshtë i bukur e i lumtur sikur mban në krah
këtë ndërtesë për t'ia drejtuar qiellit*

Më poshtë kam hedhur për lexuesin një pjesë të mesazheve, që kam këmbyer me miqtë e tij, misionarë të huaj, që kanë punuar e punojnë me gjithë shpirt për përçimin e ungjillit dhe lartësimin e emrit të Perëndisë dhe kishës ungjillore në Shqipëri.

Michael Brown

10/31/2011

Yes indeed, mirepo kam qënë aq i zënë sa që s'po arrij dot të të jap përgjigjet e duhura... Siç thoshte xha Ligor i aq shpesh, “avash - avash” me një të pirë të gotës në shtëpi...

Michael Brown

8/25/2011

E dashur Zhuljeta,

E mora e-mailin e mëposhtme nga zonja Diana që e kam njohur prej vitesh që kur punoja në Korçë. Babanë tënd e njoha për herë të parë që në vitin 1991 kur erdha në Korçë, dhe lidhjet me të i mbajta të ngushta derisa vdiq disa vite më vonë. Do isha i kënaqur të kisha lidhje edhe me ty të të jap informacion aq sa kam për Ligorin.

Majku

AEM (office@aemission.org)

11/16/2011

E dashura Zhuljeta,

Ngrohtësisht ju falenderoj për imail tuaj rreth babës suaj fare të nderuar. Ju lutem, bëjuni të fala familjes së tij në Korçë! Fotografitë, që i kam i mora nga familja, pra mendoj se tashmë ju i keni. Atë që e di për atë e botova në librat, që mund të gjinden në Shqipëri, ose prej librarisë së vogël të kishës ungjillore, ose nga z. Geoff Townsend (Gjirokastër) i cili vjen mjaft shpesh në Korçë, sidomos për t'i vizituar Niko dhe Monda Treskën.

Unë personalisht nuk kam asnjë plan për të ardhur prapë në Korçë - isha në spital në gusht kur shpresoja të vija - dhe në dhjetor do të dal në pension. Mirëpo, punën do ta marrë përsipër z. Paul Davies, i cili vjen në Korçë në lidhjen me punën e Misionit. Po t'i shkruani atij me siguri ai do të ketë rast për t'ju sjellë të gjitha fotografitë që i kemi këtej.

Gjithashtu, mendoj se i keni shkruajtur vllaut Mike Brown nese jo, jam i sigurtë që ai ka shumë kujtesa të dashura të Ligorit.

Ju uroj shumë sukses dhe bekim nga Zoti në kërkimet që po i bënë për këtë çështje, si dhe nga çdo anë të jetës suaj.

David Young

Larry & Dana Stucky

4 Nov 2011

Dear Zhuljeta,

Jam shumë e gëzuar për punën tënde edhe më shumë për bekimin e Fjalës së Zotit në jetën tënde. Sa mirë të jemi në prezencën e Tij. Lavdi Zotit për 20 -vjetorin e kishës Emanuel.

Me dashuri në Zotin tonë me respekt,

Djana

2011/10/30 Zhuljeta Grabocka

Dear Diana,

I hope you are finally settled, wish you all the best in your new location.

Today we celebrated the 20'th anniversary of the Emmanuel Church. In the celebration I met with John Quanrud and Artur Mills. It was a pleasure meeting them and listening to their memories. In the meanwhile I am reading the Bible and writing the book.

In case you could find some free time, I would appreciate if you send any materials or memories you posses on my father Ligor, especially the letter showing that Kosta (Ligor's father) approved the baptismal of Ligor.

God bless You and Your family!

Best regards,

Zhuljeta Grabocka

Larry & Dana Stucky

8/23/2011

E dashur Zhuljeta,

U kënaqa shumë me kohën tonë së bashku sot. Isha e bekuar nga historia e Ligorit që nga fillimi ynë në Korçë por edhe sot prej teje. Jam më shumë e gëzuar që ti beson plotësisht në Zotin dhe gëzohesh dhe rritesh duke lexuar Fjalën e Zotit. Sa e veçantë që ti shkon në takimet në Kishën Emanuel në Tiranë për të adhuruar Zotin dhe për të mësuar më shumë.

Tani po të dërgoj ty disa adresa e imail-it me emrat e njerëzve që mund të të ndihmojnë gjithashtu me informacion për babanë tënd, Ligor Çina. Kur të jem më e sistemuar pas një muaji do të të dërgoj ty më shumë informacion që kam për jetën e Ligorit.

Në dashurinë e Zotit Tonë,

Diana

Larry & Dana Stucky

8/23/2011

E dashur Zhuljeta,

Kam qef të takohem me ty sot në orën 1:30 mbasdite në Kishën Ungjillore.

Dana

Iancaralee

7/26/2011

E dashur Zhuljeta,

Me dëshirë do të kisha qejf të të takoj, por do të jemi në Angli për 4 ditë, por mund të jetë Dana Stucky, dhe mund të ketë kohë në qoftë se kontaktoje, do të vendosa adresën e saj sipër.

Me gëzim dua të të njoftoj që xhaxhi Berti është me Zotin dhe Xhaxhi Ligorin tani në parajsë. Ai e ka ngritur të shtunë, ora 10:10 natës, me shumë paqe. Funerali ishte shumë bukur, si xhaxhi Ligorit, dhe kemi kënduar disa nga këngët e tij më të preferuara..... do kemi shumë marr malli për atë, por gjithashtu e dimë se ku është dhe s'ka dhimbje ose vuajtje më, lavdi Perëndisë!!

Me dashuri,

Karalina

E dashur Karolina,

26/07/2011

Pas dates 4 Gusht do të jem në Korçë. Deshiroj t'u takoj dhe të bisedojmë rreth kujtimeve dhe materialeve që mund të mbledh për babanë. Ndërkohë do të përpiqem të kontaktoj me personat që më keni referuar.

Miru takofshim,

Zhuljeta

E dashur Zhulijeta,

Dana Stucky është kthyer tani nga USA, edhe sapo dëgjova që ka gjetur një fletëleje nga gjyshi tuaj për pagëzimin e Ligorit, mendova që mund të jetë një gjë e mirë për librin tënd, prandaj unë po i dërgoj emaili. Danas, gjithashtu David Young (aemission), që ka shumë informacioni për Ligorin, në qoftë se nuk jeni në kontakt akoma...

ZJB,

Karalina

PS Lavdi Zoti që ke folur me Xhaxhi Bertin kur ke ardhur, sepse tani nuk flet më pasi ka thrombos, dhe e ka shumë të vështirë ta komunikojë... ishte nga Zoti, që ke ardhur kur ke ardhur....

E dashur Karolina,

Faleminderit! Kujtimet për xha Ligorin, babain tim të dashur janë sa të shtrenjta për ju aq domethënëse për mua. Ato janë një jetë e mbushur me besim, sakrificë e dashuri, shembulli i një jete në Jezu Krisht. Lidhja jonë nëpërmjet kujtimeve të babait e bën të dyfishtë mirënjohjen.

Me dashuri Zhulijeta Grabocka Çina.

From: Iancaralee

Date: Thu, 10 Mar 2011 06:10:17 -0500

Dear Zhulieta,

It is with pleasure that I write some memories of xhaxhi Ligori, he is someone that we often remember for his faith and

example live on in all of us.... he is one of the most godly men I have met and known, and I wish I knew Albanian better when I knew him so I could have spoken more with him.....

You couldn't help but feel his wisdom and gentleness when you met him....

Some of the photos you have are from baptisms, the rebirth of the church in Korca was his dream, and we were privileged that we could help him realize this dream. He was the first elder appointed in the Korca Evangelical Church and the person we consulted with on most things.

He joined us on evangelism trips often, where we systematically visited all the villages we could get to in the region by Landrover...I'll always remember when we had to run away from Pirg, because they were throwing stones at us, he had stood and started speaking before we'd been ready to start, and before we had to run, and after we were safely in the car, he said, 'yep, that's what they did last time, but I wanted to give it another chance!' He said nothing about it before, so that we had no idea of the animosity he'd encountered before, he didn't want us going in with pre-judgment.

He was part of one of our first work projects, the rebuilding of the school in Proger, we were joined by a foreign team and a team from the Korca church, and for two weeks we daily visited the village and worked on the school and visited all the homes door to door. Xhaxhi Ligor and Xhaxhi Berti worked side by side, redoing the walls and then repainting them...they were quite a team, Xhaxhi Berti fired questions at him all day, and he always seemed to have an answer.

We attended a Bible Study at his home every wednesday evening, I remember one conversation in particular, when we were getting some attacks from the Orthodox church, some bad rumors

were being spread about us and some signs were posted.....he said, the way that you work with the Orthodox is not with a hammer, but with a feather, softly, gently, little by little....we got the message and did not attack back.

He also joined us on the early work in the town of Erseka, at that point, a socialist atheist stronghold. He would come and visit on the weekends, when we held meetings, and we had rented an apartment so we could stay the night, and have more time there. I remember him kneeling down at his bed, and praying before he went to sleep, it was so natural for him. His relationship with the Lord was so dear.

‘What a Friend we have in Jesus,’ I think must have been one of his favorite songs, he and Kristac and Koco would sing it with tears pouring out of their eyes, it became a very special song to all of us because of the meaning it had to them and all they’d been through, and how they found Jesus to be their most faithful Friend.

I hope that this is the type of thing that you wanted Zhuljeta...

It was very nice meeting you in Korca,

Eshtë me shumë kënaqësi që unë po shkruaj disa kujtime rreth xhaxhi Ligorit. Ai është një person të cilin ne e kujtojmë shpesh sepse besimi dhe shembulli i tij vazhdon të jetojë brenda të gjithë nesh... Ai është një nga njerëzit më të perëndishëm që kam takuar apo njohur, dhe do të kisha uruar që ta dija Shqipën me mirë kur u takova me të, në mënyrë që të kishim biseduar së bashku më tepër... Kur takoheshe me të ishte e pamundur të mos ndjeje urtësinë dhe mirësinë e tij. Disa nga fotot e tua janë nga pagëzimet. Rilindja e Kishës së Korçës ishte ëndrra e tij, dhe ne ishim të privilegjuar që

mund ta ndihmonim me realizimin e kësaj ëndrre. Ai ishte plaku i parë i zgjedhur në Kishën Ungjillore të Korçës, dhe personi të cilin konsultonim për shumicën e gjërave. Ai u bashkua me ne shpesh në udhëtime ungjillizuese, në të cilat vizitonim në mënyrë sistematike të gjitha fshatrat që na dilnin përpara me Landrover. Unë gjithmonë do ta kujtoj se si na u desh të iknim me vrap nga Pirgu sepse filluan të na gjuajnë me gurë. Ai u ngrit dhe filloi të flasë përpara se ne të ishim gati, dhe përpara se filluam të vrapojmë. Kur arritëm në makinë shëndoshë e mirë ai tha: 'Po këtë gjë bënë herën e fundit kur ishim këtu, por unë doja t'ju jepja një shans të dytë!' Ai nuk na kishte thënë asgjë më parë për këtë, ndaj nuk e kishim fare idenë e opozitës që ai kishte përjetuar në këtë vend me parë, nuk donte që ne të shkonim tek ky vend me paragjykime. Ai ishte pjesë e njerit prej projekteve tona të para, rindërtimin e shkollës në Progër. Së bashku me një grup nga jashtë dhe nga Kisha e Korçës për dy javë ne e vizituam fshatin çdo ditë, punuam në shkollë dhe vizituam gjithë shtëpitë derë me derë. Xhaxhi Ligor dhe xhaxhi Berti punuan krah për krah, duke riparuar mure dhe duke i lyer. Xhaxhi Berti s'pushonte se bëri pyetje gjithë ditën, dhe xhaxhi Ligor dukej që ishte gjithmonë gati për t'i dhënë një përgjigje. Ne shkonin në studimin biblik që zhvillohej në shtëpinë e tij çdo të mërkurë në mbrëmje. Në veçanti me kujtohet një bisedë, ndërkohë që Kisha Ungjillore po sulmohej nga kisha Orthodokse të cilët po përhapnin thashetheme negative dhe po vendosnin afishe ne qytet. Xhaxhi Ligor tha: Mënyra se si punohet me Orthodoksë nuk është me një çekan, por me një pupël, me kujdes, pak nga pak. Ndaj ne nuk i kundërsulmuan Orthodoksët. Ai po ashtu u bashkua me ne në punën e hershme në Ersekë, në një kohë kur Erseka ishte një fortesë e socializmit. Ai na vizitonte në fundjave kur bënim takime, dhe mori me qira një apartament ku mund të kalonim natën, në mënyrë që të kalonte më shumë kohë atje. Më kujtohet kur ai

gjunjëzohej në lutje pranë krevatit të tij përpara se të flinte, ishte tipike për atë si njeri. Marrëdhënia e tij me Zotin ishte shumë pranë zemrës së tij. 'Ç'mik na është Jezui Krishti', besoj se duhet të ketë qënë një nga këngët e tij më të preferuara. Ai dhe Kristaqi, Koço e këndonin me lotë që ju rridhnin nga sytë. Kjo këngë u bë një këngë shumë e dashur për të gjithë ne, për shkak të domethenies që kishte për ata dhe asaj çka ata kishin përjetur dhe se si Jezusi kishte qënë për ta miku më besnik. Shpresoj që kjo ishte ajo që doje Zhuljeta... Ishte shumë kënaqësi që u takuam me ty në Korçë....

Me dashuri,

Karalina

Mendime rreth librit

Shumë bukur e ke shkruar... Unë munda të dëgjoj zërin i Xha Ligorit në këto fjalë, që i ke shkruar nga mesazhet e tij dhe nga kujtimet e fjalët e tij. Shumë interesante historia e tij. Është e bukur të lexoje për një mik të nderuar. Sa shumë e ndjejmë mungesën i tij dhe sa të bekuar jemi, që e kemi njohur dhe kemi bashkëpunuar. Gjithmonë me fjalët e urta na ka dhënë... Të lumshin duart!

Caralee Albarian Loring

“Z. Çina la një trashëgimi jo vetëm për brezin e tij i cili përjetoi komunizmin, por për brezat ende për të ardhur. Lexuesi gjen njohuri të jashtëzakonshme për një njeri me karakter të singertë, që e donte Perëndinë dhe të tjerët thellësisht.”

Dana Stucky

Anëtare e Komitetit Ekzekutiv, Instituti për Studime Shqiptare dhe Protestante

Librin e lexova dhe ju përgëzoj për punën që keni bërë. Libri është frymëzues siç edhe duhet të jetë. Urime!

Zefjani Nikolla

Kisha Emanuel

E lexova “librin e të gjithë librave”...dedikim shumë i bukur për babanë tënd të dashur, që i lidhur me besimin tek Zoti dhe Ungjilli gjeti kuptimin e jetës së tij të përkushtuar. Suksese dhe urime.

Angjelina Xhara

skenariste

Po më kthehet në zemër gjithë e kaluara! Më pelqeu libri, dhe siç thashë m'u kthyen shumë gjëra. Më pëlqen fakti që ke marrë përsipër barrën për të shkruar jetën e tij, është një punë e madhe, por bekim për ata që do ta lexojnë.

Pastor Mike Brown

Libri i Zhuljeta Grabocka-Çinas nuk është një rrëfim tipik historik, as nuk është një prozë artistike e ndërtuar mbi një ngjarje të fantazuar: Por është një ngjarje e vërtetë, që rrëfhet nga një dëshmitare, rreth ngjarjeve më të rëndësishme të historisë së familjes së vet, të qytetit të vet. Ajo rrëfen ngjarje me rëndësi për të gjithë kombin me shumë ngjyra, me shumë ndjenjë, me shumë vlerësime,

që lexuesit të mund t'i ngjallet interesi për këto ngjarje e njerëz, në dukje të zakonshëm, por të bërë të jashtëzakonshëm prej Atij që drejton në të vërtetë historinë. Për ta bindur lexuesin për Atë që e drejton historinë e këtij vendi të vogël, në libër ndërthurren dy ligjërime: Ai i Zhuljetës dhe ai i Biblës, i shfaqur përmes citimeve të vargjeve të ndryshme nga teksti biblik, të cilat e drejtojnë lexuesin nga konteksti i ngushtë i një familjeje, i një qyteti, i një vendi si Shqipëria për tek një panoramë botërore, gjithëkohore, si është edhe vetë rrëfimi biblik. Ky libër nuk është vetëm një dëshmi për jetën e Ligor Çinas, por njëkohësisht me jetën e tij, rrëfhet edhe jeta e kishës së Perëndisë në Shqipëri. Një histori të cilën kemi dëshiruar ta dëgjojmë e ta lexojmë. E kishim besuar se mund të ishte e vërtetë, por ende nuk e kishim mësuar me fakte: Perëndia nuk e kishte lënë pa dritën e dëshmisë së Vet Shqipërinë. Përgjatë viteve të Regjimit të ashtuquajtur Popullor në Shqipëri, kur pushteti e ndaloi çdo formë të adhurimit dhe të besimit fetar, Perëndia ruajti për Vetën e Tij një “mbetje” besnike, një dritë, edhe pse e dobët, por ... një dritë.

Lexuesit do të mund të gjejnë nëpër rreshtat e mbushur me ligjërime emotiv biografike e një dëshmie të rëndësishme të krishtërimit ungjillor dhe të përvijojnë kështu hallkat e munguara të një historie që duhet rrëfyer.

Teuta Toska

Ky libër është më shumë sesa një jetëshkrim. Është një histori frymëzuese, një dëshmi besimi dhe shembull besnikërie. Çdo kush që do t'a lexonte, do të thoshte me gojën plot, se Ligor Cina ka jetuar me ungjillin kohë e pa kohë. Ai ka jetuar me Lajmin e Mirë në ditë me dritë, por edhe në ditët më të errëta. Jeta e tij

është një dëshmi e gjallë e fuqisë vepruese të Perëndisë edhe atëherë kur sytë njerëzor nuk shohin shpresë. Në jetën e Ligorit shpaloset fuqia e shpresës dhe e lirisë që sjell ungjilli tek njeriu edhe kur ai jeton në një diktaturë të egër.

Në të njëjtën kohë libri është edhe një histori tepër e rëndësishme se si Kisha Ungjillore në Shqipëri ka dalë e sprovuar përmes zjarrit të përndjekjes. Është një urë lidhëse e historisë ungjillore shqiptare të të dy kohëve, para dhe pas komunizmit. Libri ka edhe dokumentime të ngjarjeve ungjillizuese dhe emrave të misionarëve të parë pasi u hap Shqipëria, të cilat mund të shërbejnë në të ardhmen si një referencë për të ndërtuar një histori të plotë të krishtërimit shqiptar. Këto tregime marrin vlera të padiskutueshme, pasi dëshmia e fjalës përforcohet me fotografi, të cilat të marra së bashku, i sjellin ngjarjet tek lexuesi tërësisht autentike dhe të gjalla.

Autorja na ka sjell një rrëfim që e tejkalon admirimin dhe dashurinë që ajo ka për prindin e saj, ndonëse këto ndjenja janë të pranishme në çdo rresht. Për më tepër, libri është një krijim që të fton të mahnitesh me veprën e Perëndisë në jetën e Ligorit, por edhe dhe që të pergatisësh veten për rrugëtimin që Krijuesi ka rezervuar si vazhdimësi të misionit që Ligori ka lënë pas.

Zhuljeta, ka treguar një jetë me në qendër ungjillin, jo thjesht si një kujtim për njerëz të familjes, por si një inkurajim për breza besimtarësh që duan të gjenden besnik përpara Perëndisë njësoj si Ligor Cina. Ai e ka mbajtur me përulësi dhe përgjegjshmëri stafetën e ungjillit që nga vitet 30' dhe ia ka dorëzuar besimtarit të ri të viteve 90'.

Na takon ne tani, ta pasojmë tek të tjerë visarin e mirë që Ligori na ka lënë.

Kaon Serjani

Disa fjalë për autoren



Zhuljeta Grabocka (Çina) ka lindur në vitin 1953, në qytetin e Korçës. Ka mbaruar studimet e larta pranë Universitetit të Tiranës, fakulteti Histori – Filologji, dega: Gjuhë - letërsi shqipe. Në vitin akademik 1982 – 1983 ka përfunduar kursin pasuniversitar një vjeçar për gjuhësi me rezultate të shkëlqyera. Ajo ka një përvojë të pasur në mësimdhënien e lëndës së letërsisë, në menaxhimin e drejtimit të shkollës së mesme

në Maliq dhe inspektimit pranë DAR Korçë. Vitet e fundit, ajo punoi në disa shkolla të qytetit të Tiranës dhe doli në pension në gjimnazin “Qemal Stafa”. Krahas veprimtarive me shoqërinë civile, ajo ka punuar si e jashtme në redaksinë e kulturës pranë Radio Korçës. Përveç këtij libri memuar mbi modelimin e formimit të personalitet dhe jetës në besim, ajo ka shkruar edhe dy vëllime me poezi “Ditari i gushtit” dhe “Bota pa stinë”.

